



**Planifikimi i  
menaxhimit  
të siteve të  
Trashëgimisë  
Botërore të  
UNESCO-s**  
*Udhëzime për  
hartimin, zbatimin  
dhe monitorimin  
e planeve të  
menaxhimit*



Ky publikim është punuar me ndihmën financiare të Programit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA Adriatik (*IPA Adriatic Cross-Border Cooperation Programme*). Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësia ekskluzive e Qendrës për Konservim dhe Arkeologji e Malit të Zi dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron këndvështrimet e përgjegjësve për programin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA Adriatic



**Planifikimi i  
menaxhimit  
të siteve të  
Trashëgimisë  
Botërore të  
UNESCO-s**  
*Udhëzime për  
hartimin, zbatimin  
dhe monitorimin  
e planeve të  
menaxhimit*

me shembuj të siteve të UNESCO-s  
në rajonin e Adriatikut

# Përmbajtja

<b>Për udhëzimet e “Planifikimit të menaxhimit të siteve të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s – Udhëzimet për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve të menaxhimit – me shembuj të siteve të UNESCO-s në rajonin e Adriatikut”</b>	<b>01</b>
--	-----------

---

<b>1. Hyrje</b>	<b>03</b>
-----------------	-----------

---

1.1 Për projektin EX.PO AUS	03
1.2 Sitet e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në rajonin e Adriatikut të përfshirë në projektin EX.PO AUS	04
1.3 Aktivitete të lidhura me planifikimin e menaxhimit në kuadër të projektit EX.PO AUS	08

<b>2. Korniza për mbrojtjen dhe menaxhimin e zonave të Trashëgimisë Botërore</b>	<b>13</b>
--	-----------

---

2.1 Konteksti i Trashëgimisë Botërore	13
2.2 Pikënisjet kryesore për menaxhimin e pasurive të Trashëgimisë Botërore	14
2.3 Mbrojtja dhe menaxhimi i pasurive të Trashëgimisë Botërore	16

<b>3. Sistemi i menaxhimit të Trashëgimisë Botërore</b>	<b>19</b>
---	-----------

---

3.1 Supozime kyçe për qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e sistemit të menaxhimit	21
3.2 Procesi i planifikimit të menaxhimit dhe planet e menaxhimit	23

<b>4. Korniza për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të menaxhimit – Shtojcë A e Doracakut për Trashëgiminë Botërore – Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore Botërore</b>	<b>25</b>
---	-----------

---

4.1 Hyrje: Planet e menaxhimit në kuadër të sistemit të menaxhimit	26
4.1.1 Planifikimi i menaxhimit: vështrim	26
4.1.2 Plani i menaxhimit	27
4.2 Procesi i planifikimit të menaxhimit (fazat e ndryshme)	30
4.2.1 Procesi i planifikimit të menaxhimit	30
4.2.2 FAZA I: PËRGATITJA	32
4.2.3 FAZA II: GRUMBULLIMI I TË DHËNAVE/INFORMACIONEVE	32
4.2.4 FAZA III: VLERËSIMI I RËNDËSISË/GJENDJES	33
4.2.5 FAZA IV: ZHVILLIMI I PËRGJIGJEVE/PROPOZIMEVE	33

4.3	Përmbajtja e planit të menaxhimit	51
4.3.1	Përmbajtja e planit të menaxhimit	51
4.3.2	Aktivitetet pas hartimit të planit	51

**5. Mësimet e nxjerra gjatë planifikimit të menaxhimit të siteve të Trashëgimisë Botërore në rajonin e Adriatikut** 53

---

5.1	Hartimi dhe zbatimi i planeve të menaxhimit – procesi, mësimet e nxjerra, sfidat	61
5.2	Korniza ligjore dhe institucionale	63
5.3	Llojet e sistemeve të menaxhimit dhe aktorët kryesorë, përgjegjësitë, bashkërenditja mes aktorëve	71
5.4	Marrëdhëniet e menaxhimit ndaj konservimit, restaurimit dhe mirëmbajtjes	74
5.5	Marrëdhëniet e menaxhimit ndaj planifikimit urbanistik dhe hapsinor	75
5.6	Marrëdhëniet e menaxhimit ndaj zhvillimit (politikat, strategjitë, etj.)	76
5.7	Financimi dhe fondet	77
5.8	Monitorimi i efikasitetit	78

**6. Bibliografia** 81

---

**7. Summary** 82

---



# *Për udhëzimet e “Planifikimit të menaxhimit të siteve të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s – Udhëzimet për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve të menaxhimit – me shembuj të siteve të UNESCO-s në rajonin e Adriatikut”*

Udhëzimet “Planifikimi i menaxhimit të siteve të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s – Udhëzimet për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve të menaxhimit – me shembuj të siteve të UNESCO-s në rajonin e Adriatikut” janë krijuar në kuadër të projektit ndërkuftar EX.PO AUS (EXtension of Potentiality of Adriatic UNESCO Sites – Avancimi i potencialeve të siteve të UNESCO-s në rajonin e Adriatikut), të cilin e bashkëfinancon Bashkimi Evropian në kuadër të Programit IPA të bashkëpunimit ndërkuftar Adriatik (Adriatic CBC Programme) 2007–2013.

Objektivi i përgjithshëm i projektit EX.PO AUS është krijimi i rrjetit të bashkëpunimit mes siteve të UNESCO-s në Detin Adriatik (duke përfshirë edhe sitet nga Lista e pasurive potenciale të Trashëgimisë Botërore ose ato që planifikohen të përfshihen në këtë listë), të zbatueshëm në kontekstin ndërkuftar me zgjerim të njohurive dhe aftësive cilësore teknike dhe menaxhuese mes aktorëve të ndryshëm publikë dhe privatë – objektivi është strategjia e përbashkët afatgjatë e zhvillimit të qëndrueshëm të këtyre siteve, e bazuar në nivelin e lartë të inovacionit menaxhues, teknologjik dhe energjetik. Një nga objektivat specifike të projektit EX.PO AUS është zhvillimi ndërkuftar i konceptit dhe i mjeteve për menaxhimin e qëndrueshëm të siteve të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s.

Këto udhëzime janë pjesë e proceseve dhe aktiviteteve specifike të lidhura me planifikimin e menaxhimit të pasurive të Trashëgimisë Botërore, të iniciuara në kuadër të *Paketës së punës 3 – Menaxhimi i qëndrueshëm ndërkuftar i siteve të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në rajonin e Adriatikut*, të cilën e ka koordinuar Qendra për Konservim dhe Arkeologji e Malit të Zi. Aktivitetet që janë realizuar në kuadër të kësaj pakete të punës përfshijnë: vlerësimin e gjendjes së planeve të menaxhimit dhe çështjeve të përgjithshme të menaxhimit për sitet e UNESCO-s të përfshira në projekt; vlerësimin e efikasitetit të menaxhimit përmes hartimit dhe testimit praktik të listës së kontrollit dhe të treguesve; hartimin e Qasjes së përbashkët ndërkuftare për menaxhimin e qëndrueshëm të siteve të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në rajonin e Adriatikut; organizimin e nëntë seminareve/punëtorive për hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit. Këto aktivitete më hollësisht janë të përshkruara në kapitullin 1.2 - Aktivitetet e lidhura me planifikimin e menaxhimit në kuadër të projektit EX.PO AUS. Udhëzimet ekzistuese janë të bazuara mbi rezultatet e aktiviteteve të përmendura.

**Objektivi i këtyre udhëzimeve** është që të kontribuojnë për përmirësimin e procesit të menaxhimit të zonave të Trashëgimisë Botërore në rajonin e Adriatikut, si dhe të zonave që e synojnë këtë status, posaçërisht përmes kornizës për hartim, zbatim dhe monitorim të planeve të menaxhimit.

Udhëzimet janë krijuar në bazë të rezultateve të projektit EX.PO AUS, duke u mbështetur mbi udhëzimet ndërkombëtare për menaxhimin e zonave të Trashëgimisë Botërore. Posaçërisht ka qenë e rëndësishme që gjatë realizimit të projektit, në vitin 2013, Qendra për Trashëgiminë Botërore e UNESCO-s, ICCROM, ICOMOS dhe UCN kanë botuar doracakun e ri *World Heritage Resource Manual - Managing Cultural World Heritage / Doracaku për Trashëgiminë Botërore – Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore Botërore*<sup>1</sup>. Përveç literaturës tjetër të vëllimshme për këtë temë, materiali nga ky Doracak ka qenë baza kryesore për hartimin e udhëzimeve.

Udhëzimet u janë kushtuar të gjithë aktorëve që janë përfshirë në procesin e menaxhimit të zonave të Trashëgimisë Botërore. Posaçërisht është me rëndësi se udhëzimet janë të përgatitura në gjuhët e të gjitha vendeve që marrin pjesë në projektin EX.PO AUS: në gjuhën shqipe, boshnjake, kroate, italiane, malazeze dhe sllovene, duke përfshirë edhe gjuhën angleze. Në këtë mënyrë njohuritë dhe udhëzimet më të reja mbi planet e menaxhimit do të jenë të qasshme për numrin e madh të aktorëve në vendet e pellgut të Adriatikut.

Udhëzimet përmbajnë këto kapituj:

- Në kapitullin e parë jepet një hyrje e përgjithshme për projektin EX.PO AUS dhe për sitet e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në rajonin e Adriatikut që janë të përfshirë në projektin EX.PO AUS
- Në kapitujt 2 dhe 3 janë dhënë parimet kryesore të menaxhimit të zonave të

<sup>1</sup> UNESCO, ICCROM, ICOMOS i IUCN. 2013. *Managing Cultural World Heritage*. Paris. UNESCO World Heritage Centre. (World Heritage Resource Manual.)

Trashëgimisë Botërore. Në këtë pjesë, në një formë të përmbledhur jepen pikënisjet dhe korniza kryesore lidhur me sistemin e menaxhimit të zonave të Trashëgimisë Botërore. Ato mbështeten tek dokumentet e miratuara ndërkombëtare të kësaj fushe, posaçërisht tek dokumentet e UNESCO-s, duke përfshirë edhe doracakun e ri *World Heritage Resource Manual - Managing Cultural World Heritage / Doracaku për Trashëgiminë Botërore – Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore Botërore*/

- Në kapitullin 4 është dhënë tërësisht Shtojca A e Doracakut për Trashëgiminë Botërore – Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore Botërore: Korniza për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të menaxhimit. Ishim të mendimit që do të ishte shumë me rëndësi që ky material të prezantohet në tërësi.
- Në kapitullin 5 jepen mësimet e nxjerra gjatë planifikimit të menaxhimit të siteve të Trashëgimisë Botërore në rajonin e Adriatikut që janë të përfshira në projektin EX.PO AUS, deri tek cilat është ardhur në bazë të rezultateve të aktiviteteve të projektit EX.PO AUS.

Edhe nëse këto udhëzime, si dhe i tërë projekti EX.PO AUS, fokusohen, pikë së pari, tek zonat e Trashëgimisë Botërore dhe sitet që synojnë këtë status, ato mund të jenë të dobishme edhe si shembuj për menaxhimin e zonave tjera të trashëgimisë kulturore dhe si kornizë për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve të menaxhimit.

## 1.1. Për projektin EX.PO AUS

Projekti EX.PO AUS (EXtension of POtentiality of Adriatic UNESCO Sites – Përmirësimi i potencialeve të siteve të UNESCO-s në rajonin e Adriatikut) paraqet një projekt ndërkufitar që e bashkë-financon Bashkimi Evropian në kuadër të IPA Programit të bashkëpunimit ndërkufitar Adriatik (Adriatic CBC Programme) 2007–2013. Në projekt marrin pjesë dymbëdhjetë partnerë nga të dy anët e Detit Adriatik, nga katër vende anëtare të Bashkimit Evropian (Italia, Sllovenia, Kroacia dhe Greqia) dhe tri vende të Adriatikut lindor (Bosnje - Hercegovina, Mali i Zi dhe Shqipëria): Qyteti i Dubrovnikut, Qarku i Istrias, Qyteti i Splitit, Provinca Ferrara, Komuna e Ravenës – Muzeu i qytetit, Komuna Alberobello; Fondacioni Akuileia, Universiteti Primorska – Qendra Shken-core dhe Kërkimore; Qendra për Konservim dhe Arkeologji e Malit të Zi, Komisioni i Ruajtjes së Monumenteve Kombëtare (Bosnje - Hercegovinë), Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Butrintit (Shqipëri) dhe Komuna e Korfuzit (Greqi). Kohëzgjatja e projektit është tridhjetë e gjashtë muaj.

Objektivi i përgjithshëm i projektit EX.PO AUS është krijimi i rrjetit të bashkëpunimit mes siteve të UNESCO-s në Detin Adriatik (duke përfshirë edhe sitet nga Lista e pasurive potenciale të Trashëgimisë Botërore

ose ato që planifikohen të përfshihen nën këtë listë), të zbatueshëm në kontekstin ndërkufitar me zgjerim të njohurive dhe aftësive cilësore teknike dhe menaxhuese mes aktorëve të ndryshëm publikë dhe privatë – objektivi është strategjia e përbashkët afatgjatë e zhvillimit të qëndrueshëm të këtyre siteve, e bazuar në nivelin e lartë të inovacionit menaxhues, teknologjik dhe energjetik.

Për ta arritur këtë objektiv strategjik, synohet arritja e qëllimeve specifike që vijojnë:

- zhvillimi ndërkufitar i konceptit dhe i mjeteve për menaxhim të qëndrueshëm të siteve të UNESCO-s;
- zgjerimi ndërkufitar i njohurive, teknikave dhe mbështetjes teknike përmes shkëmbimit të informacioneve për praktikatat dhe teknikat më të mira;
- realizimi i pilot aksioneve inovuese në site të caktuara të UNESCO-s;
- valorizimi i përbashkët i të gjithë siteve të UNESCO-s në rajonin e Adriatikut dhe përqendrimi tek çështjet tematike specifike, me qëllim të tërheqjes së numrit sa më të madh të turistëve (në nivelin botëror) të cilët janë të interesuar për kulturën dhe natyrën.

Qasja ndërkufitare është mënyra më e përshtatshme e arritjes së rezultateve afatgjata të zhvillimit të qëndrueshëm të

trashëgimisë kulturore për shkak të kombinimit të afërsisë gjeografike dhe përqendrimit të lartë të trashëgimisë kulturore dhe natyrore të pranuar nga UNESCO-ja. Sipas përkufizimit, sitet e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s e kanë një dimension ndërkombëtar që i tejkalon kufijtë kombëtarë, kështu që është me shumë rëndësi të krahasohen, shkëmbehen dhe të transmetohen përvojat, si dhe të zhvillohen strategjitë e reja të përbashkëta të bazuara mbi afërsinë territoriale.



**EX.PO AUS**

EXtension of POtentiality  
of Adriatic Unesco Sites

## 1.2. Sitet e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në rajonin e Adriatikut të përfshirë në projektin EX.PO AUS

Fernan Brodel (Fernand Braudel), historiani francez i njohur për veprën e vet për Mesdheun, ka menduar se nuk ekziston vetëm një Det Mesdhe unik, por një hapësirë jashtëzakonisht e madhe e përbërë nga shumë dete. Ishte mendimi se nga të gjitha zonat e Mesdheut, Deti Adriatik është “ndoshta më i lidhuri”. Kushtet gjeografike, rrethanat politike dhe ekonomike, ndikimet e qytetërimeve dhe feve bashkërisht kanë kontribuar që Adriatiku të bëhet një botë homogjene që përfshihet edhe jashtë brigjeve të detit. Qytetërimi i tij ka qenë shumë i ndërlikuar, me ndikime nga përendimi dhe nga lindja dhe me elementet të cilat me ndërthurjen e vet i kanë dhënë origjinalitetin kësaj zonë kufitare.<sup>2</sup>

Deti Adriatik është zonë e cila karakterizohet me shumëllojshmëri dhe pasuri të vlerave të natyrës dhe të peisazhit. Duke konsideruar se Adriatiku ka qenë udhëkryqi i qytetërimeve të ndryshme dhe udha kryesore e grekëve, romakëve dhe venedikasve, nuk çudit fakti se pasuritë kulturore të vlefshme dhe të llojllojshme një pas një renditen përgjatë brigjeve të Italisë, Sllovenisë, Kroacisë, Malit të Zi, Shqipërisë dhe Greqisë. Brigjet perëndimore dhe lindore të Adriatikut, nga Kanali i Otrantos në jug deri tek brigjet moçalore të lumit Po në veri, janë të pasura me shtresa kulturore, mbetje të kulturave nga epokat e kaluara dhe me pasuri kulturore të vlefshme.

<sup>2</sup> Braudel, F. 1949/ 1972 *Mesdheu dhe bota mesdhetare në kohën e Filipit të II /The Mediterranean and the Mediterranean World in the Age of Philip II/*

Trashëgimia kulturore dhe natyrore e Adriatikut përfshin pasuritë me vlera të jashtëzakonshme universale që janë të vendosura në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Aktualisht, në zonën e Detit Adriatik janë mbi 20 site të UNESCO-s. Projekti EX.PO AUS ka përfshirë 14 site të këtylla, prej të cilëve **11 tashmë janë përfshirë në Listën e Trashëgimisë Botërore, dy janë në Listën e pasurive potenciale të Trashëgimisë Botërore (Lista e Përkohshme), ndërsa një akoma nuk është përfshirë në Listën e pasurive potenciale.** Të gjitha këto site i takojnë kategorisë së pasurive kulturore.

**Zonat e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s që janë të përfshira në projektin EX.PO AUS janë:**

1. Trulli në Alberobello, Itali
2. Zona arkeologjike e Bazilikës Patriarkale të Aquileias, Itali
3. Butrinti, Shqipëri
4. Qyteti i Vjetër i Korfuzit, Greqi
5. Qyteti i Vjetër i Dubrovnikut, Kroaci
6. Ferrara, qytet i Rilindjes në grykëderdhje

të lumit Po, Itali

7. Zona natyrore dhe kulturo-historike e Kotorrit, Mali i Zi
8. Zona e Urës së Vjetër dhe Qyteti i Vjetër i Mostarit, Bosnje - Hercegovinë
9. Kompleksi peshkopal i Bazilikës së Eufrazianit në Qendrën historike të Poreçit, Kroaci
10. Monumentet e krishtërimt të hershëm të Ravenës, Itali
11. Kompleksi historik i Splitit me Pallatin e Dioklecianit, Kroaci

**Dy site në Listën e Përkohshme të pasurive potenciale të Trashëgimisë Botërore përfshijnë:**

12. Zonën natyrore dhe arkitekturore të Bllagajit, Bosnje - Hercegovinë
13. Zonën natyrore dhe arkitekturore të Stollacit, Bosnje - Hercegovinë

dhe një sit i cili akoma nuk është përfshirë në Listën e pasurive potenciale:

14. Peisazhi kulturor i Piranit me krioret në Seçovel dhe Strunjan, Slloveni



Përzgjedhja e siteve ka qenë i kushtëzuar sipas kërkesave të projektit, në njërën anë të prezantojë vlerat e përgjithshme të trashëgimisë së zonës së Adriatikut, dhe në anën tjetër, të përfshijë të gjitha zonat gjeografike.

Truli në Alberobello është shembull i ndërtimeve popullore, kishat në Ravenna tregojnë bukuritë e arkitekturës dhe artit të krishterimit të hershëm, Akvilea është qyteti romak dhe mesjetar në kufi të zonës së gjerë; kompleksi peshkopal në Poreç është i rëndësishëm sepse është i ruajtur, njëllon si Pallati i Dioklecianit në Split; Dubrovniku është unik në vetvete, si qytet mesjetar i fortifikuar dhe jashtëzakonisht mirë i ruajtur në tërësi, ndërsa zona e Kotorrit është e rëndësishme për bashkëveprim të qyteteve bregdetare dhe rrethinave të tyre, njëllon sikur edhe Butrinti, megjithëse rrethanat historike dhe natyrore të këtyre dy siteve janë mjaft të ndryshme; sitet në Bosnje dhe Hercegovinë që janë të përfshira në këtë projekt janë heterogjene, duke konsideruar se Mostari është i vendosur në Listën e Qendrës për Trashëgiminë Botërore, ndërsa Stollac, Bllidinje dhe Bllagaj janë në Listën e pasurive potenciale; bukuria

dhe rëndësia e qytetit të Korfuzit pasqyrohet në karakteristika të ndryshme historike, arkitektonike dhe kulturore; për Piranin është karakteristik ndërthurja e tij me kriporet – si me një ambient natyror të cilin e kanë formuar edhe duart e njeriut; ndërthurjen e veprimtarisë njerëzore me rrethinat natyrore e dëshmon edhe Ferrara.<sup>3</sup>

<sup>3</sup> Publikimi realizuar në kuadër të projektit, 2013. EX.PO AUS Përmirësimi i potencialeve të siteve të UNESCO-s në rajonin e Adriatikut



Alberobello, Itali



Akvilea, Itali



Butrint, Shqipëri



Korfuz, Greqi



*Dubrovnik, Kroaci*



*Ferrara, Itali*



*Zona e Kotorit, Mal i Zi*



*Mostar, Bosnje – Hercegovinë*



*Poreč, Kroaci*



*Ravenna, Itali*



*Split, Kroaci*



*Bllagaj, Bosnje – Hercegovinë*



*Stollac, Bosnje – Hercegovinë*



*Piran, Slloveni*

### 1.3. Aktivitete të lidhura me planifikimin e menaxhimit në kuadër të projektit EX.PO AUS

Në kuadër të projektit EX.PO AUS është iniciuar një seri e proceseve dhe aktiviteteve specifike të lidhura me planifikimin e menaxhimit të pasurive të Trashëgimisë Botërore, në kuadër të *Paketës së punës 3 – Menaxhimi i qëndrueshëm ndërkufitar i siteve të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në rajonin e Adriatikut*, të cilën e ka koordinuar Qendra për Konservim dhe Arkeologji e Malit të Zi. Kjo paketë e punës ka përfshirë këto aktivitete:


- **Vlerësimi i gjendjes së planeve të menaxhimit dhe çështjeve të përgjithshme të menaxhimit për sitet e**

Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s të përfshira në projektin EX.PO AUS. Vlerësimi është bërë në bazë të formularëve të cilët janë përgatitur dhe plotësuar nga partnerët e projektit EX.PO AUS. Analiza e këtij materiali është prezantuar në “Raportin ndërkufitar për menaxhimin e siteve të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në rajonin e Adriatikut”, që mund të shkarkohet nga faqja e uebit e projektit EX.PO AUS [www.expoaus.org](http://www.expoaus.org).

- Janë organizuar nëntë **seminare/punëtori për hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit**, në nivelet lokale dhe ndërkufitare, me qëllim të edukimit të aktorëve lokalë, zgjerimit të njohurive praktike për përgatitjen dhe zbatimin e planeve të menaxhimit, zgjerimit të përvojave për procesin e planifikimit të menaxhimit në nivelet ndërkombëtare dhe rajonale (të Adriatikut). Punëtoritë janë organizuar me pjesëmarrjen e ekspertes Katri Lisitzin.

**Janë organizuar edhe 5 seminare/punëtori lokale për përgatitjen/zbatimin e planeve të menaxhimit:**

- › Hartimi i planeve të menaxhimit për Qytetin e Vjetër, Split, Kroaci, 21.10.2013
- › Seminari lokal për përgatitjen e planeve të menaxhimit të zonave të UNESCO-s, Piran, Slloveni, 25.10.2013
- › Prezantimi i planit të menaxhimit për sitin e UNESCO-s Akuileia, Akuileia, Itali, 26.10.2013
- › Planet e menaxhimit për zonat e UNESCO-s dhe sfidat në zbatimin e tyre, shembulli i Butrintit, Butrint, Shqipëri, 18-19.05.2014





*Split, Kroaci, 21.10.2013*



*Piran, Sloveni, 25.10.2013*



*Akuileia, Itali, 26.10.2013*



*Butrint, Shqipëri, 18-19.05.2014*



*Mostar, Bosnje – Hercegovinë, 10.03.2014*



*Piran, Sloveni, 24.10.2013*



*Kotorr, Mal i Zi, 10.04.2014*



*Poreç, Kroaci, 12.06.2014*



Dubrovnik, Kroaci, 11.09.2014

- › Sfidat në zbatimin e planeve të menaxhimit për zonat e Trashëgimisë Botërore, Mostar, Bosnje – Hercegovinë, 10.03.2014

**Janë organizuar edhe 2 seminare/punëtori rajonale për përgatitjen/zbatimin e planeve të menaxhimit:**

- › Seminari ndërkufitar për përgatitjen dhe zbatimin e planeve të menaxhimit për sitet e UNESCO-s në rajonin e Adriatikut, Piran, Slloveni, 24.10.2013

- › Menaxhimi i qëndrueshëm i zonave të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në rajonin e Adriatikut, Kotorr, Mali i Zi, 10.04.2014


**Gjithashtu është organizuar pjesëmarrja në dy konferenca/punëtori lokale:**

- › Përgatitja e planeve të menaxhimit për sitet e UNESCO-s dhe zbatimin e tyre në kontekstin e gjerë të zhvillimit urban, etiketimit, promovimit dhe qasjes bashkëkohore ndaj mbrojtjes së trashëgimisë, Poreç, Kroaci, 12.06.2014
- › Mundësitë e qëndrueshme të menaxhimit: “Fokusi tek menaxhimi në qytetet historike”, Dubrovnik, Kroaci, 11.09.2014



Split, Kroaci, 21.10.2013

- **Qasja e përbashkët ndërkufitare ndaj menaxhimit të qëndrueshëm të siteve të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në rajonin e Adriatikut,** që fokusohet tek menaxhimi i pasurive të Trashëgimisë Botërore, si njëri nga proceset kryesore të mbrojtjes së tyre. Kjo qasje e përbashkët ndërkufitare vendos parimet kryesore udhëheqëse, të bazuara mbi qasjet dhe njohuritë e pranuar në nivelin ndërkombëtar, për mbrojtjen dhe menaxhim të Trashëgi-



misë Botërore dhe të trashëgimisë kulturore në përgjithësi; thekson supozimet kryesore për qëndrueshmëri dhe efikasitet të sistemit të menaxhimit të pasurive të Trashëgimisë Botërore; dhe propozon udhëzimet për qasjen e përbashkët ndërkuftare, të bazuar mbi proceset dhe aktivitetet e iniciuara në kuadër të projektit EX.PO AUS. Qasja e përbashkët ndërkuftare mund të shkarkohet nga faqja e ueb-it e projektit EX.PO AUS [www.expoaus.org](http://www.expoaus.org).


**Vlerësimi i efikasitetit të menaxhimit të siteve të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në rajonin e Adriatikut** përmes hartimit dhe testimit praktik të listës së kontrollit dhe të treguesve të efikasitetit të menaxhimit. Duke u nisur nga modelet ekzistuese për vlerësimin e efikasitetit të menaxhimit, është vendosur që si bazë e procesit të vlerësimit pilot të zonës në kuadër të projektit EX.PO AUS të përdoret metodologjia e zhvilluar në dokumentin “Enhancing our Heritage Toolkit - Assessing management effectiveness of natural World Heritage sites” / Doracaku për përmirësimin e trashëgimisë sonë – Vlerësimi i efikasitetit të menaxhimit të Trashëgimisë Botërore Natyrore<sup>4</sup>. Në kuadër të projektit janë testuar dy instrumente nga “Doracaku për përmirësimin e trashëgimisë sonë”, në bazë të të cilave është përgatitur një pyetësor i cili iu është shpërndarë partnerëve dhe i cili është analizuar. Gjatë realizmit të projektit, gjatë periudhës 2014-2015, është përfunduar Cikli i II-të i Raportimit Periodik të UNESCO-s për Evropën dhe Amerikën

<sup>4</sup> Hockings, M., James, R., Stolton, S., Dudley, N., Mathur, V., Makombo, J., Courrau, J. and Parrish, J. (2008). Enhancing our Heritage Toolkit. Assessing management effectiveness of Natural World Heritage sites. Paris, UNESCO World Heritage Centre. (World Heritage Papers 23.)<http://whc.unesco.org/en/series/23/>

e Veriut /Cycle II of UNESCO Periodic Reporting for Europe and North America<sup>5</sup>, i cili përmban raportet për shtet e Trashëgimisë Botërore të përfshirë në projektin EX.PO AUS. Për të fituar një imazh të plotë dhe të kompletuar, janë analizuar edhe të dhënat për monitorimin nga raporti periodik i UNESCO-s. Raporti “Vlerësimi dhe monitorimi i efikasitetit të menaxhimit të siteve të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në rajonin e Adriatikut” mund të shkarkohet nga faqja e ueb-it e projektit EX.PO AUS [www.expoaus.org](http://www.expoaus.org)

- Hartimi i publikimit “Planifikimi i menaxhimit të siteve të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s – Udhëzime për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve të menaxhimit – me shembuj të siteve të UNESCO-s në rajonin e Adriatikut”.

<sup>5</sup> Qasja në internet, në ueb faqe: <http://whc.unesco.org/>



Publikimi është bërë në bazë të rezultateve të projektit EX.PO AUS, duke u mbështetur tek udhëzimet ndërkombëtare për menaxhimin e zonave të Trashëgimisë Botërore. Ka qenë posaçërisht e rëndësishme që gjatë realizimit të projektit, në vitin 2013, Qendra e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, ICCROM, ICOMOS dhe UCN kanë botuar doracakun e ri World Heritage Resource Manual - Managing Cultural World Heritage / Doracaku për Trashëgiminë Botërore – Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore Botërore/. Qëllimi i publikimit është që të kontribuojë në përmirësimin e procesit të menaxhimit të zonave të Trashëgimisë Botërore në rajonin e Adriatikut, si dhe zo-

nave që e synojnë këtë status, posaçërisht përmes kornizës për hartim, zbatim dhe monitorim të planeve të menaxhimit.

## 2 Korniza për mbrojtjen dhe menaxhimin e zonave të Trashëgimisë Botërore

### 2.1. Konteksti i Trashëgimisë Botërore

*Trashëgimia është pasuria jonë kulturore që e kemi trashëguar nga e kaluara, ajo me çfarë jetojmë tani, dhe çfarë e transmetojmë tek brezat e ardhshëm. Trashëgimia jonë kulturore dhe natyrore është burimi i pazëvendësueshëm i jetës dhe i frymëzimit. Ajo është gur themeli ynë, mbështetja jonë, identiteti ynë. Zbatimi universal është ai që e konceptin Trashëgiminë Botërore, e dallon si të jashtëzakonshme. Zonat e Trashëgimisë Botërore i takojnë të gjithë popujve të botës, pa marrë parasysh se në të cilin territor ndodhen.*<sup>6</sup>

Në vitin 1972 **Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO)** ka miratuar **Konventën për mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore**, me qëllim vendosjen e sistemit efikas të mbrojtjes kolektive të trashëgimisë kulturore dhe natyrore me vlerë të jashtëzakonshme universale, të organizuar në bazë të përhershme dhe në përputhje me metodat shkencore bashkëkohore<sup>7</sup>. Me nënshkrimin e Konventës, shtet

tet konfirmojnë se pasuritë që ndodhen në territorin e tyre të cilat janë të përfshira në **Listën e Trashëgimisë Botërore** paraqesin, duke respektuar sovranitetin e shtetit dhe pronën, edhe trashëgiminë botërore “për mbrojtjen e së cilës duhet të bashkëpunojë gjithë komuniteti ndërkombëtar”. Prandaj, shtetet dhe komunitetet lokale kanë përgjegjësinë e madhe në mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë për brezat e rinj.

**Pasuritë e Trashëgimisë Botërore** përfshihen në Listën e Trashëgimisë Botërore, e cila përfshin pasuritë më të dalluara të trashëgimisë kulturore dhe natyrore anembanë botës dhe aktualisht janë të përfshira gjithsej 1031. Si pasuri të Trashëgimisë Botërore dallohen monumentet, grupet e ndërtesave, sitet e njohura, monumentet e natyrës, formacionet gjeologjike dhe fiziko-grafike, të cilat janë me vlerë të jashtëzakonshme universale.

*Vlera e jashtëzakonshme universale nënkupton rëndësinë kulturore dhe/ose natyrore që është aq e rëndësishme sa që i tejkalon kufijtë shtetërore dhe është me rëndësi të përbashkët për brezin e tanishëm dhe ato të ardhshme të të gjithë njerëzimit. Si e tillë, mbrojtja e përhershme e kësaj trashëgimie është me rëndësi më të madhe për komunitetin ndërkombëtar në përgjithësi.*<sup>8</sup>

<sup>6</sup> UNESCO Qendra për Trashëgiminë Botërore (World Heritage Centre). 2008. *World Heritage Information Kit*

<sup>7</sup> UNESCO. 1972. *Konventë lidhur me Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore/ Convention concerning the Protection of the World Cultural and Natural Heritage/*

<sup>8</sup> UNESCO Qendra për Trashëgiminë Botërore. 2015 Udhëzimet operative për zbatimin e Konventës mbi Trashëgiminë Botërore / *Operational Guidelines for the Implementation of*

## 2.2. Pikënisjet kryesore për menaxhimin e pasurive të Trashëgimisë Botërore

Kur bëhet fjalë për mbrojtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore është me rëndësi të kemi pikënisjen që mbështetet tek parimet kryesore të kësaj fushe. Shumica e këtyre parimeve kryesore tashmë është përcaktuar në qasjet dhe njohuritë e pranuar në nivelin ndërkombëtar. Disa nga pyetjet kryesore në lidhje me menaxhimin e Trashëgimisë Botërore janë të përfshira në një nga dokumentet më të reja që është hartuar nga UNESCO / ICCROM / ICOMOS / IUCN – the *World Heritage Resource Manual - Managing Cultural World Heritage / Doracaku për Trashëgiminë Botërore – Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore Botërore*<sup>9</sup>.

Po japim disa nga pikënisjet e njohura në Kapitullin 2: Konteksti – menaxhimi i trashëgimisë kulturore të këtij Doracaku<sup>10</sup>, të cilat i konsiderojmë kyçe për menaxhimin e Trashëgimisë Botërore:

- **Vendosja e mbrojtjes së Trashëgimisë Botërore në një kontekst më të gjerë**

Është shumë me rëndësi që një nga pikënisjet të jetë përmirësimi i **konceptit të trashëgimisë** dhe rëndësia gjithnjë e më e madhe që i jepet raportit

---

*the World Heritage Convention/ (WHC.15/01, 8 korrik 2015)*


<sup>9</sup> UNESCO, ICCROM, ICOMOS i IUCN. 2013. *Managing Cultural World Heritage*. Paris. UNESCO World Heritage Centre. (World Heritage Resource Manual.)

<sup>10</sup> Fragmentet nga UNESCO, ICCROM, ICOMOS dhe IUCN. 2013 *Managing Cultural World Heritage*. Paris. UNESCO World Heritage Centre. (World Heritage Resource Manual.)Chapter 2: Context – managing cultural heritage, fq. 12-28.

të pasurive kulturore ndaj **kontekstit më të gjerë** të tyre. Pasuritë kulturore nuk mund të shikohen ndarazi nga aktivitetet zhvilluese, të izoluar nga ndryshimet shoqërore që ndodhin, ose të ndara nga çështjet që janë të rëndësishme për komunitetin. Kur bëhet fjalë për pasuritë kulturore, **faktorët shoqërorë dhe kulturorë** kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të rëndësishme për formimin e tyre.

Dimensioni më i gjerë i trashëgimisë në ditët e sotme ka shkaktuar përfshirjen e një numri më të madh të aktorëve dhe palëve të interesuara në procesin e menaxhimit të trashëgimisë. Është e domosdoshme që organizmat që merren me trashëgiminë të bashkëpunojnë sa më shumë me aktorët e tjerë për të zhvilluar dhe zbatuar vizionin dhe politikat e përbashkëta për menaxhimin e pasurive në kuadër të kontekstit më të gjerë fizik dhe shoqëror të tyre.

- **Roli i trashëgimisë kulturore në zhvillimin e qëndrueshëm** Trashëgimia kulturore, duke përfshirë edhe Trashëgiminë Botërore, mund të luajë rol të rëndësishëm dhe aktiv në zhvillimin e qëndrueshëm. Vetë trashëgimia kulturore është **pjesë e burimeve ekologjike/kulturore** që duhet të mbrohen dhe t'u transmetohen brezave të ardhshëm për të siguruar zhvillimin e tyre. Nga ana tjetër, **trashëgimia dhe ruajtja e trashëgimisë mund të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme ndaj dimensionit ekologjik, shoqëror dhe ekonomik të zhvillimit të qëndrueshëm.**
- **Qasja e ruajtjes dhe menaxhimit të trashëgimisë e bazuar tek vlerat** Qasja e bazuar tek vlerat është përgjigje ndaj njohjes gjithnjë e më të madhe të ndër-



Burimi: UNESCO, ICCROM, ICOMOS i IUCN. 2013 *Managing Cultural World Heritage*. Paris. UNESCO World Heritage Centre. (*World Heritage Resource Manual*), fq. 14. i 15.

likueshmërisë së trashëgimisë. Ajo promovon vlerësimin e rëndësisë së pasurive – të bazuar tek vlerat që ua atribuojnë të gjithë aktorët (jo vetëm ekspertët) dhe përdorimi i Deklaratës mbi rëndësinë si bazë për hartimin e strategjive të konservimit dhe menaxhimit.

- **Menaxhimi i ambientit historik që ndryshon**  
Menaxhimi i ambientit historik është menaxhimi i ndryshimit. Objektivi i këtij menaxhimi duhet të jetë shfrytëzimi i qëndrueshëm i pasurive në kontekstin dhe ambientin e tyre, duke ruajtur, dhe nëse është e mundur, përsëri duke shfrytëzuar atë që është

me rëndësi nga e kaluara, duke ruajtur vlerat të jashtëzakonshme universale të pasurisë. Prandaj, duhet të ndryshohet edhe mënyra e menaxhimit për t’i marrë në konsideratë pikëpamjet e të tjerëve dhe interesat e atyre që jetojnë dhe punojnë në një zonë të caktuar.

- **Qasja gjithëpërfshirëse– qasja e bashkëpjesëmarrëse ndaj menaxhimit**  
Për t’u marrë në konsiderim ndërlikueshmëria gjithë e më e madhe, e cila kërkon përparimin e praktikës së menaxhimit është e domosdoshme rritja e bashkëpjesëmarrjes. Qasjet ndaj menaxhimit duhet të mundësojnë kalimin drejt qasjes më të gjerë, më përfshirëse të menaxhimit të trashëgimisë dhe të

theksojnë gjithë e më shumë përfshirjen e komunitetit.

*Qasja bashkëpjesëmarrëse ndaj menaxhimit promovohet në sektorët e ndryshme, posaçërisht në sektorin e trashëgimisë, duke patur parasysh perceptimin e trashëgimisë si pasuri e përbashkët e komunitetit dhe si faktor i cili mund të sigurojë qëndrueshmërinë e komuniteteve të tilla. Pasuria mund të jetë pronë e aktorëve të ndryshëm, posaçërisht kur bëhet fjalë për zonat urbane ose peisazhet kulturore. Kjo është një gjë posaçërisht e rëndësishme për pasuritë e Trashëgimisë Botërore ku përcaktimi i vlerës së jashtëzakonshme universale nënkupton obligimet edhe më të mëdha dhe një spektër më të gjerë të pronësisë, duke konsideruar se trashëgimia shikohet si pasuri kolektive e tërë njerëzimit dhe se menaxhimi i saj përfshin elementin ndërkombëtar.<sup>11</sup>*

### 2.3. Mbrojtja dhe menaxhimi i pasurive të Trashëgimisë Botërore

Kur bëhet fjalë për aktivitetet e lidhura me Trashëgiminë Botërore, përmes kornizës së përfshirë në Konventën mbi Trashëgiminë Botërore, objektivi i përgjithshëm është **identifikimi, mbrojtja, konservimi, prezantimi dhe transmetimi tek brezat e ardhshëm të trashëgimisë kulturore dhe natyrore që janë me vlerë të jashtëzakonshme universale.**<sup>12</sup>

Nga viti 2005 kërkesa për zhvillimin e qëndrueshëm është e përfshirë në Udhëzimet operative për zbatimin e Konventës mbi Trashëgiminë Botërore, duke shërbyer si udhëzim për menaxhimin e pasurive të Trashëgimisë Botërore.

Koncepti i “menaxhimit” është shfaqur relativisht vonë në historinë dyzetvjeçare të Konventës mbi Trashëgiminë Botërore. Por, kërkesa për realizimin e objektivave të menaxhimit të suksesshëm – identifikimit, mbrojtjes, konservimit, prezantimit dhe transmetimit tek brezat e ardhshëm të trashëgimisë me vlera të jashtëzakonshme universale – ka qenë e përfshirë në Konventë që nga fillimi.

Pasuritë përfshihen në Listën e Trashëgimisë Botërore dhe konsiderohen se i kanë vlerat e jashtëzakonshme universale nëse ato plotësojnë:

<sup>11</sup> UNESCO, ICCROM, ICOMOS i IUCN. 2013. *Managing Cultural World Heritage*. Paris. UNESCO World Heritage Centre. (World Heritage Resource Manual.)

<sup>12</sup> Me nenin 4 të Konventës mbi Trashëgiminë Botërore është përkufizuar se cilido anëtar i Konventës e pranon detyrën e identifikimit, mbrojtjes, konservimit, prezantimit dhe transmetimit tek brezat e ardhshëm të trashëgimisë kulturore dhe natyrore që ndodhen në territorin e saj.

- një ose më shumë kritere të Trashëgimisë Botërore
- kushtet e integritetit dhe origjinalitetit
- kërkesën e mbrojtjes dhe menaxhimit<sup>13</sup>

Çdo pasuri e Trashëgimisë Botërore duhet të ketë një **sistem të përshtatshëm të mbrojtjes dhe manaxhimit** për t'u konsideruar se e ka vlerën e jashtëzakonshme universale.

**Mbrojtja dhe menaxhimi i pasurive të Trashëgimisë Botërore** duhet të sigurojë mirëmbajtjen ose përmirësimin e vlerës së jashtëzakonshme universale të tyre gjatë kohës, duke përfshirë kushtet e integritetit dhe/ose origjinalitetit që kanë ekzistuar në kohën e përfshirjes.<sup>14</sup>

<sup>13</sup> UNESCO Qendra për Trashëgimisë Botërore. 2015 *Udhëzimet operative për zbatimin e Konventës mbi Trashëgiminë Botërore* (WHC.15/01 8. jul 2015), paragrafët 77-97.

<sup>14</sup> UNESCO Qendra për Trashëgiminë Botërore 2015 *Udhëzimet operative për zbatimin*

**Sistemi** i menaxhimit të trashëgimisë kulturore ndihmon në **ruajtjen dhe menaxhimin** e pasurisë ose grupit të pasurive të caktuara në mënyrë që të **mbrohen vlerat e trashëgimisë**, posaçërisht vlerat universale në rast se bëhet fjalë për pasurinë e Trashëgimisë Botërore, dhe, **aty ku ekziston mundësia, zgjerohen dobitë e gjera shoqërore, ekonomike dhe ekologjike edhe jashtë kufijve të pasurisë**. Përveç këtyre, ai nxit rolin konstruktiv të trashëgimisë kulturore në rritjen e zhvillimit njerëzor që në afat të gjatë do të realizojë fitim, duke rritur qëndrueshmërinë e vetë pasurisë kulturore.<sup>15</sup>

*e Konventës mbi Trashëgiminë Botërore* (WHC.15/01 8. jul 2015), paragrafi 96

<sup>15</sup> UNESCO, ICCROM, ICOMOS i IUCN. 2013 *Managing Cultural World Heritage*. Paris. UNESCO World Heritage Centre. (World Heritage Resource Manual.)



Diagrama: Tre shtyllat e vlerës së jashtëzakonshme universale. Burimi: UNESCO, ICCROM, ICOMOS i IUCN. 2013 *Managing Cultural World Heritage*. Paris. UNESCO World Heritage Centre. (World Heritage Resource Manual.), fq. 54 dhe 55.






### 3 Sistemi i menaxhimit të Trashëgimisë Botërore

Sistemi i menaxhimit të pasurive të Trashëgimisë Botërore është krijuar me qëllim mbrojtjen më efektive të vlerave të pasurive kulturore për brezat e sotme dhe ato të ardhshme. Përkufizimi dhe përshkrimi i sistemit të menaxhimit janë dhënë në *World Heritage Resource Manual - Managing Cultural World Heritage / Doracakun për Trashëgiminë Botërore – Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore Botërore*, në kuadër të Kapitullit 4: *Përkufizimi, vlerësimi dhe përmirësimi i sistemit të menaxhimit të trashëgimisë/ Defining, assessing and improving heritage management system*<sup>16</sup>. Në këtë kapitull po paraqesim elementet kryesore të përshkruara në Manual / Doracak.

Sipas *World Heritage Resource Manual - Managing Cultural World Heritage / Doracakut për Trashëgiminë Botërore – Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore Botërore* / janë nëntë komponente<sup>17</sup> të cilat janë të përbashkëta për të gjitha sistemet e menaxhimit:

<sup>16</sup> UNESCO, ICCROM, ICOMOS dhe IUCN. 2013. *Managing Cultural World Heritage*. Paris. UNESCO World Heritage Centre. (World Heritage Resource Manual.) Chapter 4: Defining, assessing and improving heritage management system, fq. 53-121.

<sup>17</sup> UNESCO, ICCROM, ICOMOS dhe IUCN. 2013. *Managing Cultural World Heritage*. Paris. UNESCO World Heritage Centre. (World Heritage Resource Manual.), fq. 53.




Diagrami: Elementet e sistemit të menaxhimit. Burimi: UNESCO, ICCROM, ICOMOS i IUCN. 2013. *Managing Cultural World Heritage*. Paris. UNESCO World Heritage Centre. (World Heritage Resource Manual.), fq. 54–55.

- 3 elemente: Korniza ligjore, korniza institucionale dhe burimet (njerëzore, financiare dhe intelektuale) që janë të nevojshme për të funksionuar sistemi
- 3 procese: Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi
- 3 rezultate: objektivat e arritura (outcomes), rezultatet (outputs) dhe përmirësimi i sistemeve të menaxhimit

Ekzistojnë **sisteme të ndryshme të menaxhimit të trashëgimisë** që ndryshojnë nga vendi në vend dhe nga pasuria në pasuri. Sistemet primare të menaxhimit të pasurive në nivel kombëtar ose rajonal shpeshherë duhet të përmirëojnë proceset e veta të vendimmarrjes për t'i integruar në mënyrë më efektive kontributet e sistemeve të tjera.

Për pasuritë e Trashëgimisë Botërore janë të mundshëm skenarë të ndryshëm, varësisht nga tipi i pasurisë dhe pronësia e tyre:

- Për pasuritë që janë në pronë dhe të cilat menaxhohen përjashtimisht nga “sistemi parësor i menaxhimit” – institucioni kryesor përgjegjës për trashëgiminë me burimet e veta kryen planifikimin e konservimit, zbatimin dhe monitorimin si dhe marrjen e vendimeve.
- Për pasuritë me disa pronarë, përdorues dhe shfrytëzues vijues, siç janë qendrat historike dhe peisazhet kulturore, procesi i vendimmarrjes është i ndryshëm dhe përfshin organet qeverisëse dhe menaxhuese, pronarët dhe përdoruesit. Deri sa disa nga vendimet mund të merren nga organe të veçanta, do duhej të ekzistonte një mekanizëm i ri për marrjen e vendimeve të përbashkëta ose kolektive.



Diagrami: Skenari i menaxhimit ku janë të përfshira organet e ndryshme, Burimi: UNESCO, ICCROM, ICOMOS dhe IUCN. 2013. *Managing Cultural World Heritage*. Paris. UNESCO World Heritage Centre. (World Heritage Resource Manual), fq. 57.

- Në shumicën e rasteve, **organet e ndryshme mund të jenë të përfshira në menaxhimin** e pasurisë dhe zonës së mbrojtur (bufer zone), dhe procesi i vendimmarrjes në kuadër të këtij skenari bëhet edhe më i ndërlikuar dhe parakushti i tij është një platformë e re për vendimmarrje.

### 3.1. Supozime kyçe për qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e sistemit të menaxhimit

**Sistemet i menaxhimit** të pasurive formësohen nga pikëpamjet e ndryshme kulturore, burimet e disponueshme dhe faktorë të tjerë. Sistemi i menaxhimit duhet të përditësohet dhe të përmirësohet rregullisht në përputhje me ndryshimet që u ndodhin pasurive, mjedisit të tyre dhe vetë sistemit të menaxhimit.

Për ta arritur një sistemi menaxhimi të qëndrueshëm dhe efikas nevojitet të shqyrtohen disa **çështje** të caktuara. Disa prej tyre, të theksuara në *World Heritage Resource Manual - Managing Cultural World Heritage / Doracakun për Trashëgiminë Botërore – Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore Botërore/*, përfshijnë<sup>18</sup>:

- **Pranimin e shumëllojshmërisë:** Çdo sistem i menaxhimit të trashëgimisë do të jetë i veçantë deri në një masë të caktuar për arsye se formësohet nga nevojat specifike të trashëgimisë për nën kujdesin e tij, konteksti kulturor dhe faktorët më të gjërë shoqërore, ekonomike dhe ekologjike. Kur bëhet fjalë për Trashëgiminë Botërore duhen shikuar *Udhëzimet operative / Operational Guidelines/ (OG paragrafi 110)*.
- **Qartësia dhe bashkërendimi:** Sistemi i menaxhimit është ciklik dhe përfshin vlerësimin e procesit dhe arritjeve të veta për t'i përshtatur aktivitetet ekzistuese dhe për të siguruar të dhënat e nevojshme për ciklin vijues. Përmes ndërveprimit me sistemet tjera të menaxhimit ose komponentët e tyre, ai

<sup>18</sup> UNESCO, ICCROM, ICOMOS dhe IUCN. 2013 *Managing Cultural World Heritage*. Paris. UNESCO World Heritage Centre. (World Heritage Resource Manual.), fq. 60.

siguron rezultatet e bashkërendura dhe efikase të menaxhimit kur bëhet fjalë për vlerat e trashëgimisë dhe vlerën e jashtëzakonshme universale, në rastin e Trashëgimisë Botërore.

- **Përgatitja ndaj rreziqeve:** Sistemi i menaxhimit duhet të jetë mjaft fleksibil për t'iu përgjigjur ngjarjeve të paparashikuara, siç janë fatkeqësitë natyrore ose ndryshimet e burimeve financiare apo njerëzore të cilat i kanë dispozicion.
- **Qasja pjesëmarrëse:** Mirëkuptimi i përbashkët i pasurisë dhe rëndësisë së saj nga ana e të gjithë aktorëve dhe përfshirja e tyre në procese të menaxhimit në mënyrë radikale mund të ndryshojë mënyrën e realizimit të funksioneve të sistemit të menaxhimit. Me ndihmë të qasjes pjesëmarrëse proceset e lidhura me trashëgiminë mund t'iu përgjigjen më mirë ndikimeve dhe të arrijnë qëllimet dhe rezultatet të cilët janë më mirë të lidhura me nevojat reale të pasurive dhe aktorëve të cilët janë të lidhur me këtë pasuri. Gjithashtu, ajo promovon rolin konstruktiv të trashëgimisë në kontributin që jep për shoqërinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
- **Roli i trashëgimisë në zhvillimin e qëndrueshëm:** Vendosja e rolit aktiv të trashëgimisë në zhvillimin e qëndrueshëm krijon dobiti e shumta reciproke, duke e mundësuar sistemin e menaxhimit që në mënyrë më efikase t'i harmonizojë nevojat e ndryshme dhe të kundërshtuara, dhe që t'i përcaktojë format e reja të mbështetjes që mund t'i përforcojnë vlerat e trashëgimisë.

Sistemi efikas dhe i plotë i menaxhimit të trashëgimisë, i cili reagon në mënyrë të duhur, gjithashtu do të duhej të jetë i aftë për t'iu plotësuar kërkesat e shtuara të cilat ia vendos sistemi i Trashëgimisë Botërore, duke përfshirë përputhshmërinë me proceset e raportimit dhe vendimet e Komitetit të Trashëgimisë Botërore.

Duhet të merren në konsideratë dhe **shqyrtimet e shtuara**<sup>19</sup>:

- *Nevoja që të hartohet një **vizion i përbashkët dhe realist** për zhvillimin afatmesëm dhe afatgjatë të pasurisë, që mund të ndahet me komunitetin ndërkombëtar.*
- *Nevoja e zgjidhjes së **çështjeve të ndryshimeve dhe sfidave të menaxhimit** që mund të rrjedhin nga përfshirja e pasurive në Listën e Trashëgimisë Botërore. Për shembull, nevojitet që të kuptohet dhe të përgatitet për ndikime të rritjes eventuale të numrit të vizitorëve për arsye të përfshirjes në Listë, si dhe që t'i përkushohet më shumë kohë interpretimit të pasurive dhe përmbajtjes për vizitorët.*
- *Nevoja për mjete të reja ose **mjete të përmirësuara për realizim të efikasitetit më të lartë dhe rezultateve më të mira të menaxhimit** kur shtetet vendosin përdorimin e institucioneve dhe burimeve ekzistuese për zbatimin e aktiviteteve të reja të menaxhimit të lidhura me përfshirjen e pasurisë në Listën e Trashëgimisë Botërore.*
- *Nevoja për integrimin e strategjive të reja të menaxhimit për pasuritë e Trashëgimisë Botërore ndonjëherë çon deri tek vendosja e **strukturave të reja të menaxhimit**. Ato mund të jenë njësitë e ndara në kuadër të institucioneve ekzistuese dhe/ose ekipi për zbatim i angazhuar në bazë të projekteve ose të një institucioni në lidhje me një pasuri të caktuar me mandatin dhe burimet e veta të posaçme.*<sup>20</sup>

<sup>19</sup> UNESCO, ICCROM, ICOMOS dhe IUCN. 2013. *Managing Cultural World Heritage*. Paris. UNESCO World Heritage Centre. (World Heritage Resource Manual.), fq. 62.

<sup>20</sup> UNESCO, ICCROM, ICOMOS i IUCN. 2013 *Managing Cultural World Heritage*. Paris. UNESCO World Heritage Centre. (World Heritage Resource Manual.)


### 3.2. *Procesi i planifikimit të menaxhimit dhe planet e menaxhimit*

**Planifikimi i menaxhimit** është një nga instrumentet kyçë për mbrojtjen e vlerave kulturore, dhe posaçërisht për vlerat e jashtëzakonshme universale në procesin e Trashëgimisë Botërore. Në këtë proces, **plani i menaxhimit** në mënyrë të strukturuar i dokumenton sistemin(/-et) e menaxhimit të një pasurie dhe gjithashtu ndihmon që të identifikohen mungesat e sistemit të menaxhimit ekzistues, në bazë të të cilave mund të jepen reagime për ndryshim ose përmirësim të tij.

Përgatitja dhe zbatimi i planeve të menaxhimit kërkojnë kontributin e të gjithë nëntë komponentëve të sistemit të menaxhimit të trashëgimisë, dhe procesi i **hartimit, zbatimit dhe monitorimit të planit të menaxhimit** është shumë i rëndësishëm.

Plani i menaxhimit është mjet i cili zhvillohet përmes fazës së planifikimit, dhe pastaj kryhet zbatimi i tij dhe monitorimi. Korniza për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve të menaxhimit është marrë nga *World Heritage Resource Manual - Managing Cultural World Heritage / Doracakun për Trashëgiminë Botërore – Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore*

*Botërore / dhe është prezantuar në kapitullin vijues.*





## 4 Korniza për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të menaxhimit – Shtojcë A e Doracakut për Trashëgiminë Botërore – Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore Botërore

Materiali i cili gjendet në këtë kapitull është marrë nga *Doracaku për Trashëgiminë Botërore – Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore Botërore / World Heritage Resource Manual- Managing Cultural World Heritage* /<sup>21</sup>. Materiali është pjesë e Shtojcës A të Doracakut, me titullin *Korniza për hartimin, zbatimin dhe përcjelljen e planit të menaxhimit / A framework for developing, implementing and monitoring a management plan/*.

Kjo Shtojcë është marrë nga Doracaku në versionin integral dhe është e plotë.

Është konsideruar se kjo Shtojcë e tërë, duke dhënë udhëzimet për hartim, zbatim dhe monitorim të planit të menaxhimit, paraqet bazën e rëndësishme për menaxhimin e Trashëgimisë Botërore në rajonin e Adriatikut, si dhe të zonave që ndodhen në Listën e pasurive potenciale të Trashëgimisë Botërore ose synohen që në të ardhmen të nominohen për Listën e Trashëgimisë Botërore. Posaçërisht është e rëndësishme që të gjitha udhëzimet, sikurse dhe kjo Shtojcë, janë të përkthyer në 7 gjuhët: në gjuhët shqipe, boshnjake, kroate, greke, italiane, malazeze dhe sllovene, kështu që njohuritë dhe udhëzimet më të reja për planet e menaxhimit do të jenë të qasshme për një numër më të madh të aktorëve në vendet e Adriatikut.

<sup>21</sup> UNESCO, ICCROM, ICOMOS dhe IUCN. 2013 *Managing Cultural World Heritage*. Paris. UNESCO World Heritage Centre. (World Heritage Resource Manual.), fq. 122-145. Shtojca A zgjeron diskutimin për procesin e 'planifikimit' që është dhënë në Pjesën 4.3 të Doracakut.

Shtojca A ka për qëllim të ndihmojë hartimin e planit të menaxhimit që kërkohet në Pjesën 5 të Formatit të nominimit për Trashëgiminë Botërore / World Heritage nomination format<sup>22</sup>. Plani i menaxhimit është instrumenti gjithnjë e më i popullarizuar për mbrojtjen e vlerave kulturore, posaçërisht Vlerave të Jashtëzakonshme Universale (OUV – Outstanding Universal Value) në kuadër të procesit të Trashëgimisë Botërore (World Heritage). Përgatitja dhe zbatimi i planeve të menaxhimit kërkojnë kontributin e të gjithë nëntë komponentëve të sistemit të menaxhimit të trashëgimisë (korniza ligjore, korniza institucionale, burimet, planifikimi, zbatimi, monitorimi, objektivat e arritura, rezultatet, përparimi – duke përfshirë edhe vështrimin e masave të shtuara që janë të nevojshme)<sup>23</sup> dhe paraqet rastin që në mënyrë të strukturuar të dokumentojë sistemin(-et) e menaxhimit të një pasurie. Gjithashtu, plani i menaxhimit ndihmon që të identifikohen mungesat e sistemit ekzistues të menaxhimit, në bazë të të cilave mund të ofrohen informacionet kthyesë për ndryshimin ose përmirësimin e tij. Këto informacione nevojiten edhe për Pjesët 3.1 e, 4.5, dhe 6 të formatit të nominimit.

<sup>22</sup> Formatit për nominim të pasurive për përfshirje në Listën e Trashëgimisë Botërore – Formatit nominues, mund të shkarkohet nga ueb-faqja <http://whc.unesco.org/en/nominationform>

<sup>23</sup> *Managing Cultural World Heritage*. (World Heritage Resource Manual), Pjesa 4

Shtojca është e përbërë nga kapitujt siç vijon:

1. Hyrje: Planet e menaxhimit në kuadër të sistemit të menaxhimit
2. Procesi i planifikimit të menaxhimit
3. Përmbajtja e planit të menaxhimit.

## 4.1. Hyrje: Planet e menaxhimit në kuadër të sistemit të menaxhimit

### 4.1.1. Planifikimi i menaxhimit: vështrim

Planifikimi i menaxhimit, pa dyshim, është bërë një nga mjetet më të njohura në kuadër të sistemit të Trashëgimisë Botërore. Shtetet Palë (nënshkruese të Konventës mbi Trashëgiminë Botërore), anëtarët e Komitetit për Trashëgiminë Botërore dhe të organizmave këshillëdhënëse e përdorin menaxhimin si një instrument për vlerësimin e përkushtimit të Shtetit Palë ndaj ruajtjes së vlerës së jashtëzakonshme universale të një pasurie të caktuar dhe si garanci se dobitë e menaxhimit të trashëgimisë do të përcillen tek shoqëria. Shumë më shpesh përdoret nocioni “plani i menaxhimit”, që i thekson rezultatet e planifikimit në raport me qasjen dhe procesin e planifikimit pjesë e të cilit është.

Megjithatë, planifikimi i menaxhimit dhe planet e menaxhimit që dalin si rezultat i tij duhet të shikohen në raport me sistemin(-et) e drejtimit të vendit ku pasuria ndodhet, siç është përshkruar edhe përpunuar në Pjesën 4<sup>24</sup> (shiko gjithashtu faqet

<sup>24</sup> *Managing Cultural World Heritage*. (World Heritage Resource Manual), Pjesa 4

89-91 të Doracakut për nominim<sup>25</sup>). Plani i menaxhimit duhet të jetë pasqyrim i sistemit të tërë të menaxhimit. Si mjet i cili e dokumenton tërë sistemin e menaxhimit dhe paraqet rastin që të përshkruhet dhe të vlerësohet sistemi përkatës i menaxhimit, dhe si i tillë ai mund të tregojë se si Shteti Palë synon ta ruajë vlerën e jashtëzakonshme universale (OUV) të pasurisë përkatëse.

Kur bëhet fjalë për Trashëgiminë Botërore, ruajtja etributeve të cilat pasqyrojnë vlerën e jashtëzakonshme universale duhet të jetë qëllimi kryesor, por jo edhe qëllimi i vetëm i planit të menaxhimit. Siç është cekur në kapitullin “Procesi i planifikimit të menaxhimit” në vazhdim, plani i menaxhimit merret me vlerat e përgjithshme kulturore të pasurisë dhe me ndryshimet në mjedisin e drejtpërdrejtë të saj të cilat mund të ndikojnë tek ato. Kjo qasje përfshirëse paraqet një cilësitë e procesit të planifikimit të menaxhimit për arsye se kërkon një lidhshmëri me planet tjera (siç janë planet hapësinore lokale dhe rajonale ose planet zhvillimore) dhe aktorët që janë jashtë sistemit të mbrojtjes së trashëgimisë.

Planifikimi i menaxhimit jashtë kufijve fizikë të pasurisë për qëllim ka sigurimin e mbrojtjes më të mirë të vlerës së jashtëzakonshme universale të saj si dhe vlerave të tjera kulturore, dhe që të sigurojë dobitë të cilat shoqëria mund t’i ketë nga trashëgimia, si dhe dobitë për vetë pasurinë që mund të rrjedhin nga përfshirja më e gjerë e komunitetit<sup>26</sup>.

<sup>25</sup> UNESCO, ICCROM, ICOMOS and IUCN. 2011. *Preparing World Heritage Nominations*. Paris. UNESCO World Heritage Centre. (World Heritage Resource Manual). Second edition.

<sup>26</sup> *Managing Cultural World Heritage*. (World Heritage Resource Manual), Pjesa 2.3 për zhvillimin e qëndrueshëm

## KËSHILLAT

Përgatitja e planit të menaxhimit është e lidhur ngushtë me përgatitjen e dosjes për nominim. Kur përcaktohet vlera e jashtëzakonshme universale (OUV), do të ishte mirë që të fillohet me vlerësimin e sistemit të menaxhimit në përputhje me Pjesën 5 të formatit të nominimit (Udhëzimet operative<sup>27</sup> Shtojca 5) dhe t'ia fillojë procesi i cili është i përshkruar në vijim. Pjesët 4, 5 dhe 6 të formatit (Udhëzimet operative Shtojca 5) duhen plotësuar duke përdorur informacionet e grumbulluara për planin e menaxhimit.

Qëllimi kryesor i procesit të planifikimit të menaxhimit është mbrojtja strategjike afatgjate e pasurive kulturore. Pjesa e tij kryesore është hartimi i kornizës për vendimmarrje dhe menaxhimin e ndryshimeve të një pasurie kulturore të caktuar. Kur dokumentohet kjo kornizë, së bashku me qëllimet dhe aktivitetet e menaxhimit të cilat përcaktohen bashkërisht nga aktorët e përfshirë në menaxhimin e pasurisë kulturore, atëherë ajo quhet “plani i menaxhimit”. Në thelb, plani i menaxhimit është dokumenti i cili jep udhëzime, i zhvilluar në kuadër të sistemit të caktuar të menaxhimit, duke përshkruar njëkohësisht vetë atë sistem. Plani i menaxhimit është instrument i rëndësishëm për të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit (planifikimi, zbatim, monitorimi) të një pasurie kulturore dhe duhet periodikisht të përditësohet dhe të ripërtëritet.

### 4.1.2. Plani i menaxhimit

Plani i menaxhimit paraqet një mjet relativisht të ri i cili përcakton dhe vendos strategjinë, objektivat, aktivitetet dhe strukturat zbatuese përkatëse për menaxhim, dhe sipas nevojës, për zhvillimin e trashëgimisë kulturore në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme, me qëllim të ruajtjes së vlerave të tyre për përdorim në ditët e sotme por edhe në të ardhmen dhe për të qenë të vlerësuara. Plani i menaxhimit i harmonizon dhe i përputh nevojat e trashëgimisë kulturore me nevojat e “përdoruesve” të saj dhe organizmave përgjegjëse qeveritare dhe/ose atyre private/lokale.

Konteksti dhe karakteri i planeve të menaxhimit ndryshojnë dukshëm varësisht nga tipi i pasurisë. Për shembull, plani i menaxhimit për sitin arkeologjik ose qendrën urbane do të jetë shumë më i ndërlikuar sesa plani për një ndërtesë të veçantë. Gjithashtu, plani i menaxhimit varet nga lloji i sistemit të menaxhimit parësor. Plani duhet të sqarojë se si do të mirëmbahet vlera e jashtëzakonshme universale – OUV (ose OUV potencial në rastin e nominimit) përmes zbatimit të mbrojtjes dhe konservimit dhe të tregojë praktikisht efikasitetin e masave për arritjen e rezultateve të mbrojtjes në terren.

Siç është shpjeguar më parë, hartimi i planit të menaxhimit është rezultat i qasjes kolektive dhe pjesëmarrëse, dhe me këtë sigurohet(-en):

- Kur bëhet fjalë për Trashëgiminë Botërore, përkushtimi zyrtar për zbatimin e detyrave që rrjedhin nga Konventa mbi Trashëgiminë Botërore;

<sup>27</sup> UNESCO Qendra për Trashëgiminë Botërore. 2015. *Udhëzimet operative për zbatimin e Konventës mbi Trashëgiminë Botërore* (WHC.15/01 8. jul 2015)

- Mundësitë që të gjitha palët e interesuara<sup>28</sup>, posaçërisht pronarët dhe drejtuesit e pasurisë, të jenë të përfshirë dhe të arrijnë kuptimin e përbashkët të pasurisë, gjë e cila do të çonte deri tek mbështetja e fuqishme e planit;
- Përshkrimi i qartë i pasurisë si bazës për vlerësim të vlerave të saj, posaçërisht vlerës së jashtëzakonshme universale (OUV);
- Përshkrimi transparent i funksionimit të sistemit aktual të menaxhimit dhe mundësive për përmirësimin e tij;
- Deklarata mbi Vlerën e jashtëzakonshme universale të pasurisë, ashtu siç është dakortësuar ose propozuar Komitetit për Trashëgiminë Botërore, i cili i identifikon atributet që duhet të menaxhohen dhe kushtet e origjinalitetit dhe të integritetit që duhet të ruhen;
- Vlerësimi i vlerave të tjera të pasurisë, duke pasur parasysh se edhe ato duhet të merren në konsiderim gjatë procesit të menaxhimit;
- Shqyrtimi i gjendjes aktuale të pasurisë dhe faktorëve të ndryshëm që mund të kenë ndikim pozitiv ose negativ tek atributet, origjinaliteti dhe integriteti i saj;
- Vizioni kolektiv i menaxhimit të pasurisë (për shembull, si duhet të jetë ai për 20-30 vjet);
- Një sërë politikash drejtuese dhe/ose qëllimeve për realizim të këtij vizioni, për një periudhë prej zakonisht 5 vjetësh;
- Një sërë aktivitetesh (për konservim, interpretim dhe prezantim, kontributin në shoqëri, etj);
- Strategjia për zbatimin e planit, përfshirë edhe monitorimin edhe rishikimin;
- Integrimi, sipas nevojës, i planeve dhe sistemeve të ndryshme, duke u siguruar që ato të jenë bashkëplotësuese;
- Dobitë nga pasuria për shoqërinë, e cila, nga ana tjetër, siguron dobitë për pasurinë (përmirësimi i të gjitha vlerave, sigurimi i formave të reja të mbështetjes së komunitetit).

#### Plani i menaxhimit mund të:

- përshkruajë tërë sistemin e menaxhimit të pasurisë;
- sigurojë strukturën për analizimin e proceseve të ndërlukuara;
- sigurojë kornizën për marrje të vendimeve në bazë të njohurive dhe informacioneve dhe për menaxhimin e ndryshimeve;
- sigurojë parimet udhëheqëse për bashkërenditjen e aktiviteteve/përgjegjësi të menaxhimit të pasurisë;
- ndihmojë në bashkërenditjen e bashkëpunimit mes grupeve të ndryshme të interesit nga sektorët privat dhe publik;
- sigurojë planifikimin e kujdesshëm të ndërhyrjeve për mbrojtje të vlerës së jashtëzakonshme universale dhe vlerave të tjera dhe të sigurojë përputhshmërinë e tyre me mbrojtjen e vlerës së jashtëzakonshme universale;

<sup>28</sup> Në këtë kontekst, palët e interesuara mund të përfshijnë popullsinë lokale dhe autoktone, pronarët dhe drejtuesit e pasurisë, autoritetet e të gjitha niveleve, interesat e biznesit përfshirë këtu edhe turizmin, edhe organizatat joqeveritare.

- ndihmojë në racionalizmin e burimeve ekzistuese dhe të lehtësojë financimin.

Gjithashtu, plani duhet të pasqyrojë:

- pjesëmarrjen e palëve të interesuara kryesore dhe komunitetit të gjerë nga vetë fillimi i përgatitjes së nominimit, kuptimin e përbashkët të konceptit të Trashëgimisë Botërore dhe çfarë nënkupton përfshirja në Listën e Trashëgimisë Botërore kur bëhet fjalë për menaxhimin e pasurisë;
- kuptimin e përbashkët të sistemit ekzistues të menaxhimit (kornizës ligjore dhe rregulluese, strukturave drejtuese dhe qasjes tek menaxhimi), i planeve dhe politikave zhvillimore, si dhe shfrytëzimit aktual të pasurisë;
- kuptimin e përbashkët të vlerës së jashtëzakonshme universale, kushteve të origjinalitetit dhe integritetit, si dhe faktorëve që ndikojnë tek pasuria nga të gjitha palët e interesuara;
- përgjegjësinë dhe mbështetjen e përbashkët nga të gjitha palët e interesuara kur bëhet fjalë për qasjet tek menaxhimi dhe aktivitetet e nevojshme për ta ruajtur vlerën e jashtëzakonshme universale të pasurisë;
- qasjen përfshirëse të planifikimit, ndarjen e detyrave ndërmjet të gjitha organeve kompetente dhe palëve të interesuara për të vendosur një kornizë e realizueshme për marrjen e vendimeve që do të sigurojë menaxhimin e qëndrueshëm të pasurisë në të ardhmen;
- krijimin e strukturave të menaxhimit për zbatimin e planit dhe gatishmërinë e kapaciteteve për zbatimin e aktiviteteve të nevojshme të menaxhimit. Në këtë mënyrë plani do të jetë “mjet për realizimin e qëlli-

mit” (dhe jo qëllim në vetvete, çfarë mund të jetë rrezik për procesin e planifikimit).

Përmbajtja e planit duhet:

- të jetë e fokusuar tek mbrojtja e vlerës së jashtëzakonshme universale të pasurisë, njëkohësisht duke u marrë me çështjet e menaxhimit me rëndësi lokale;
- të sigurojë të dhënat kryesore mbi gjendjen e pasurisë, duke përfshirë edhe përshkrimin përkatës të pasurisë;
- të përshkruajë sistemin e menaxhimit: masat ligdhënëse dhe rregulluese, si dhe masat e mbrojtjes në nivelin e politikave, strukturat drejtuese dhe praktikat e menaxhimit të pasurisë (por ato që vërtetë zbatohen, e jo vetëm ato që vlejné si parim);
- të jetë e qasshme dhe lehtësisht e kuptueshme për të gjitha palët e interesuara, duke shmangur përdorimin e tepërt të zhargonit;
- të paraqesë vizionin dhe qëllimet e afatgjata për pasurinë e Trashëgimisë Botërore dhe aktivitetet e nevojshme për realizimin e këtyre qëllimeve;
- të paraqesë pozitën e planit të menaxhimit në raport me planet e tjera (të zhvillimit/konservimit) të cilët zbatohen në lidhje me pasurinë;
- të jetë e dobishme për edukim dhe zhvillim të qëndrueshëm;
- të marrë në konsiderim menaxhimin e rrezikut;
- të jetë strategjike në qasjen e vet: të përdoren mësimet e nxjerra nga aktivitetet e kaluara për ta parashikuar drejtimin e menaxhimit në të ardhmen;

- të përshkruajë se në të cilën mënyrë do të kryhet zbatimi, monitorimi dhe rishikimi i planit të sistemit të menaxhimit;
- të tregojë planin përfundimtar dhe rezultatet e tij të pritshme, që janë të lidhura drejtpërdrejtë me burimet e nevojshme.

Hartimi i planeve të menaxhimit përfshin dy detyra bashkëplotësuese: procesin (planifikimi dhe zhvillimi) dhe përmbajtjen (qëllimet dhe rezultatet e arritura – plani si mjet i menaxhimit).

## 4.2. *Procesi i planifikimit të menaxhimit (fazat e ndryshme)*

### 4.2.1. **Procesi i planifikimit të menaxhimit**

Kjo pjesë përshkruan disa faza të procesit të përgatitjes së planit të menaxhimit të pasurisë së Trashëgimisë Botërore.

Procesi është po aq i rëndësishëm sa edhe produkti i tij final për zhvillimin e kuptimit kolektiv të vlerës së jashtëzakonshme universale, për arritjen e konsensusit mes të gjitha palëve të interesuara dhe për ndarjen e përgjegjësisë për mbrojtjen e pasurisë. Plani është mjet për udhëheqjen e dialogut me palët e interesuara dhe për shqyrtimin e vazhdueshëm të mbrojtjes së vlerës së jashtëzakonshme universale dhe vlerave të tjera.

Procesi i planifikimit të menaxhimit mund të fillojë sipas njerit nga tre skenarët e ndryshme: 1. gjatë përgatitjes së nominimit, 2. për pasurinë që tashmë është e përfshirë, 3. gjatë shqyrtimit të planit të menaxhimit/master planit/planit ekzistues të konservimit. Sa i përket skenarit të parë, monitorimi sistematik i hapave të përshkruara në këtë pjesë do të ndihmojë gjatë plotësimit të Pjesëve 3.1 e, 4.5 dhe 6 të formatit për nominim.

Sa i përket skenarëve 2 dhe 3, disa prej hapave të përmendur këtu janë cekur më parë. Për shembull, Deklarata mbi vlerën e jashtëzakonshme universale tani paraqet pjesën e detyrueshme të procesit të nominimit, por për pasurinë që tashmë është e përfshirë në Listën e Trashëgimisë Botërore, ajo tashmë ekziston dhe nuk mund të ndryshohet.

Kur bëhet fjalë për rishikimin e planeve të menaxhimit, kryesore është që në mënyrë gjithëpërfshirëse të vlerësohen sukseset, dështimet dhe dobësitë e planit(-eve) ekzistues(e) dhe se do të punohet në drejtim të eliminimit të tyre.<sup>29</sup> Një numër i vogël i planeve të miratuara më herët ka qenë i bazuar në Deklaratën mbi vlerën e jashtëzakonshme universale të miratuar, për arsye se ajo nuk është kërkuar deri në vitin 2007; vetëm nga viti 2005 është vendosur kushti i integritetit në procesin e menaxhimit të pasurive kulturore të Trashëgimisë Botërore. Ndikimet e këtyre dy risive sigurisht se nuk mund të pasqyrohej tek planet e menaxhimit të mëparshëm.

Hartimi i planit të menaxhimit përbëhet nga fazat vijuese:

**FAZA I:** Përgatitja

**FAZA II:** Grumbullimi i të dhënave/informacioneve

**FAZA III:** Vlerësimi i rëndësisë/gjendjes

**FAZA IV:** Zhvillimi i përgjigjeve/propozimeve

Këto faza janë të përshkruara hollësisht në vijim. Procesi i planifikimit që ato përfaqësojnë mbështetet tek qasja e bazuar mbi vlera<sup>30</sup>:




Tabela 1. Qasja e bazuar mbi vlerat për planifikimin e menaxhimit të Trashëgimisë Botërore

Procesi i planifikimit i cili nevojitet në planifikimin e menaxhimit nuk është as proces linear e as hierarkik nga lart – poshtë (*top-down*) (si në diagramën në vijim), por është procesi rrethor si në skicën 2, kurse në rastin ideal është procesi i frekuentuar si në skicën 3, në të cilin çdo fazë vazhdimisht drejton tek fazat e mëparshme ose ato vijuese. Për shembull, gjatë vlerësimit të gjendjes së pasurisë mund të jetë e nevojshme kthimi tek faza e grumbullimit të të dhënave, për t'i grumbulluar informacionet e shtuara. Ky ndërveprim është ilustruar në diagramin e mëposhtëm.

Në anën tjetër, procesi i planifikimit është i lidhur fuqishëm me zbatimin dhe monitorimin, të cilat mund të zhvillohen paralelisht, për arsye se plani i menaxhimit nuk është dokumenti statik, por kërkon rishikim të vazhdueshëm. Zbatimi dhe monitorimi janë procese të ndara, por në diagram janë shënuar si numri 5 për të ilustruar lidhjen e tyre të vazhdueshme me procesin e planifikimit.

<sup>29</sup> *Managing Cultural World Heritage*. (World Heritage Resource Manual), Pjesa 4.5

<sup>30</sup> *Managing Cultural World Heritage*. (World Heritage Resource Manual), Pjesët 2 dhe 4.3




Diagram: Natyra e procesit të planifikimit. Burimi: UNESCO, ICCROM, ICOMOS dhe IUCN. 2013. *Managing Cultural World Heritage*. Paris. UNESCO World Heritage Centre. (World Heritage Resource Manual), fq. 128.

#### 4.2.2. FAZA I: PËRGATITJA

Kjo fazë duhet të shikohet si faza e para-planifikimit gjatë të cilës vendoset baza dhe arrihet konsensusi për qëllimet e procesit të planifikimit dhe për ata që duhet të përfshihen.

##### 4.2.2.1 Hapat përgatitorë

Hartimi i planit të menaxhimit duhet të miratohet nga institucioni kompetent dhe të mbështetet nga palët e interesuara kryesore të cilat do ta pranojnë miratimin e planit dhe do të mundësojnë zbatimin dhe përditësimin e tij. Gjithashtu, miratimi i planit mund të kërkojë leje nga pronari i pasurisë ose Komiteti për Trashëgiminë Botërore, ose vërtetim zyrtar të organizatave të ndryshme (qeveritare ose private) të bashkuara për këtë qëllim (në rastin e Trashëgimisë Botërore, me siguri si pjesë e procesit të nominimit).

Shumë shpesh një politikë në nivelin kombëtar çon deri tek miratimi i planit

të menaxhimit dhe urdhëron detyrën e hartimit të tij. Megjithatë, nxitja për inicim të procesit dhe hartimin e planit duhet të vijë nga niveli i pasurisë (ose nga niveli lokal kur bëhet fjalë për një grup të pasurive). Kjo është vendimtare për të siguruar pjesëmarrjen e barabartë të të gjitha palëve të interesuara dhe për të zhvilluar ndjenjën e pronësisë ndaj procesit dhe planit si rezultat i tij.

Aftësitë e menaxhimit të projekteve janë shumë të dobishme gjatë kësaj faze për ta përkufizuar drejtimin kryesor ose planin e procesit të planifikimit, dhe për ta kontrolluar kornizën kohore dhe buxhetin në kohën kur fillon procesi.

Gjatë kësaj faze duhet të caktohet një person ose ekip (në rast të pasurisë komplekse ose grupit të pasurive) të cilëve do t'iu besohet detyra e menaxhimit të "projektit" (do të thotë, procesi i menaxhimit të planifikimit).

#### 4.2.2.2 Kush e udhëheq procesin dhe e harton planin?

Organizata(t) udhëheqëse të sistemit parësor të menaxhimit<sup>31</sup>, në marrëveshje me të tjerët, duhet ta mbledhin ekipin me liderin i cili është i aftë të koordinojë aftësitë e ndryshme për të filluar procesin dhe për të përcaktuar burimet financiare, institucionale dhe njerëzore që nevojiten për hartimin e planit. Lideri i ekipit i koordinon aktivitetet e të gjithë tjerëve të përfshirë dhe paraqet forcën kryesore lëvizëse të hartimit të planit, duke i dhënë prioritet gjatë mbledhjeve ekipit ekspertëve nga vendi dhe/ose atyre që do ta kryejnë zbatimin e planit

Në disa vende angazhohen konsulentë të jashtëm të cilët e udhëheqin procesin. Në ato raste, roli i tyre duhet të jetë vetëm udhëheqja e procesit, me pjesëmarrje të të gjitha palëve të interesuara të cilat, gjithashtu, do të udhëheqin procesin dhe do të zhvillojnë ndjenjat e pronësisë mbi planin.. Kushtet e angazhimit të konsulentit ose përshkrimi i punës duhet të jenë të qarta. Ekipi i cili merret me hartimin e planit duhet ta njohë mirë sistemin ekzistues të menaxhimit i cili zbatohet në një pasuri (ose pasuritë) të caktuar. Në disa vende grupi drejtues e mbikqyr procesin e hartimit të planit të menaxhimit, zbatimit dhe rishikimit të tij.

#### KËSHILLA

Grupi drejtues i përbërë nga zyrtarët/et më të lartë të sistemit parësor të menaxhimit dhe të tjerëve të cilët janë të përfshirë në procesin e nominimit mund të promovojë progresin në hartimin e planit dhe të kërkojë mbështetjen e nevojshme.

#### 4.2.2.3 Ekipi i projektit dhe aftësitë e tij

Lideri i ekipit duhet të mbledhë grupin e punës i cili përbëhet nga anëtarët/et me njohuri dhe aftësi multidisiplinare, që në nivel kolektiv arrijnë të:

- kuptojnë kërkesat e Konventës mbi Trashëgiminë Botërore dhe të Komitetit për Trashëgiminë Botërore,
- kenë njohuritë e detajuara lokale për pasurinë dhe vlerave të tyre të trashëgimisë dhe njohjen e mirë të faktorëve që ndikojnë tek ato vlera,
- njohin sistemin e menaxhimit të trashëgimisë dhe sistemin specifik (ose disa sistemeve) që zbatohen për një pasuri të caktuar,
- kenë njohuri për pasurinë e caktuar, në kuptimin e konservimit teknik dhe zhvillimit historik të saj,
- njohin kornizën ligjore/rregulluese/politike brenda të cilave duhet të kryhet menaxhimi i pasurisë,
- njohin çështjet sociale dhe ekonomike të cilat ndikojnë tek pasuria, rrethi i saj dhe palët e interesuara (dhe se si pasuria ndikon tek çështjet sociale dhe ekonomike),
- kenë aftësinë e hartimit të programeve të aksioneve me përllogaritje të shpenzimeve,

<sup>31</sup> *Managing Cultural World Heritage*. (World Heritage Resource Manual), Pjesa 4.1

- kenë aftësitë e komunikimit efikas (me shkrim dhe me gojë),
- kenë ekspertizën në menaxhimin e informacioneve,
- kenë aftësitë e negociimit / avokimit publik dhe lehtësimit,
- kenë ndjeshmëri politike dhe aftësinë e ndërtimit të marrëdhënieve dhe mirëbesimit me njerëz të tjerë,
- kenë fleksibilitetin / tolerancën dhe gatishmërinë që t'i njohin nevojat e të tjerëve,
- aftësitë e menaxhimit të projektit,
- kenë njohuri te drejtpërdrejta të “përfituesve përfundimtarë” / bashkëveprimi me ta (për shembull vizitorët, komunitetet lokale).

Në fazën e para-planifikimit, lideri i ekipit, në marrëveshje me anëtarët/et të tjerë të grupit të punës dhe organet kompetente, duhet të vendosin për rëndësinë relative që do të kenë katër elementet kryesore të projektit: burimet (njerëzore dhe financiare), koha, cilësia dhe fusha – që ato të kanë mundësi të përshtaten kur të sqarohen objektivat e projektit. Këto elemente janë të ndërlidhura dhe ato duhet të menaxhohen në mënyrë efikase për të siguruar suksesin e procesit të planifikimit të menaxhimit. Faza e para-planifikimit së pari duhet të përshkruajë fushën e projektit (në këtë rast pasuria ose pasuritë ndaj të cilave i referohet procesi i menaxhimit dhe vështrimi fillestar i objektivave të cilat duhet të arrihen). Kur, përveç fushës së projektit, përcaktohen edhe afatet kohore dhe buxheti, mund të fillojë shpërndarja e burimeve njerëzore dhe financiare.

Prandaj, lideri i ekipit duhet të:

- a. përkufizojë fushën e aktiviteteve dhe të zhvillojë programin,
- b. vlerësojë se cilat aftësi janë të nevojshme,
- c. identifikojë palët e tjera të interesuara,
- d. përkufizojë tipin e procesit të konsultimeve (qasja pjesëmarrëse),
- e. përgatisë renditjen kohore,
- f. përcaktojë burimet financiare, njerëzore dhe teknike (pajisjet, etj.) që janë të nevojshme.

Grupi drejtues, i përbërë nga përfaqësuesit/et e palëve të interesuara kryesore, duhet të krijohet për të mbikqyrur proceset e planifikimit dhe të zbatimit. Kur bëhet fjalë për nominim për Trashëgiminë Botërore, grupi drejtues duhet të formohet para fazës së para-planifikimit.

Grupi drejtues është i nevojshëm për pasuritë që shtrihen jashtë një zone administrative (çfarë është çdoherë rasti me peisazhe kulturore ose pasuritë seriale) ose vendit (pasuritë ndërkufitare). Ai duhet të krijohet sa më parë dhe të hartohet kalendari i mbajtjes së takimeve dhe i konsultimeve të rregullta.

#### **4.2.2.4 Identifikimi i palëve të interesuara**

Palë e interesuar është çdo person ose organizatë tek e cila mund të ndikojë plani ose që mund të ndikojë tek sukcesi i planit. Palët e tjera të interesuara janë ato, e drejta e të cilave rrjedh nga ndonjë detyrim ose kërkesë ligjore. Ato mund të klasifikohen në katër kategori:

- aktorët e përfshirë në sistemin parësor të menaxhimit të pasurisë (institucionet në pronën e të cilave janë pasuritë kulturore dhe të cilat i menaxhojnë),
- pronarët privatë të pasurive,
- aktorët nga sistemet e tjera që sigurojnë mjetet sekondare për menaxhimin e trashëgimisë (për shembull këshilli bashkiak i cili e ka kompetencën juridike për kontrollimin e zonës së mbrojtur /buffer zone/),
- komunitetet dhe grupet e tjera të interesit.

#### **4.2.2.5 Rëndësia e bashkëpunimit me palët e interesuara**

Procesi i planifikimit të menaxhimit pa asnjë dyshim nënkupton njohjen e trashëgimisë dhe ndjenjën që trashëgimia “u takon” dhe i ndihmon palët e interesuara dhe agjencitë kompetente në mbrojtjen e pasurive. Puna me palët e interesuara ofron mundësinë për shkëmbimin e informacioneve dhe njohurive, rritjen e përkushtimit të tyre, zhvillimin e përgjegjësisë kolektive, si dhe marrjen e pëlqimit dhe mbështetjes së tyre për aktivitetet në lidhje me mbrojtjen dhe rritjen e vlerave të pasurisë, origjinalitetit dhe integritetit të saj.

Megjithatë, që ky proces përfshirës të jetë efikas, ai duhet të jetë i menaxhuar. Numri i palëve të interesuara mund të jetë shumë i madh, si për shembull në qendra urbane. Janë më shumë se shtatëqind pronarë të Murit të Hadrianit, si pjesës e pasurisë ndërnacionale të Trashëgimisë Botërore “Kufijtë e Perandorisë Romake”. Në raste të tilla, nga vetë fillimi i procesit nevojitet menaxhimi me përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara.

#### **4.2.2.6 Procesi pjesëmarrës**

Në qasjen pjesëmarrëse të gjitha palët e interesuara në nivele të ndryshme marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes. Gjatë fazës së para-planifikimit, ekipi drejtues duhet të zhvillojë strategjinë e cila do ta mundësojë këtë.

#### **4.2.2.7 Procesi marrjes së vendimeve**

Paralelisht me përfshirjen e numrit të madh të palëve të interesuara dhe sistemeve të tjera të menaxhimit është i domosdoshëm zhvillimi i mekanizmit të ri për marrjen e vendimeve, duke konsideruar se njëkohësisht sistemi parësor i menaxhimit mund ta udhëheqë atë proces. Gjatë kësaj faze përgatitore nevojitet të përkufizohet procesi shumë i qartë i marrjes së vendimeve dhe të përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë gjatë procesit të planifikimit dhe fazës së zbatimit.

### **4.2.3. FAZA II: GRUMBULLIMI I TË DHËNAVE/INFORMACIONEVE**

Grumbullimi i informacioneve mund të jetë një proces tejet i hapur, kështu që ato që janë të përfshirë në këtë proces nuk mund ta përballojnë lehtë. Prandaj, është me shumë rëndësi që në fillim fare të caktohen llojet e informacioneve të cilat janë të nevojshme, si do të përftohen ato dhe si do të menaxhohen. Informacionet janë të nevojshme për vlerësimin e vlerës dhe të vlerës së jashtëzakonshme universale të pasurisë, për identifikimin e attributeve të cilat i pasqyrojnë ato vlera, dhe për vlerësimin e origjinalitetit dhe integritetit. Llojet tjera të informacioneve do të nevojiten për vlerësimin e rëndësisë së vlerave të tjera për të cilat pasuria duhet të menaxhohet; për kuptimin dhe përkufizimin e pasurisë dhe për qëllim të planifikimit; dhe përfundimisht për vlerësimin e gjendjes fizike dhe të faktorëve të cilët mund të ndikojnë tek vlera e jashtëzakonshme universale dhe

tek vlerat e tjera. Këto informacione mund të përbëjnë bazën e monitorimit të ardhshëm. Gjithmonë mund të grumbullohen edhe informacione shtesë për marrjen e vendimeve gjatë fazave të mëvonshme të procesit të planifikimit të menaxhimit.

Disa nga këto informacione ndoshta grumbullohen gjatë përgatitjes së dosjes së nominimit ose do përfshihen në vlerësimin e nominimit nga ana e ICOMOS-it. Se sa informacionet e grumbulluara parapra-kisht do të jenë të dobishme për procesin e planifikimit të menaxhimit varet nga koha e cila ka kaluar nga përfshirja e pasurisë në Listën e Trashëgimisë Botërore.

#### **4.2.3.1 Burimet e mundshme të informacioneve**

Vetë pasuria është burimi i informacioneve. Grumbullimi i informacioneve mund të përfshijë grumbullimin e materialeve nga burimet ekzistuese ose kërkimin e informacioneve të reja (duke përfshirë zbatimin e studimit). Burimet ekzistuese mund të jenë: arkivat, studimet, evidencat ndërtimore, koleksionet muzeore, arkivat fotografike, agjencitë për mappinghartografi (shërbimet kombëtare për gjeodezi), bibliotekat, dokumentacioni për pasurinë, ministritë/agjencitë/organizatat dhe palët e interesuara (shpeshherë burimi i mirë i fotografive të vjetra, mes tjerash). Mund të përdoren edhe sistemet tradicionale të njohurive të palëve të interesuara.

Nevojat për informacione të reja mund të përfshijnë: mappingun e ri/hartografinë, studimet, matjet gjeofizike, evidencën ndërtimore, fotografitë (të thjeshta, të rektifikuara, etj.), inventarët e detajuar, punimin e bazës së të dhënave, matjet fizike (vizuale), studimet me shkrim ose me gojë të llojeve të ndryshme, intervistat dhe traditat gojore, porositjen e studimeve dhe kërkimeve të detajuara (për shembull studimet krahasuese).

#### **4.2.3.2 Lista kryesore e kontrollit**

Këto informacionet janë minimumi i domosdoshëm:

1. Informacionet e nevojshme për vlerësimin e vlerës (potenciale) së jashtëzakonshme universale, origjinalitetit, integritetit dhe vlerave të tjera të pasurisë;
2. Informacionet për gjendjen fizike (ndikimet e faktorëve të ndryshme, rreziqet dhe cenueshmëria)
3. Informacionet për kufijtë dhe mjedisin rrethues (duke përfshirë qëllimin e trullit fqinjë dhe aktivitetet dhe planet zhvillimore);
4. Informacionet e përgjithshme <sup>32</sup>.

<sup>32</sup> *Managing Cultural World Heritage*. (World Heritage Resource Manual), Pjesa 4, checklist

**Pjesa 1 – Informacionet e nevojshme për vlerësimin e vlerës (potenciale) së jashtëzakonshme universale, origjinalitetit, integritetit dhe vlerave të tjera të pasurisë**

Temat	Burimet
Vlerat, rëndësia dhe historia	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Burimet e shkruara / traditat gojore</li> <li>▪ Fotografitë</li> <li>▪ intervistat / bashkëbisedimet me palët e interesuara</li> <li>▪ Krahasimi me shembuj ndërkombëtarë</li> <li>▪ Analizat e zbatuara në të kaluarën, zakonisht arkeologjike ose analizat e ndërtesave</li> <li>▪ Krahasimi i hartave (map regression)</li> <li>▪ Sistemet tradicionale të njohurisë</li> </ul>
Përdorimi(-et) aktual(e) të pasurisë	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Hartat ose planet e qëllimit të truallit</li> <li>▪ Përshkrimet e shkruara</li> <li>▪ Informacionet për pronësinë ekzistuese, duke përfshirë pronarët autoktonë dhe tradicionalë</li> <li>▪ përdorimet e ndryshme – ritualet, doket, etj.</li> </ul>
Pikëpamjet e palëve të interesuara dhe çfarë është e me rëndësi për ata	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Nga intervistat, bashkëbisedimet me palët e interesuara</li> </ul>

Mund të tregohet si i nevojshëm grumbullimi i informacioneve dhe fillimi i vlerësimit të vlerës së jashtëzakonshme universale potenciale ndërkohë që janë duke u grumbulluar informacionet e tjera. Në këtë mënyrë do të jetë më lehtë të njihen atributet e rëndësishme të cilat i pasqyrojnë ato vlera dhe të përkufizohen origjinaliteti dhe integriteti, sipas të cilave duhet të zbatohet vlerësimi i gjendjes fizike të attributeve, origjinalitetit dhe integritetit, si dhe i ndikimeve që pasqyrohen ndaj tyre.

Gjatë vlerësimit të gjendjes përcaktohen ndikimet pozitive dhe negative, vijuese dhe ato të ardhshme dhe burimi i tyre, pa marrë parasysh a është ndikimi tek vetë pasuria apo jashtë saj (shiko poshtë).

## Lista e kontrollit për grumbullimin e informacioneve

### Pjesa 2 – Informacionet për gjendjen fizike (ndikimet e faktorëve të ndryshme, rreziqet dhe cenueshmëria)

Temat	Burimet
<b>Gjendja e të ruajturit – ndikimet tek materialet (prishje, etj.), konstruksionet (deformimet, etj.), sitet (peisazhet, funksionet)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Evidenca vizuale</li> <li>▪ Studimet shkencore</li> <li>▪ Praktikrat ekzistuese të përcjelljes</li> <li>▪ Të dhënat për konservimin e mëparshëm</li> </ul>
<b>Gjendja e të ruajturit – Faktorët të cilët ndikojnë tek trashëgimia dhe ndikimet e tyre</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Disa faktorë të mundshëm ndikojnë tek trashëgimia (ndërtimet dhe ndërtimtaria, infrastruktura transportuese, infrastruktura komunale, ndotja, përdorimi/modifikimi i burimeve biologjike, shfrytëzimi i burimeve fizike, kushtet lokale që ndikojnë tek shtresa fizike, shfrytëzimi i trashëgimisë për qëllime sociale/kulturore, aktivitetet e tjera të njeriut, speciet pushtuese/të huaja ose speciet tejet të përhapura, menaxhimi dhe faktorët institucionalë, ndryshimet klimatike dhe kushtet ekstreme të motit, ngjarjet e papritura ekologjike dhe gjeologjike</li> <li>▪ Studimet, raportet, planet e zhvillimit, studimet ndërkombëtare, për shembull burimet e informacioneve për ndikimet (potenciale) të fatkeqësive: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të dhënat për fatkeqësitë në të kaluarën e afërt dhe të largët dhe rreziqet ekzistuese / kërcënimet</li> <li>- Informacionet për ndryshimet potenciale që mund të sjellin deri tek fatkeqësitë</li> <li>- Informacionet për planet ekzistuese për zbutjen e rrezikut dhe menaxhimin e fatkeqësive në lidhje me trashëgiminë dhe në përgjithësi</li> <li>- Informacionet për agjencitë përgjegjëse për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë</li> <li>- Informacionet për praktikrat vijuese të monitorimit të rrezikut nga fatkeqësitë</li> </ul> </li> </ul>
<b>Gjendja e të ruajturit , Aktivitetet aktuale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Qasjet ekzistuese, planet (për konservim, master-planet) raportet me shkrim</li> <li>▪ Aktivitetet vijuese të konservimit</li> <li>▪ Praktikrat tradicionale nëse përdoren</li> </ul>

<b>Praktikat e interpretimit, prezantimit dhe menaxhimit të vizitës</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Raportet për qasjet ekzistuese/planet për interpretimin dhe menaxhimin e vizitës</li> <li>▪ Përmbajtjet ekzistuese për turistët (shitja e biletave, pijeve freskuese tualetet, etj.)</li> <li>▪ Studimi për perceptimin e vizitorëve, ndikimet e tyre</li> <li>▪ Mjetet e qasshme edukative</li> <li>▪ Propozimet ekzistuese për përmirësim</li> </ul>
<b>Monitorimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Politikat, procedurat ekzistuese</li> </ul>

## Lista e kontrollit për grumbullimin e informacioneve

### Pjesa 3 – Informacionet për kufijtë dhe mjedisin rrethues (duke përfshirë qëllimin e truallit fqinjë dhe aktivitetet dhe planet zhvillimore);

Tema	Burimet
<b>Kufijtë dhe karakteristikat fizike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ hartat dhe planet e pasurive dhe mjedisit të tyre rrethues</li> <li>▪ Vizatimet arkitekturore dhe arkeologjike (nëse është e zbatueshme)</li> <li>▪ Fotografitë nga ajri</li> <li>▪ Ligjet në fuqi në fushën e trashëgimisë dhe planifikimit</li> <li>▪ Instrumentet e tjera planifikuese që ndikojnë tek pasuria</li> <li>▪ Të dhënat mbi pronën autoktone</li> </ul>
<b>Instrumentet e tjera të planifikimit të lidhura me pasurinë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Planet e qëllimit të truallit</li> <li>▪ Planet e zonimit</li> <li>▪ Programet infrastrukturore</li> <li>▪ Plani i shfrytëzimit të burimeve / eksploatimi i mineraleve, etj./ shfrytëzimi bujqësor / autokton</li> </ul>
<b>Planifikimi dhe aktivitetet zhvillimore në nivelet lokale, rajonale dhe kombëtare</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Aktivitetet e planifikimit dhe rregullat në fuqi në nivelin komunal ose rajonal, për shembull planet e qëllimit të truallit përreth</li> <li>▪ Planet e nxjerrjes së mineraleve dhe burimeve të tjera</li> <li>▪ Planet e mbrojtjes së mjedisit</li> <li>▪ Planet zhvillimore lokale, rajonale dhe kombëtare</li> <li>▪ Rregullat ligjore të lidhura me aktivitete të caktuara, për shembull bujqësinë</li> <li>▪ Zhvillimi i infrastrukturës</li> </ul>

## Lista e kontrollit për grumbullimin e informacioneve

Pjesa 4– Informacionet e përgjithshme	
Temat	Burimet
<b>Kornizat ekzistuese ligjvënëse dhe institucionale, proceset e planifikimit, burimet, si ato të qasshme ashtu dhe ato potenciale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të gjitha instrumentet që ndikojnë tek pasuria (kombëtare, krahinore, lokale dhe ato që i referohen vetë pasurisë)</li> <li>▪ Skema organizative (në nivele të ndryshme)</li> <li>▪ Përshkrimi me shkrim i procesit të vendimmarrjes dhe planifikimit</li> <li>▪ Përshkrimet e punës të personave përgjegjëse</li> <li>▪ Burimet njerëzore, financiare, intelektuale që janë në dispozicion</li> <li>▪ Buxhetet vjetore</li> <li>▪ Buxhetet e detajuara për sektorët e caktuar</li> <li>▪ Informacionet për projektet jashtë-buxhetore</li> <li>▪ Informacionet për burimet e financimit në të kaluarën</li> <li>▪ Informacionet për praktikat ekzistuese të monitorimit</li> <li>▪ Detyrat ekzistuese dhe kontributi i palëve të interesuara</li> <li>▪ Detyrat potenciale dhe kontributi i palëve të interesuara</li> <li>▪ Problemet ose çështjet e tjera që janë të lidhura me palët e interesuara</li> <li>▪ Të dhënat për shërbimet speciale që merren me Trashëgiminë Botërore, në rast se ekzistojnë</li> </ul>
<b>Elementet e sistemeve tradicionale të menaxhimit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të dhënat e shkruara (parimet, metodat e monitorimit përmes tabuve, etj.)</li> <li>▪ Traditat gojore</li> <li>▪ Metodat e grumbullimit të të dhënave për marrje të vendimeve</li> <li>▪ Lidhja me sistemet më të mëdha administrative në nivelin kombëtar dhe/ose rajonal</li> <li>▪ (Gjatë grumbullimit të të dhënave për disa prej këtyre temave mund të vijnë deri tek ballafaqimi me kufizime)</li> </ul>
<b>Elementet e dobisë ekonomike dhe shoqërore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Burimet që mund të sigurojnë dobitë ekonomike/ shoqërore siç është punësimi potencial</li> </ul>

## 4.2.4. FAZA III: VLERËSIMI I RËNDËSISË/GJENDJES

Kjo fazë nënkupton vlerësimin e vlerës së jashtëzakonshme universale (nëse një gjë e tillë nuk është bërë më parë), vlerave dhe attributeve të tjera të cilat pasqyrojnë ato vlera, si dhe origjinalitetit dhe integritetit të këtyre attributeve. (Hapi vijues do të jetë vlerësimi i gjendjes dhe përcaktimi i çështjeve kryesore të menaxhimit).

### 4.2.4.1 Vlerësimi i vlerave

Vlerësimi i rëndësisë<sup>33</sup> duhet të përfshijë vlerësimin e vlerave të cilat përshkruajnë vlerën e jashtëzakonshme universale potenciale, si dhe vlerave të tjera që nuk duhet të jenë pjesë e vlerës së jashtëzakonshme universale, por të cilat duhen ruajtur.

Ky proces përbëhet nga dy hapa: (1) vlerësimi i vlerës së jashtëzakonshme universale dhe përkufizimi i deklaratës për vlerën e jashtëzakonshme universale me të cilën identifikohen atributet të cilët e pasqyrojnë vlerën e jashtëzakonshme universale, si dhe origjinaliteti dhe integriteti i tyre; dhe (2) vlerësimi i vlerave të tjera dhe identifikimi i attributeve që i pasqyrojnë. Vlerësimi i vlerës duhet të bëhet në bashkëpunim me palët e interesuara përkatëse.

Siç është thënë më parë, për vlerësimin e vlerës së jashtëzakonshme universale përdoret qasja e ruajtjes dhe menaxhimit të trashëgimisë e bazuar tek vlerat (për vlerësim të vlerës së jashtëzakonshme universale shiko *Doracakun e nominimit*).

### 4.2.4.2 Deklarata mbi vlerën e jashtëzakonshme universale (Statement of Outstanding Universal Value - SOUV)

Nëse nuk është miratuar, duhet të përpilohet "deklarata mbi vlerën e jashtëzakonshme universale", e bazuar mbi vlerën e jashtëzakonshme universale dhe kushtet e origjinalitetit dhe integritetit. Ajo do të jetë pikënisja kryesore për mbrojtje efikase dhe menaxhim të pasurisë në të ardhmen<sup>34</sup>. Deklarata mbi vlerën e jashtëzakonshme universale i identifikon atributet mbi të cilat është e mbështetur vlera e jashtëzakonshme universale si dhe kushtet e origjinalitetit dhe integritetit që duhen ruajtur.

### 4.2.4.3 Vlerat e tjera dhe Deklarata mbi rëndësinë (Statement of Significance)

Deklarata mbi vlerën e jashtëzakonshme universale mbështetet mbi vlerën e jashtëzakonshme universale, por pasuritë zakonisht kanë edhe vlera të tjera, si ato që i bëjnë trashëgimi, ashtu edhe të tjera (siç janë ekonomike, sociale, ekologjike) të cilat janë të rëndësishme në nivelet lokale, rajonale madje edhe kombëtare. Nuk është praktike që atributet të cilët e pasqyrojnë vlerën e jashtëzakonshme universale të menaxhohen ndarazi nga atributet që i mbajnë vlerat tjera, sepse kjo mund të sjellë që t'u jepet përparësi vlerave të para në krahasim me vlerat e dyta, në rast të krijimit të një konflikti potencial mes tyre.

Kur është fjala për vlerat sociale dhe ekonomike, nëse, për shembull, shfrytëzohet trualli i pasurisë duhet të merren në konsideratë interesat e bujqve për të me-

<sup>33</sup> *Managing Cultural World Heritage*. (World Heritage Resource Manual), Pjesa 3

<sup>34</sup> *Managing Cultural World Heritage*. (World Heritage Resource Manual), Pjesa 3 dhe *Nomination Manual*

naxhuar bujqësinë. Edhe nëse theksi i këtij doracakut është tek mbrojtja e vlerës së jashtëzakonshme universale, organet kompetente të cilët i hartojnë planet e menaxhimit duhet të përpilojnë deklaratën gjithëpërfshirëse për rëndësinë (Statement of Significance) e cila e përfshin vlerën e jashtëzakonshme universale, si dhe vlerat e tjera dhe ta përdorin si bazë për menaxhimin e pasurisë.

#### 4.2.4.4 Vlerësimi i gjendjes

Pasi identifikohen atributet, origjinaliteti dhe integriteti, hapi vijues është vlerësimi i faktorëve të ndryshëm të cilët ndikojnë tek ata, si pozitivisht, ashtu edhe negativisht. Kjo procedurë është e njohur si “vlerësimi i gjendjes”. Qëllimi i saj është përcaktimi i faktorëve të ndryshëm të cilët ndikojnë tek atributet, origjinaliteti dhe integriteti, për t’i menaxhuar këta faktorë në mënyrë afatgjatë. Qëllimi i dytë është që të identifikohen dhe të sigurohen dobisht të cilat komunitetet lokale dhe shoqëria në përgjithësi mund të kanë nga trashëgimia dhe vlerat tjera të ndërlydhura. Vlerësimi i gjendjes i identifikon problemet të cilët do të shfaqen dhe ndihmon që të përkufizohen qëllimet e ardhshme (ka ndonjëherë të përcaktuar si “politikat”) dhe aktivitetet e menaxhimit.

Organizmat këshillëdhënëse dhe Qendra për Trashëgiminë Botërore, në konsultim me disa shtete që i janë bashkuar Konventës mbi Trashëgiminë Botërore dhe organet kompetente për menaxhim të pasurive, kanë përpiluar listën e faktorëve që mund të ndikojnë tek pasuria (kjo punë, e kryer në kuadër të procesit të Raportimit të Dytë Periodik, që ka filluar në vitin 2009). Në këtë listë janë cekur faktorët kryesorë dhe një numër i caktuar i nënfaktorëve për secilin prej tyre.

Ndërtimet dhe ndërtimtaria  
Infrastruktura transportuese  
Infrastruktura komunale  
Ndotja  
Shfrytëzimi/modifikimi i burimeve biologjike  
Nxjerrja e burimeve fizike  
Kushtet lokale që ndikojnë tek shtresa fizike  
Shfrytëzimi i trashëgimisë për qëllime sociale/kulturorë  
Aktivitetet e tjera të njeriut  
Ndryshimet klimatike dhe kushtet ekstreme të motit  
Ngjarjet e papritura ekologjike dhe gjeologjike  
Speciet pushtuese/të huaja ose speciet tejet të shpërndara  
Menaxhimi dhe faktorët institucionalë  
Faktorë të tjerë

Në Pjesën 4 të formularit të nominimit janë cekur vetëm disa nga këta faktorë, por për ta hartuar planin e menaxhimit është e domosdoshme të merret në konsideratë spektri më i gjerë i mundshëm i faktorëve që ndikojnë tek pasuria e caktuar.

Në këtë fazë nevojitet të vlerësohen ndikimet e faktorëve të ndryshëm tek pasuria, dhe të identifikohen edhe kërcënimet edhe mundësitë. Duhet të shqyrtohen shkaqet ose burimet që mund të ndikojnë edhe tek trashëgimia edhe tek komuniteti. Është e zakonshme të shikohen ndikimet negative tek trashëgimia të cilat janë të shkaktuara nga faktorë të ndryshëm, por nuk ndikojnë të gjithë faktorët negativisht. Prandaj duhet të shqyrtohen edhe ndikimet pozitive. Për shembull, turizmi mund të ketë ndikimin serioz tek atributet (për shembull dëmtimi si pasojë e përdorimit) dhe tek rrethi sakral i kishës ose tempullit që ndoshta është identifikuar si aspekti i rëndësishëm i origjinalitetit të tyre. Megjithatë, në disa raste, është e

dobishme të krijohen të ardhura të cilat janë shumë të nevojshme për mirëmbajtjen e atyre pasurive. Në mënyrë të ngjashme, përshtirëria e rrethit sakral mund të ketë një ndikim pozitiv tek komuniteti. Menaxhimi dhe faktorët institucionalë gjithashtu mund të kenë ndikimet negative ose pozitive. Për shembull, politika e përshtatshme, rregullat dhe burimet për mbrojtje mund të ndikojnë pozitivisht tek trashëgimia, ndërsa mungesa e tyre mund të ndikojë negativisht. Nëse institucioni nuk ka vullnet ose nuk e ka fuqinë e mjaftueshme për t'i përfshirë komunitetet, vendimet do të marrin ekspertët në mënyrë të njëanshme, dhe ato me siguri do të ndikojnë negativisht tek komunitetet. Nëse vendimet e lidhura për çështjet e përditshme i merr autoriteti qendror në kryeqytet, punonjësi përgjegjës për një pasuri të largët do të ballafaqohet me vështirësi në punën e vet.

Njëkohësisht, përveç ndikimeve ekzistuese, duhet të vlerësohen edhe ato potenciale. Në këtë moment, turizmi nuk do të ndikojë negativisht, por me fitimin e statusit të Trashëgimisë Botërore mund të ketë rritje të konsiderueshme të tij, dhe potencialisht kjo mund të ketë ndikime negative dhe/ose pozitive në të ardhmen. Nuk është e mundur gjithmonë të parashikohen ndikimet potenciale të turizmit, por ato duhet të shqyrtohen. Gjithashtu, nuk është e thënë se të gjitha ndikimet do të krijohen tek vetë pasuria; për shembull, ndërtimi i hotelit në një vend drejtpërdrejtë me kufirin e pasurisë mund të ndikojë negativisht tek aspektet vizuale, ndërsa, për shembull, propozimet për interpretim të sitit mund të ndikojnë negativisht tek shtresat arkeologjike që ndodhen nën të.

Identifikimi i këtyre faktorëve dhe nënfaktorëve të ndryshëm që ndikojnë tek trashëgimia ka çuar në hartimin e formula-

rit vijues qëllimi i të cilit është të ndihmojë në vlerësimin e gjendjes:

Faktori kryesor:

3.8 Shfrytëzimi i trashëgimisë për qëllime sociale dhe kulturore

Nënfaktorët:

3.8.1 – Shfrytëzimi për qëllime rituale/shpirtërore/fetaredhe shoqëruese

3.8.2 – Vlerësimi i trashëgimisë nga ana e komunitetit

3.8.3 – Gjuetia tradicionale, mbledhja dhe grumbullimi

3.8.4 – Ndryshimet e mënyrës tradicionale të jetesës dhe sistemit të njohurive

3.8.5 – Identiteti, lidhshmëria sociale, ndryshimet e popullsisë dhe komuniteteve lokale

3.8.6 – Ndikimet e turizmit/vizitorëve/argëtimit

3.8.1 Shfrytëzimi për qëllime rituale/shpirtërore/religjioze dhe shoqëruese							
Emri		Ndikimi				Origjina	
		Pozitiv	Negativ	Ekzistues	Potencial	Brenda	Jashtë
3.8.1	Shfrytëzimi për qëllime rituale/ shpirtërore/ fetare dhe shoqëruese						

3.8.2 Vlerësimi i trashëgimisë nga ana e komunitetit							
Emri		Ndikimi				Origjina	
		Pozitiv	Negativ		Pozitiv	Negativ	
3.8.2	Vlerësimi i trashëgimisë nga ana e komunitetit						

Tabela 2. Formulari i cili përdoret në procesin vijues të Raportimit Periodik për t'i vlerësuar faktorët që ndikojnë tek trashëgimia

Nëse përdoret apo jo një formular i këtillë, është e domosdoshme të vlerësohen ndikimet tek trashëgimia dhe të identifikohen si kërcënimet ashtu dhe mundësitë që të zbulohen gjatë analizës. Ato mund të jenë vendimet sasiore ose cilësore ose kolektive të të palëve të interesuara. Mjetet siç janë analiza SWOT (“Strengths – Fuqitë, Weaknesses – Dobësitë, Opportunities – Mundësitë dhe Threats – Kërcënimet”) përdoren për këto qëllime. Ato ndihmojnë që të veçohen çështjet kryesore të cilat duhet të trajtohen si prioritare dhe aktivitetet e menaxhimit që duhet të ndërmerren. Kjo është shpjeguar në fazën e katërt.

Disa nga çështjet e zakonshme u referohen temave vijuese:

- Menaxhimi (struktura, burimet njerëzore, financat)
- Planifikimi dhe dizajni urban

- Infrastruktura
- Konservimi
- Mirëmbajtja
- Përdorimi
- Situata sociale dhe ekonomike
- Interpretimi i sitit
- Menaxhimi i vizitave
- Rreziqet dhe kërcënimet e shkaktuara me ndikime natyrore dhe të njerëzve (menaxhimi i rrezikut nga fatkeqësitë)
- Marrëdhëniet me komunitetin
- Vizitorët specialë
- Zbatimi dhe përcjellja
- Studimi
- Çështjet specifike të lidhura me Trashëgiminë Botërore

## 4.2.5. FAZA IV: ZHVILLIMI I PËRGJIGJEVE/PROPOZIMEVE

Për të zhvilluar propozimet e përgjigjeve, pasuria duhet të shikohet në kontekstin e saj të përgjithshëm dhe të parashikohet e ardhmja e saj afatgjatë, ndoshta si pasuri potenciale në Listën e Trashëgimisë Botërore (nëse tashmë nuk është). Vizioni se si do duhet të jetë pasuria për 20-30 vjet mund të jetë pikënisja e dobishme. Deklarata mbi vizionin mund të jetë bazë për përpunimin e politikave të menaxhimit, planeve vjetore të punës dhe strategjisë së zbatimit. Programi për rishikimin e planit duhet të përpunohet në bashkëpunim me palët e interesuara.

### 4.2.5.1 “Deklarata mbi vizionin”

Deklarata mbi vizionin përshkruan se si do të duket pasuria për 20-30 vjet dhe hapat e nevojshme për ta ruajtur vlerën e jashtëzakonshme universale të pasurisë dhe vlerat e tjera të saj, për të arritur që dobitë nga menaxhimi i pasurisë të përcillen tek tërë komuniteti dhe për të siguruar kontributin pozitiv për zhvillimin e qëndrueshëm. Deklarata mbi vizionin duhet të jetë rezultat i kontributit të përbashkët të të gjitha palëve të interesuara dhe që të paraqesin bazën për hartimin e objektivave dhe planit të aksionit. Nëse është e nevojshme, së bashku me vizionin duhet të përpilohen ose madje edhe të ndryshohen “parimet kryesore” më të plota, në bazë të cilave do të përcaktohen objektivat.

### 4.2.5.2 Objektivat

Hapi vijues është që të zhvillohen objektivat ose “rezultatet”<sup>35</sup> të cilat do të ndihmojnë në realizimin e vizionit përmes së cilës

<sup>35</sup> *Managing Cultural World Heritage*. (World Heritage Resource Manual), Pjesa 4.4

do të mbrohet vlera e jashtëzakonshme universale dhe do të sigurohen dobitë për shoqërinë. (Disa i quajnë më gjerë “politikë” në kuadër të të cilave përpunohen aktivitetet).

Objektivat i mbështesin, përpunojnë dhe i transponojnë aspektet e Deklaratës mbi vizionin për t’iu përgjigjur pyetjeve kryesore që janë të përcaktuara në Pjesën 4<sup>36</sup>. Objektivat duhet të jenë “TË MENÇURA” (SMART): specifike (Specific), të matshme (Measurable), të arritshme ose të realizueshme (Attainable or Achievable), relevante (Relevant), dhe që mund të gjurmohen ose që të jenë të kufizuara me afate kohore (Trackable or Time-bounded).

### 4.2.5.3 Plani i veprimit

Hapi vijues është hartimi i planit të veprimit cili duhet të përcaktojë mënyrën se si do të realizohen objektivat përmes serisë së aktiviteteve specifike që rezultojnë me prodhime ose shërbime. Këto rezultatet e prekshme janë të njohura si përfundime/rezultate<sup>37</sup>. Plani i veprimit duhet të përkuftizojë rezultatet në kuptimin e buxhetit, aktorëve përgjegjës për zbatimin, kohës që nevojitet për çdo aktivitet, burimeve të tjera të nevojshme (njerëzore, intelektuale, organizative dhe pajsive) dhe renditjes së zbatimit të aktiviteteve. Me fjalë tjera, plani i veprimit paraqet rastin kryesor për të përcaktuar prioritetet e aktiviteteve dhe të shfrytëzohen më mirë burimet që janë në dispozicion. Plani i veprimit përcakton objektivat, rezultatet dhe treguesit në bazë të të cilëve mund të matet suksesi apo dështimi, dhe duhet të mbajë aktivitetet vjetore dhe ato afatgjata.

<sup>36</sup> *Managing Cultural World Heritage*. (World Heritage Resource Manual)

<sup>37</sup> *Managing Cultural World Heritage*. (World Heritage Resource Manual), Pjesa 4.4

Plani i veprimit mund të jetë një sërë strategjish ose planesh, siç është plani i menaxhimit të vizitës, plani i konservimit, plani i menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë ose plani i monitorimit. Ato mund të ndihmojnë që të jepen përgjigjet për Pjesët 4, 5 dhe 6 të formatit të nominimit.

#### 4.2.5.4 Plani i zbatimit

Faza e mëparshme ka qenë e fokusuar tek hartimi i vizionit, objektivave (rezultateve) dhe përcaktimi i serisë së aktiviteteve për të arritur rezultatet. Faza e rëndësishme vijuese e procesit të planifikimit të menaxhimit është zbatimi i aktiviteteve<sup>38</sup>.

Është më mirë që zbatimi t'i besohet ndonjë shërbimi ekzistues në kuadër të organizatës e cila është kompetente për të kryer zbatimin e planit. Në disa raste formohen edhe shërbimet e reja. Nëse pasuria është e madhe dhe/ose e ndarë mes numrit të madh të palëve të interesuara, ky shërbim mund të jetë më shumë i fokusuar tek bashkërenditja sesa tek udhëheqja e procesit të zbatimit. Në fillim shërbimi duhet të rishqyrtojë dhe të riorganizojë procesin e vendimmarrjes me qëllim që të :

- gjendet lideri i fuqishëm ose koordinatori me autorizime të nevojshme,
- vendoset mekanizmi i bashkërenditjes së organizatave të kyçura (komponentëve të ndryshme në rastin e pasurisë seriale, ose shteteve kur është fjalë për pasurinë ndërkufitare),
- fitohet leja nga pronarët/organizata(t) relevante,
- identifikohen dhe të shpërndahen burimet,

- identifikohen ekspertët, zbatuesit dhe furnizuesit e përshtatshëm,
- identifikohen mënyrat e përshtatshme të prokurimit për ta siguruar angazhimin transparent dhe efikas, duke respektuar parametrat e cilësisë, çmimit dhe kohës për çdo aktivitet,
- sigurohet që marrëdhëniet kontraktuese, pas përzgjedhjes së ekspertëve, zbatueseve dhe/ose furnizueseve, në mënyrë të përshtatshme të mbrojnë porositetin dhe interesat e gjera të palëve të interesuara të lidhura për sitin<sup>39</sup>,
- zbatohet qasja e strukturuar raportimit dhe takimeve të ekipeve, pas angazhimit të stafit dhe pas aktiviteteve fillestare, për të arritur bashkërenditjen dhe rezultatet sa më të mira,
- miratohet politika komunikuese që do të sigurojë informimin e mirë të të gjitha palëve të interesuara dhe grupit drejtues (nëse ekziston),
- mbahen lidhjet me organet kombëtare përgjegjëse për bashkëpunimin ndërkombëtar (për shembull me Qendrën për Trashëgiminë Botërore),
- fillojë monitorimi i gjendjes së ruajtjes, si dhe zbatimi i planit.

Plani i veprimit duhet të përmbajë planin vjetor të punës.

Lloji i shërbimit për zbatim do të ndryshojë nëse ekziston spektri i larmishëm i aktorëve të lidhur për pasurinë me komponentë seriale ose pasuritë e mëdha siç janë qendrat urbane ose peisazhet kulturore.

<sup>38</sup> *Managing Cultural World Heritage. (World Heritage Resource Manual), Pjesa 4.3*

<sup>39</sup> *Managing Cultural World Heritage. (World Heritage Resource Manual), Pjesa 2*

Mund të emërohet menaxheri vetëm për të kryer bashkërenditjen e palëve të interesuara, ndërsa menaxhimi i përditshëm kalon tek organizatat e ndryshme dhe liderët e tyre.

#### 4.2.5.5 Monitorimi në kontekstin e planit të menaxhimit

Monitorimi është një hap themelor në procesin e menaxhimit sepse siguron informacionet e domosdoshme për shqyrtim, përshtatje dhe përditësim të aktiviteteve të menaxhimit. Plani i monitorimit është dokumenti i cili përfshin strategjinë e miratuar për matje të:

- a) përparimit, dhe
- b) rezultateve të planit të menaxhimit, që organet e menaxhimit të jenë të njoftuara për situatën në sit, *se sa shumë* nga programi i planifikuar (aktivitetet dhe rezultatet e tyre) është realizuar, dhe *se sa efikas* ka qenë zbatimi (rezultatet). Me fjalë tjera, gjatë monitorimit matet zbatimi i planit të menaxhimit në kuptimin sasior dhe cilësor, prej të cilave kjo e dyta i referohet ruajtjes së vlerës së jashtëzakonshme universale.

Përveç kësaj, nevojitet që të zhvillohen treguesit në bazë të të cilëve mund të maten ndryshimet<sup>40</sup>. Rezultatet dhe informacionet që kanë rrjedhur nga këto vlerësime janë shumë të rëndësishme për rishikimet ose ndryshimet e planit në të ardhmen.

Matja e përparimit të planit në fazën e zbatimit të tij i siguron informacionet nëse plani i menaxhimit funksionon dhe nëse zbatohet në përputhje me kohën dhe buxhetin e parashikuar me plan (vlerësimi i rezultateve). Me atë testohet efikasiteti i menaxherit dhe i planit. Vlerësimi i ob-

jektivave të arritura është testi i vërtetë i efikasitetit të menaxhimit.

Monitorimi është instrument për vëzhgim, grumbullim të informacioneve dhe matje të shkallës së përparimit; ai nuk është qëllim në vetvete, por mjet për të arritur qëllimin. Monitorimi është pjesë kryesore dhe e përhershme e procesit të menaxhimit dhe përdoret për matje dhe planifikim të ndryshimeve, duke mundësuar përshtatjen e politikave të menaxhimit dhe rishikimin e planit të menaxhimit në rastet kur nevojitet. Duke konsideruar se monitorimi mund të jetë një proces i gjatë dhe i shtrenjtë, menaxherët duhet të jenë përzgjedhës kur vendosin për të cilat aspekte të planit nevojitet monitorimi, dhe që të identifikojnë treguesit dhe mënyrën e kontrollit të tyre.

Për disa pasuri janë zhvilluar mekanizmat e monitorimit të rregullt, kryesisht për të përcaktuar gjendjen e ruajtjes. Megjithatë, të gjitha strategjitë e monitorimit (në rastin e pasurive të Trashëgimisë Botërore) duhet të kenë për qëllim që të sigurojnë informacionet për realizim të parimeve të përmbajtura në *Udhëzimet operative* dhe duhet të jenë të ndërlidhura me kërkesat e Trashëgimisë Botërore siç janë gjendja e ruajtjes, monitorimit reagues dhe proceset e raportimit periodik.

#### Treguesit për monitorim – shembujt nga plani i menaxhimit të zonës së Trashëgimisë Botërore Stounhenxh<sup>41</sup>

<sup>41</sup> Ekstraktet nga Young, C., Chadburn, A. and Bedu, I. 2009. Stonehenge. World Heritage Site Management Plan 2009. London, English Heritage.

<sup>40</sup> *Managing Cultural World Heritage*. (World Heritage Resource Manual), Pjesa 4.3 – Monitorim

Qëllimi i monitorimit është që të vlerësohet se si mirëmbahen vlerat e Trashëgimisë Botërore gjatë kohës dhe të matet a realizohen objektivat e planit të menaxhimit për pasurinë e Trashëgimisë Botërore. Matja e përparimit është e rëndësishme që të përshtatet dhe të përmirësohet menaxhimi i pasurisë. Identifikimi i kërcënimeve kryesore në fazën e hershme është i domosdoshëm për t'i zbatuar masat korrektuese para se dëmi të bëhet tepër i madh. Monitorimi i rregullt është i domosdoshëm për t'i rishqyrtuar prioritetet në përputhje me çështjet e reja që shfaqen dhe përparimin e realizuar. Treguesit për monitorim duhet të jenë të lidhur fuqishëm me vlerat dhe objektivat e përcaktuara në planin e menaxhimit të pasurisë së Trashëgimisë Botërore.

Ekzistojnë nëntëmbëdhjetë tregues për përcjelljen e zonës së Trashëgimisë Botërore Stounhenxh dhe Ejuveri (Stonehenge i Avebury) që janë përpiluar bashkarisht nga dy koordinatorë, me kontribut të madh të numrit të madh të partnerëve, dhe të cilat në vitin 2003 i ka miratuar Komiteti për Zonën e Trashëgimisë Botërore Stounhenxh. Objektivi i treguesve është matja e përparimit të mbrojtjes, interpretimit dhe menaxhimit të pasurisë. Edhe nëse shumica e treguesve është e njëjtë për Ejuverin dhe Stounhenxhin,

ekzistojnë dallimet e vogla që pasqyrojnë specifikat e secilës pasuri të veçantë. Është pranuar që treguesit duhet të jenë të thjeshtë, të kuptueshëm, të lehtë për t'u grumbulluar dhe të vazhdueshëm, që të krijohen mundësi për krahasime gjatë kohës. Kur përcaktohen atributet e vlerës së jashtëzakonshme universale, nevojitet që gjatë periudhës së zbatimit të planit të vlerësohen këta tregues për ta vlerësuar a duhet ata edhe më tutje t'u referohentributeve.

Shiko Tabelën 3 me treguesit



© Diego Delso, Wikimedia Commons, License CC-BY-SA 3.0

Objektivat	Treguesit kryesor për monitorim	Si dhe kush?	Sa shpesh?	A ekziston?
Konservimi i siteve arkeologjike	1. Krijimi i të dhënave të përditësuara për sitet arkeologjike	Evidenca e siteve dhe monumenteve për të cilat kujdeset Këshilli i Qarkut Wiltshir (Wiltshire County Council - WCC)	Sipas nevojës	Po
		Sistemi i informacionit gjeografik (GIS) për Stounhenxh të cilin e mirëmban organizata Trashëgimia Angleze (English Heritage - EH)		Po
	2. Gjendja e siteve arkeologjike	Studimi i gjendjes së zonave të Trashëgimisë Botërore që financohen nga EH	Çdo gjashtë vjet	Po
		Monitorimi i rregullt i siteve që zbatohet nga vullnetarët e National Trust-it (National Trust - NT) dhe asistentët në terren të mjedisit historik të Trashëgimisë Angleze (EH Historic Environment Field Assistants)	Sipas nevojës	Po
	3. Numri i hektarëve të barit të ripërtërirë dhe numri i siteve të mbrojtur nga dëmtimet që shkaktohen nga lërimi i tokës	Hartat dhe të dhënat të cilat i unifikon koordinatori për zonën e Trashëgimisë Botërore, Defra, National Trust	Përditësimi vjetor	Po

**Tabela 3** Treguesit për përcjellje të Planit të menaxhimit të zonës së Trashëgimisë Botërore Stounhenxh

#### **4.2.5.6 Shqyrtimi i planit të menaxhimit**

Hartimi i planit të menaxhimit është një proces i vazhdueshëm dhe vijues, dhe jo ngjarje e fiksuar dhe e njëhershme. Të gjitha palët e interesuara duhet të dinë se do të kryhet shqyrtimi i rregullt i planit të menaxhimit (një ose dy herë në vit). Informacionet e fituara nga procesi i monitorimit duhet të vlerësohen dhe të përdoren për shqyrtimin e planit.

Përveç shqyrtimit të rregullt, në këto raste vijuese mund të jetë i nevojshëm edhe shqyrtimi i pjesëve ose i tërë planit:

- a) kur nevojitet veprimi urgjent, në bazë të rezultateve të procesit të monitorimit,
- b) në raste të situatave të emergjencës (për shembull, në rast të fatkeqësive),
- c) kur Komiteti e përfshin pasurinë në Listën e Trashëgimisë Botërore në rrezik, ose në raste kur ndryshimet e mëdha e pengojnë zbatimin e pjesëve të planit.

Procesi i shqyrtimit duhet të mbështetet në qasjen pjesëmarrëse që është përdorur gjatë hartimit të planit, dhe sipas nevojës të përfshijë palët e reja të interesuara (për shembull autoritetet e mbrojtjes në rastet e sulmeve terroriste).

Procesi i shqyrtimit duhet të jetë pjesë e planit të menaxhimit, i harmonizuar në bashkëpunim me palët e interesuara, posaçërisht kur bëhet fjalë për situata të emergjencës që u përmendën më parë. Procesi i shqyrtimit duhet të përbëhet nga shqyrtimet vjetore, shqyrtimet pesëvjeçare dhe shqyrtimet e mëdha, etj, sipas nevojës, me zbatimin e shqyrtimeve plotësuese reaguese në rastet e situatave të emergjencës.

### 4.3. Përmbajtja e planit të menaxhimit

#### 4.3.1 Përmbajtja e planit të menaxhimit

Faza përfundimtare e procesit të menaxhimit të përshkruar sa më sipër është hartimi i planit të menaxhimit. Nëse është përgatitur gjithë materiali i nevojshëm, gjatë kësaj faze duhet shqyrtuar se si të prezantohet në mënyrë efektive përmbajtja e planit: si duhet të jetë organizimi i dokumentit final, stili i tij, struktura dhe renditja e kapitujve. Plani duhet të jetë i shkruar me një gjuhë të kuptueshme dhe të ketë strukturë të thjeshtë. Nëse përmban çdo informacion tek të cilët qasja është e kufizuar, shpërndarja e tij duhet të jetë e kontrolluar.

Plani duhet të ketë strukturë të brendshme të qëndrueshme dhe në mënyrë sistematike të përshkruajë se si do të menaxhohet një pasuri dhe si do të ruhet rëndësia e saj dhe si do të promovohet për të gjithë ata që janë të interesuar për pasurinë në fjalë.

Plani mund të ketë përmbajtje të tillë siç vijon:

#### Plani i menaxhimit: përmbajtja

- Qëllimi
- Procesi (së bashku hartuar plani dhe kush ka qenë i përfshirë), duke përfshirë diagramin e procesit të marrjes së vendimeve
- Përshkrimi i pasurisë
- Rëndësia (duke cekur vlerat e jashtëzakonshme universale për zonat e Trashëgimisë Botërore)
- Përcaktimi i çështjeve kryesore
- Deklarata mbi vizionin/parimet udhëheqëse, politikën/objektivat

- Aktivitetet e nevojshme për realizimin e politikave/objektivave (duke përfshirë kornizën kohore, prioritetet, burimet dhe treguesit

- Plani i zbatimit; plani vjetor i punës, përpunimi i projektit, specifikimi i burimeve
- Plani i monitorimit
- Plani kohor i shqyrtimit

#### 4.3.2 Aktivitetet pas hartimit të planit

Suksesi i planit të menaxhimit varet nga autoriteti që i është dhënë gjatë hartimit dhe pas përfundimit. Organizatat e identifikuara në fillim të procesit tani duhet ta miratojnë planin, të detyrohen për realizimin e tij, të sigurojnë burimet (për shembull, stafin për zbatim të planit) të cilat i kanë premtuar gjatë procesit të planifikimit, si dhe burimet shtesë. Ku ekziston mundësia, planit duhet t'i jepet statusi juridik në kuadër të sistemit të menaxhimit ekzistues.

Pas miratimit të planit, duhet të fillohet me zbatimin e tij, në përputhje me planin e zbatimit i cili është përgatitur paraprakisht. Aty fillojnë aktivitetet e përditshme menaxhuese të zbatimit të procesit të menaxhimit.

Shikoni planet e menaxhimit për pasuritë e përfshira në Listën e Trashëgimisë Botërore (<http://whc.unesco.org/en/list/>)



## 5 Mësimet e nxjerra gjatë planifikimit të menaxhimit të siteve të Trashëgimisë Botërore në rajonin e Adriatikut

Në këtë kapitull janë prezantuar mësimet e nxjerra gjatë planifikimit të menaxhimit të siteve të Trashëgimisë Botërore të përfshira në projektin EX.PO AUS, që kanë dalë nga aktivitetet e realizuara të projektit. Në pjesën e parë janë prezantuar rezultatet e Vlerësimit të gjendjes së planeve të menaxhimit dhe çështjeve të përgjithshme të menaxhimit. Vlerësimi është kryer në bazë të formularëve të përgatitur dhe të plotësuar nga partnerët e projektit EX.PO AUS. Analiza e këtij materiali është prezantuar në dokumentin “Raporti ndërkufitar për menaxhimin e siteve të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në rajonin e Adriatikut”, i cili mund të shkarkohet nga faqja e uebit e projektit EX.PO AUS [www.expoaus.org](http://www.expoaus.org).

Në projektin EX.PO AUS janë përfshirë **14 site**. Njëmbëdhjetë prej tyre janë në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s; dy janë në Listën e pasurive potenciale të Trashëgimisë Botërore (Tentative List), dhe një është në proces të përfshirjes në Listë të pasurive potenciale.


Në bazë të të dhënave të marra përmes formularëve, këto site përfshijnë **format e ndryshme të pasurive kulturore:**

- **Zonat arkeologjike** (Zona arkeologjike e Bazilikës Patriarkale të Akuileias, Butrint)
- **Monumentet dhe komplekset individuale** (Kompleksi peshkopal i Bazilikës


së Eufrazianit në Qendrën historike të Poreçit)

- **Kompleksin e monumenteve individuale** (Monumentet e krishtërit të hershëm të Ravenës – që përbëhen prej tetë monumenteve individuale)
- **Pjesët e zonave urbane** (Truli në Alberobello, Qyteti i Vjetër i Korfuzit, Zona e Urës së Vjetër dhe Qyteti i Vjetër i Mostarit)
- **Zonat urbane** (Kompleksi historik i Splitit me Pallatin e Dioklecianit)
- **Zonat dhe peisazhet urbane** (Qyteti i Vjetër i Dubrovnikut, me ishullin Llokrum)
- **Zonat natyrore dhe arkitekturore** (Zona natyrore dhe arkitekturore e Blagajit, Zona natyrore dhe arkitekturore e Stollac)
- **Zonat natyrore dhe kulturo – historike** (Zona natyrore dhe kulturo-historike e Kotorrit)
- **Peisazhet kulturore** (Ferrara, qytet i Rilindjes në grykëderdhje të lumit Po, peisazhi kulturor i Piranit me kriporet në Seçovle dhe Strunjan)

Sa i përket kohës së përfshirjes në Listën e Trashëgimisë Botërore, përmes projektit EX.PO AUS janë trajtuar sitet që janë përfshirë në periudha të ndryshme, prej atyre më të hershme të viteve 70-të të



Pjesët e zonave urbane



Monumentet e veçanta




Zonat urbane dhe peisazhet




Zonat urbane



Zona natyrore dhe kulturo – historike



Peisazhet kulturore



shekullit XX, shumica gjatë viteve 90- të të shekullit XX dhe disa pas vitit 2000, deri tek ato që akoma nuk janë të përfshira në Listën e Trashëgimisë Botërore dhe as në Listën e pasurive potenciale.

- Sitet e përfshira **gjatë viteve 70-të të shekullit XX** (tre site: Qyteti i Vjetër i Dubrovnikut, Kompleksi historik i Splitit me Pallatin e Dioklecianit, Zona natyrore dhe kulturo-historike e Kotorrit)

- Sitet e përfshira **gjatë viteve 90- të të shekullit XX** (gjashtë site: Truli në Alberobello, Zona arkeologjike e Bazilikës Patriarkale të Akuileias, Butrinti, Ferrara qytet i Rilindjes në grykëderdhje të lumit Po, Kompleksi peshkopal i Bazilikës së Eufrasijanit në Qendrën historike të Poreçit, Monumentet e krishtërit të hershëm të Ravenës)

- Sitet e përfshira **pas vitit 2000** (dy site: Zona e Urës së Vjetër dhe Qyteti i Vjetër i Mostarit, Qyteti i Vjetër i Korfuzit)

- Sitet e përfshira **në Listën e pasurive potenciale** (dy site nga viti 2007: Zona natyrore dhe arkitekturore e Bllagajit, Zona natyrore dhe arkitekturore e Stollac-it)

- Siti që akoma **nuk është përshirë në Listën e pasurive potenciale**: Peizazhi kulturor i Piranit me kriporet në Seçovle dhe Strunjan, për të cilin gjatë projektit do të bashkohet dokumentacioni për nominim për përfshirje në Listën e pasurive potenciale.

Tabela 4 Identifikimi i siteve të UNESCO-s në kuadër të projektit

Emri i sitit	Shteti	Tipi i sitit	Përfshirja në Listën e Trashëgimisë Botërore	Viti i përfshirjes	Kriteret
1. Truli në Alberobello	Itali	Zonë urbane	Po	1996	3,4,5
2. Zona arkeologjike e Bazilikës Patriarkale të Akuileias	Itali	Zonë urbane arkeologjike	Po	1998	3,4,6
3. Butrinti	Shqipëri	Peizazh arkeologjik	Po	1992	3
4. Qyteti i Vjetër i Korfuzit	Greqi	Kalatë e vjetra dhe të reja; plani urban dhe rrugët; hapësirat, sheshet dhe parqet; karakteristikat kulturore	Po	2007	4

	Nome del sito	Paese	Tipo del sito	Iscritto nella		
				Lista del Patrimonio Mondiale	Anno di iscrizione	Criteri
5.	Qyteti i Vjetër i Dubrovnikut, me ishullin Llokrum	Kroaci	Qendra urbane, peisazh kulturor	Po	1979, 1994 ostrvo	1,3,4
6.	Ferrara qytet i Rilindjes në grykëderdhje të lumit Po	Itali	Peisazh kulturor	Po	1995-1999	2,3,4, 5,6
7.	Zona natyrore dhe kulturo-historike e Kotorit	Mal i Zi	Zonë natyrore dhe kulturo – historike (peisazh kulturor)	Po	1979	1,2, 3,4
8.	Zona e Urës së Vjetër dhe Qyteti i Vjetër i Mostarit	Bosnje – Hercegovina	Monument kombëtar – zonë urbane historike	Po	2005	6
9.	Zona natyrore dhe arkitekturale e Blagajit		Tërësi natyrore dhe arkitekturore	Në Listën e pasurive potenciale (2007)		
10.	Zona natyrore dhe arkitekturale e Stollac					
11.	Peizazhi kulturor i Piranit me kripore në Sečovle dhe Strunjan (duhet të konfirmohet)	Sllloveni	Peizazh kulturor me komponente rurale dhe urbane	Jo		

			Iscritto nella			
Nome del sito	Paese	Tipo del sito	Lista del Patrimonio Mondiale	Anno di iscrizione	Criteria	
12.	Kompleksi peshkopal i Bazilikës së Eufrazijanit në Qendrën historike të Poreçit	Kroaci	Monument individual	Po	1997	2,3,4
13.	Monumentet e krishtërimin të hershëm të Ravenës (Bazilika San Vitale, Mauzoleu Galle Placidie, Pagëzimorja (katolike) Neoniane, Pagëzimorja e Arianit, Kishëza Arkipeshkopale, Bazilika Sant' Apollinare Nuovo, Mauzoleumi i Teodorikut, Bazilika Sant' Apollinare in Classe)	Itali	Tetë monumente individuale	Po	1996	1,2,3,4
14.	Kompleksi historik i Splitit me Pallatin e Dioklecianit	Kroaci	Zonë urbane	Po	1979	2,3,4

**Planet e menaxhimit të siteve të përfshira në projektin EX.PO AUS – gjendja aktuale**

Planet e menaxhimit të siteve të përfshirë në projektin EX.PO AUS janë në faza

të ndryshme të hartimit dhe të zbatimit. Analiza e gjendjes së planeve të menaxhimit e prezantuar në vijim është bërë në bazë të formularëve që janë plotësuar nga partnerët e projektit.

Tabela 5 Gjendja e planeve të menaxhimit të siteve të përfshira në projekt

	Emri i sitit	Viti i përfshirjes në Listën e Trashëgimisë Botërore	Gjendja e planit të menaxhimit (PM)					Viti i miratimit të PM
			PM nuk ekziston		PM ekziston			
			PM nuk ekziston	PM është në fazë të përgatitjes	PM ende nuk zbatohet	PM zbatohet	Pm zbatohet dhe përditësohet rregullisht	
1.	Truli në Alberobello	1996				x		2010
2.	Zona arkeologjike e Bazilikës Patriarkale të Akuileias	1998		x				-
3.	Butrinti	1992					x	2012
4.	Qyteti i Vjetër i Korfuzit	2007				x		2005
5.	Qyteti i Vjetër i Dubrovnikut, me ishullin Lokrum	1979, 1994	x					-
6.	Ferrara qytet i Rilindjes në grykëderdhje të lumit Po	1995-1999					x	2011
7.	Zona natyrore dhe kulturo-historike e Kotorrit	1979				x		2011
8.	Zona e Urës së Vjetër dhe Qyteti i Vjetër i Mostarit	2005				x		2005

9.	Zona natyrore dhe arkitekturnore e Bllagajit	-		x				-
10.	Zona natyrore dhe arkitekturnore e Stollacit	-	x					-
11.	Peisazhi kulturor i Piranit me kripore në Seçovle dhe Strunjan ( <i>dubet të konfirmobet</i> )	-				x*		2011*
12.	Kompleksi peshkopal i Bazilikës së Eufrazijanit në Qendrën historike të Poreçit	1997		x				-
13.	Monumentet e krishtërimt të hershëm të Ravenës	1996				x		2005
14.	Kompleksi historik i Splitit me Pallatin e Dioklecianit	1979			x*			~.....
<b>GJITHSEJ (14)</b>			2	3	1	6	2	

Prej 11 siteve që janë në Listën e Trashëgimisë Botërore, vetëm një nuk e ka planin e menaxhimit dhe hartimi i tij akoma nuk ka filluar (Qyteti i Vjetër i Dubrovnikut).

Planet e menaxhimit për dy site janë në fazën e hartimit dhe hartimi i tyre do të mbarojë deri në përfundim të projektit (Zona arkeologjike e Bazilikës Patriarkale të Akuileias dhe Kompleksi peshkopial i Bazilikës së Eufrazianit në Qendrën historike të Poreçit).

Hartimi i planeve të menaxhimit për Kompleksin historik të Splitit me Pallatin e Dioklecianit është punuar, por plani ende nuk është miratuar.

Katër site i kanë planet e menaxhimit që zbatohen (Truli në Alberobello, Qyteti i Vjetër i Korfuzit, Zona e Urës së Vjetër dhe Qytetit të Vjetër të Mostarit, Monumentet e krishtërimin të hershëm të Ravenës), ndërsa plani i menaxhimit për Zonën natyrore dhe kulturo – historike të Kotorrit zbatohet vetëm pjesërisht. Dy site i zbatojnë dhe rregullisht i përditësojnë planet e veta të menaxhimit (Butrinti, Ferrara qytet i Rilindjes në grykëderdhje të lumit Po).

Asnjë prej tre siteve që nuk janë të përfshirë në Listën e Trashëgimisë Botërore nuk e ka planin e menaxhimit. Hartimi i planit të menaxhimit për Zonën natyrore dhe arkitekturore Stollac akoma nuk ka filluar, ndërsa për Zonën natyrore dhe arkitekturore Bllagaj hartimi i planit është në vijim. Siti Peisazhi kulturor i Piranit me kripore në Seçovle dhe Strunjan e ka planin e menaxhimit të zonës që do të jetë e nominuar për përfshirje në Listën e pasurive potenciale, planin e menaxhimit dhjetëvjeçar për Parkun peisazhi Kriporja në Seçovle (2011–2021), por jo edhe për tërë zonën.

Informacioni në lidhje me gjendjen e statusit të planeve të menaxhimit të siteve u mbledh në vitin 2013, kurse në vitin 2015 Qyteti i Dubrovnikut filloi punën me përgatitjen e planit të menaxhimit dhe u përfundua puna për hartimin e planit të menaxhimit të Kompleksit Episkopial të Bazilikës Eufraziane në Qendrën Historike të Poreçit.



Ballina e Planit të menaxhimit për monumentet e krishtërimin të hershëm të Ravenës, 2005

## 5.1. Hartimi dhe zbatimi i planeve të menaxhimit – procesi, mësimet e nxjerra, sfidat

Në pjesën e formularit të lidhur me planet e menaxhimit dy pyetje janë referuar përvojave gjatë hartimit, përditësimit dhe zbatimit të planeve të menaxhimit (procesi, anët negative dhe pozitive, sfidat, mësimet e nxjerra). Këtë pjesë të tabelës informuese e kanë plotësuar sitet që i kanë planet e menaxhimit.

Vijojnë disa nga temat kryesore që janë të njohura gjatë procesit të hartimit të planeve të menaxhimit:

- Ekzistojnë modelet e ndryshme të hartimit të planeve të menaxhimit që përbëhen nga fazat e ndryshme dhe nënkuptojnë përfshirjen e palëve të ndryshme të interesuara. Këto modele varen nga korniza juridike dhe institucionale e shtetit, tipi i sitit, specifikat e sitit dhe konteksti lokal, etj.

- › Për shkak të zbatimit të planeve të menaxhimit, **komiteti drejtues** i përbërë nga personat përgjegjës për sitin ka **emëruar grupin teknik** i cili ka hartuar planin e menaxhimit, dhe pastaj ka kryer monitorimin e zbatimit të tij. Aktualisht, grupi teknik ka përgatitur planin e përgjithshëm afatgjatë në kuadër të të cilit mund të parashikohen të gjitha aktivitetet e veçanta të lidhura me shfrytëzimin e sitit, mbrojtjen e tij dhe mirëmbajtjen përkatëse (Ferrara).

- › Plani i menaxhimit u hartua me nismën e Komunës së Korfuzit dhe Degës së Dhomës Teknike të Greqisë në Korfuz. Hartimi paraprak i planit të menaxhimit iu besua **dy arkitektëve**, të

cilët kanë hartuar draftin e parë në bazë të të dhënave për sitin dhe përvojës së vetë të pasur. Drafti i parë i planit të menaxhimit iu është **dorëzuar komiteteteve të zgjedhur** të dy organizmave përgjegjës për hartimin e planit të menaxhimit, dhe pastaj plani është rishikuar dhe përpunuar. Pas miratimit, plani iu **prezantua komunitetit lokal** dhe iu dorëzua Ministrisë së Kulturës (Drejtoria e artit bizantin dhe pas-bizantin), aktorëve të tjerë të përfshirë në menaxhimin e sitit, autoriteteve rajonale për ishujt e Detit Jon dhe Prefekturës së Korfuzit për marrje të pëlqimit. Përfundimisht, **pas konsultimeve dhe diskutimeve të gjera, plani është miratuar** nga Këshilli komunal në vitin 2005 (Korfuz).

- › Procesi i hartimit të planit të menaxhimit u realizua në dy faza (në vitet 2006-2007 dhe në vitin 2011). Procesi e kanë udhëhequr Enti rajonal për mbrojtjen e monumenteve të kulturës i Kotorrit dhe Ministria e Kulturës së Malit të Zi. Për hartimin e draftit të planit të menaxhimit janë formuar këto grupe: **Ekipi koordinues** (9 anëtarë/-e), **Grupi i punës** (22 anëtarë/-e) i përbërë nga përfaqësuesit/-et e institucioneve përkatëse shtetërore dhe lokale, medieve dhe OJQ-ve dhe **Organi këshillëdhënës** (5 anëtarë/-e) i përbërë nga përfaqësuesit/-et më të dalluar/-a të shkencës, arsimit dhe kulturës. Në fazën e dytë, gjatë përpunimit të draftit të planit të menaxhimit në përputhje me sugjerimet e UNESCO-s, është formuar **Grupi i punës** (anëtarë/-e), i përbërë nga përfaqësuesit/-et e organeve përkatëse shtetërore dhe lokale, fakulteteve, Komunës së Kotorrit dhe sektorit joqeveritar. Përveç kësaj, në procesin në fjalë u përfshirë edhe dy ekspertë të ICOMOS-it, si konsulentë profesionalë, si dhe përfaqësuesit/-et e komunave Tivat dhe Herceg Novi, për

pjesën e planit i cili i referohet zonës së mbrojtur (buffer zone) të zonës të Kotorrit. Procesi i hartimit të planit të menaxhimit përfshirte aktivitetet vijuese: edukimin e stafit, prezantimin e përvojave në lidhje me hartimin e planeve të menaxhimit, udhëtimin studimor dhe punëtorinë për formulimin e draftit të Deklaratës mbi vlerën e jashtëzakonshme universale. (Kotorr)

▪ Gjatë procesit të hartimit të planeve të menaxhimit është provuar se **përfshirja e palëve të interesuara në proces** është me shumë rëndësi.

› Procesi i hartimit të planit të menaxhimit ka përfshirë nismat e shumta për të siguruar informimin e përshtashëm dhe përfshirjen e qytetarëve/-eve dhe aktorëve të interesuar për hartimin dhe rezultatet e drejtpërdrejta të planit; janë

organizuar **tubime publike** për prezantim të projektit dhe tryeza të rrumbullakëta me pjesëmarrje të përfaqësuesve/-eve të administratës lokale, stafit teknik dhe sektorëve të përfshirë. Plani i menaxhimit është formuar në bazë të shqyrtimeve dhe mendimeve të grumbulluara gjatë këtyre tubimeve dhe krahasimeve të mendimeve të aktorëve institucionalë dhe jashtë-institucionalë, gjatë të cilëve është punuar mbi studimin e pritshmërive, zgjidhjeve dhe strategjive. (Alberobello)

› Që plani të jetë i qëndrueshëm është me shumë rëndësi të **arrihet konsensusi**. Për këtë arsye ka qenë e nevojshme që të organizohet një seri e tryezave të rrumbullakëta për aktorët e ndryshëm të interesuar për çështje të qendrës historike. (Split)



Aktivitetet e ndryshme në kuadër të procesit të hartimit të Planit të menaxhimit për zonën e Kotorrit (takimet e grupit të punës, vajtja në terren gjatë vizitës së ekspertëve, punëtoritë, prezantimi publik)



*Cytetarët/-et e Alberobello*



*Punëtorja në Split*

› *Është me rëndësi që publiku të informohet dhe të përfshihet në procesin e hartimit të planit të menaxhimit përmes aktiviteteve të ndryshme. (Kotorr)*

▪ **Grumbullimi i të dhënave dhe informacioneve** është shumë i rëndësishëm në fazën fillestare të hartimit të planit të menaxhimit dhe mund të jetë sfidë në rast se nuk është grumbulluar materiali i duhur ose në rast se ekzistojnë planet të ndryshme që janë punuar më parë dhe të cilat duhet të ndërthurrenë atë ekzistues.

› *Sfida që të përdoret materiali ekzistues, posaçërisht nëse paraprakisht janë punuar disa plane të menaxhimit. (Butrinti)*

› *Paarritshmëria e informacioneve dhe të dhënave ka vështirësuar procesin e hartimit të planit. Megjithatë, dokumentacioni i grumbulluar dhe i unifikuar gjatë procesit të hartimit të planit të menaxhimit është shumë i dobishëm për aktivitetet e ardhshme. (Kotorr)*

▪ **Gjatë procesit të hartimit të planit të menaxhimit, në fazën e vlerësimit të gjendjes, si dhe përcaktimit të propozimit,**

mund të përdoren mjetet të ndryshme të dobishme, siç janë punimi i analizës SWOT ose zhvillimi i kornizës logjike.

› *Për të prezantuar mundësitë e zhvillimit të sitit dhe për të përcaktuar të gjitha aktivitetet e nevojshme për realizimin e objektivit të mbrojtjes dhe përmirësimit që i ka përkufizuar UNESCO-ja, mund të përdoret analiza SWOT e cila shqyrton fuqitë dhe dobësitë brenda sitit dhe një mundësitë dhe kërcënimet. (Alberobello)*

› *Ka dalë si shumë e dobishme që brenda planit është zhvilluar edhe korniza logjike e planit të menaxhimit e cila i ka ndërthurur temat kryesore*



*Pjesa e materialit të grumbulluar gjatë procesit të përgatitjes së dokumentacionit për përfshirjen e sitit Peisazhi kulturor i Piranit me kripore në Seçovle dhe Strunjan në Listën pasurive potenciale të UNESCO-s*

të njohura, faktorët, objektivët, detyrat prioritare, udhëzimet, masat dhe regjimet e mbrojtjes dhe aktivitetet. (Kotorr)

▪ Kur është fjala për sítet komplekse që kanë **vlerat kulturore dhe natyrore**, ka qenë sfidë trajtimi i vlerave të tilla dhe hartimi i një plani të integruar

› Sfida kryesore gjatë hartimit të planit të menaxhimit për sitin i cili i ka vlerat/cilësitë kulturore dhe natyrore ka qenë mënyra se si do të përfshihen të gjitha çështjet dhe të hartohet plani i integruar i i menaxhimit. (Butrint)

▪ Si dokumenti strategjik për menaxhim të siteve të Trashëgimisë Botërore, plani i menaxhimit është i ndërlidhur me aspekte të ndryshme të zhvillimit të sitit, por mund të bëhet edhe **çështje politike**.

› Plani i menaxhimit është bërë çështje politike sepse diskutimet mbi planin janë përdorur si platformë për kritikë të situatës së përgjithshme në qendrën e vjetër historike, si dhe për kritikë të paaftësisë së qeverisjes lokale për t'u përballur me problemet e administrimit të qytetit dhe mungesës së procedurave demokratike për marrje të vendimeve strategjike (Split)

Duke analizuar procesin e **Zbatimit të planit të menaxhimit**, është shumë me rëndësi të theksohen këto:

▪ Menaxhimi bëhet shumë i **ndërlikuar** nëse sítet janë komplekse dhe të mëdha, dhe posaçërisht nëse janë të përfshirë shumë palë të interesuara

› Madhësia e territorit të cilën e përfshin sítet dhe numri i palëve të interesuara ndikojnë që menaxhimi i sitit të jetë shumë i ndërlikuar. Mënyra se si është shfrytëzuar deri tani

është mbështetur tek bashkërenditja e përgjithshme, duke lejuar aktorët individualë që të menaxhojnë drejtpërdrejtë me burime në territoret e veta. (Ferrara)


▪ Ekzistojnë **modele të ndryshme** për zbatim të planit të menaxhimit, të cilët konsiderohen si të vyeshtë, dhe disa prej tyre nënkuptojnë formimin e agjencive drejtuese të posaçme.

› Agjencia është themeluar për kryerjen e punëve profesionale dhe punëve të tjera në fushën e planifikimit rajonal, mbrojtjes së trashëgimisë, ruajtjes së pasurive nën mbrojtje të UNESCO-s, zbatimit të planit të menaxhimit, hartimit të propozimeve dhe planeve zhvillimore dhe bashkëpunimit me të gjitha nivelet



Parku arkeologjik në Butrint

Skema e modelit procedural të miratuar, Plani i menaxhimit për zonën e UNESCO-s "Trulli në Alberobello", 2010



Analiza SWOT e Planit të menaxhimit për sitin Ferrara qytet i Rilindjes në grykëderdhje të lumit Po, 2011

SWOT AREA SOCIO DEMOGRAFICA E WELFARE			
S (punti di forza)	W (punti di debolezza)	O (opportunità)	T (minacce)
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Presenza di forte associazionismo</li> <li>• Iniziative equo solidali del privato sociale e del terzo settore (last minute market, commercio equo solidale, ecc)</li> <li>• incremento della popolazione dovuto all'immigrazione</li> <li>• miglioramento degli indicatori del mercato del lavoro</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Emigrazione di giovani altamente qualificati</li> <li>• Scarsa attrattività di giovani immigrati</li> <li>• Elevata età media</li> <li>• Offerta scolastica insufficiente (liste attese scuole d'infanzia)</li> <li>• indice di vecchiaia in aumento</li> <li>• tasso di disoccupazione più alto della media regionale</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Distretto Altra Economia</li> <li>• Presenza di Istituti Tecnici per la formazione di manodopera specializzata</li> <li>• aumento della forza lavoro immigrata</li> <li>• sviluppo di servizi alla persona, in particolare agli anziani (telemedicina, caso domestico, ecc..)</li> <li>• l'alta qualità del territorio ferrarese rappresenta un'area favorevole per l'insediamento degli anziani e la cura della salute</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Calo demografico della popolazione, in particolare in età lavorativa</li> <li>• Criticità legate all'inclusione degli immigrati</li> <li>• Disoccupazione di lungo periodo per over 40</li> <li>• progressivo invecchiamento della popolazione</li> </ul>

Korniza logjike nga Plani i menaxhimit për zonën e Kotoritjes: temat – faktorët – objektivat – detyrat prioritare – masat dhe regjimet e mbrojtjes – aktivitetet, 2011

Titulli i politikës	Objektivi	Motivimi dhe justifikimi	Megjithatë, aspektet kryesore të rrethit	Qëllimi
<p>1. Mbrojtja dhe rindërtimi i monumenteve dhe objekteve kulturore të trashëguara nga të kaluarja dhe të tjerat që kanë vlerë historike, kulturore dhe shpirtërore.</p> <p>2. Mbrojtja dhe rindërtimi i monumenteve dhe objekteve kulturore të trashëguara nga të kaluarja dhe të tjerat që kanë vlerë historike, kulturore dhe shpirtërore.</p> <p>3. Mbrojtja dhe rindërtimi i monumenteve dhe objekteve kulturore të trashëguara nga të kaluarja dhe të tjerat që kanë vlerë historike, kulturore dhe shpirtërore.</p>	<p>1. Mbrojtja dhe rindërtimi i monumenteve dhe objekteve kulturore të trashëguara nga të kaluarja dhe të tjerat që kanë vlerë historike, kulturore dhe shpirtërore.</p> <p>2. Mbrojtja dhe rindërtimi i monumenteve dhe objekteve kulturore të trashëguara nga të kaluarja dhe të tjerat që kanë vlerë historike, kulturore dhe shpirtërore.</p> <p>3. Mbrojtja dhe rindërtimi i monumenteve dhe objekteve kulturore të trashëguara nga të kaluarja dhe të tjerat që kanë vlerë historike, kulturore dhe shpirtërore.</p>	<p>1. Mbrojtja dhe rindërtimi i monumenteve dhe objekteve kulturore të trashëguara nga të kaluarja dhe të tjerat që kanë vlerë historike, kulturore dhe shpirtërore.</p> <p>2. Mbrojtja dhe rindërtimi i monumenteve dhe objekteve kulturore të trashëguara nga të kaluarja dhe të tjerat që kanë vlerë historike, kulturore dhe shpirtërore.</p> <p>3. Mbrojtja dhe rindërtimi i monumenteve dhe objekteve kulturore të trashëguara nga të kaluarja dhe të tjerat që kanë vlerë historike, kulturore dhe shpirtërore.</p>	<p>1. Mbrojtja dhe rindërtimi i monumenteve dhe objekteve kulturore të trashëguara nga të kaluarja dhe të tjerat që kanë vlerë historike, kulturore dhe shpirtërore.</p> <p>2. Mbrojtja dhe rindërtimi i monumenteve dhe objekteve kulturore të trashëguara nga të kaluarja dhe të tjerat që kanë vlerë historike, kulturore dhe shpirtërore.</p> <p>3. Mbrojtja dhe rindërtimi i monumenteve dhe objekteve kulturore të trashëguara nga të kaluarja dhe të tjerat që kanë vlerë historike, kulturore dhe shpirtërore.</p>	<p>1. Mbrojtja dhe rindërtimi i monumenteve dhe objekteve kulturore të trashëguara nga të kaluarja dhe të tjerat që kanë vlerë historike, kulturore dhe shpirtërore.</p> <p>2. Mbrojtja dhe rindërtimi i monumenteve dhe objekteve kulturore të trashëguara nga të kaluarja dhe të tjerat që kanë vlerë historike, kulturore dhe shpirtërore.</p> <p>3. Mbrojtja dhe rindërtimi i monumenteve dhe objekteve kulturore të trashëguara nga të kaluarja dhe të tjerat që kanë vlerë historike, kulturore dhe shpirtërore.</p>

e qeverisjes – shtetërore, federale, kantonale dhe vendore. (Mostar)

▪ Plani i menaxhimit në fazën e zbatimit mund të jetë **kornizë e rëndësishme, e planifikimit dhe bazë e rëndësishme për grumbullimin e mjeteve për zbatimin e tij.**

› *Hartimi i planit të menaxhimit ka ndikuar fuqishëm tek korniza e planifikimit. Sot Komuna Alberobello merr pjesë në konkurse të shumta për financim, falë aftësisë të vazhdueshëm teknik. (Alberobello)*

▪ Plani i menaxhimit në fazën e zbatimit mund të jetë **kornizë e rëndësishme për përfshirjen e komunitetit dhe palëve të tjera të interesuara në procesin e zbatimit.**

› *Komuniteti sot në mënyrë aktive përfshihet si në aktivitete të lidhura me*

*planifikimin, ashtu dhe në projekte. (Alberobello)*


▪ Gjatë zbatimit, plani i menaxhimit mund të jetë një dokument i rëndësishëm për **zhvillimin e strategjive të tjera gjithëpërfshirëse të lidhura për zonat e Trashëgimisë Botërore.**

▪ Në strategjinë e zhvillimit të qëndrueshëm urban që e ka miratuar Komuna e Korfuzit, tri strategjitë kryesore janë në sinergji të drejtpërdrejtë me planin e menaxhimit të Kalasë:

› Strategjia e zhvillimit të qëndrueshëm

› Strategjia e cilësisë së përgjithshme

› Strategjia e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve/-eve.



Harta e zonës së Ferrarës qytet i Rilindjes në grykëderdhje të lumit Po

Të gjitha këto strategjitë e përmendura janë instrumentet e Komunës në qasjen e saj për realizimin e objektivave të zhvillimit lokal, por edhe për zbatimin planeve të menaxhimit të Qytetit të Vjetër. (Korfuz)

- Pas analizës së mënyrës së zbatimit të planit të menaxhimit, mund të **përkufizohen temat e posaçme që janë me rëndësi për përditësimin e planit** në fazën vijuese.
- Në rastin e Ravenës janë njohur këto si **udhëzime për avancim të procesit**:
  - › analiza e detajuar e botimit të parë të planit të menaxhimit dhe krahasimi me dokumente të tjera të hartuara në nivelet kombëtare dhe ndërkombëtare, duke theksuar pikat që mungojnë ose nuk janë plotësisht të zhvilluara, dhe me të gjitha dokumentet e tjera të hartuara nga aktorët e ndryshëm që janë të lidhura me sitin e Ravenës, është konsideruar si e rëndësishme për hartimin e botimit të dytë të planit të menaxhimit;
  - › organizimi i takimeve tematike me aktorë të ndryshëm lidhur me sitin (Komuna e Ravenës, Drejtoria për trashëgiminë arkeologjike dhe peisazhin për krahinat e Ravenës, Ferrarës, Forlì-Qesenës dhe Riminit, Arqipeshkvisë Ravena-Qervia, Drejtoria rajonale për trashëgiminë kulturore dhe peisazhin e rajonit Emilia-Romanja), me qëllim që, në një anë, të identifikohen elementet e rëndësishme për aktivitetin e përshkruar në pasazhin paraprak, dhe, në anë të tjetër, të bëhet analiza e detajuar plotësuese e dobishme për rishikimin e planit të menaxhimit, që parashikohet si hapi vijues;



Konferenca me pjesëmarrje të komunitetit lokal, Alberobello

- › zhvillimi i metodologjive, udhëzimeve ose instrumenteve juridike për vendosjen e sistemit të treguesve për monitorim të funksionimit të tërë sitit të UNESCO-s, duke marrë parasysh aktorët e ndryshëm, me një rereferencë të posaçme tek aktivitetet që i zbaton Komuna e Ravenës si koordinator i planit. (Ravena)
- Esistono **diversi metodi di redazione** di un Piano di gestione che si compongono di varie fasi e comportano il coinvolgimento di vari attori. I metodi dipendono dal quadro giuridico e istituzionale di un paese, dal tipo di sito, dalla specificità del sito e dal contesto locale, ecc.
  - › *Al fine di attuare il Piano di gestione il **comitato di pilotaggio**, composto dai soggetti responsabili del sito, ha nominato un gruppo tecnico che ha redatto il Piano di gestione, dopodiché ha effettuato il controllo della sua implementazione. Al momento, il gruppo tecnico ha elaborato un Piano generale di lungo termine nell'ambito del quale sarà possibile prevedere singole attività relative all'utilizzo del sito, la sua protezione e adeguata manutenzione. (Ferrara)*
  - › Il Piano di gestione è stato redatto su iniziativa del Comune di Corfù e



*Qyteti i Vjetër i Korfuzit, zona e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, Propozimet për përditësim të Planit të menaxhimit – Plani i veprimit 2013-2018, rezultat i projektit “Realizimi i qëndrueshmërisë përmes qasjes së integruar të menaxhimit të Trashëgimisë Botërore”, 2014*

## 5.2. Korniza ligjore dhe institucionale

Kornizat ligjore dhe institucionale për menaxhim të trashëgimisë kulturore dallojnë nga vendi në vend dhe ato gjithashtu varen nga tipi i sitit.

### Elementet më të shpeshta të kornizës ligjore janë:

- Ligjet kombëtare dhe rajonale nga fusha e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore
- Ligjet shtesë nga fushat e tjera me të cilat rregullohen mbrojtja e natyrës dhe mjedisit, planifikimi hapsinor dhe ndërtimi, etj.
- Rregulloret e ndryshme në nivelet rajonale, krahinore dhe lokale
- Rregulloret ndërkombëtare (Për shembull: Konventa mbi Trashëgiminë Botërore të UNESCO-s e vitit 1972), përfshirë këtu edhe rregulloret në nivelin evropian (siç janë Natura 2000 dhe Ramsar, në raste kur sitet i kanë edhe vlerat natyrore)
- Në disa raste ekzistojnë ligjet e posaçme për mbrojtje të Trashëgimisë Kulturore Botërore ose ligjet me të cilat parashikohet themelimi i institucioneve të posaçme për menaxhimin e zonave të Trashëgimisë Botërore (siç janë Ligji rajonal i cili parashikon themelimin e fondacionit që do të jetë përgjegjës për menaxhimin e Akuileias ose Ligji special mbi mbrojtjen e zonës natyrore dhe kulturo – historike të Kotorit).

**Korniza urbanistike e planifikimit** është njohur tek të gjitha sitet si pjesë e rëndësishme e sistemit juridik që mund


të përfshijë instrumentet e ndryshme të planifikimit, nga planet hapsinore në nivelet rajonale dhe lokale, planeve të peisazhit dhe planeve urbanistike, etj.

Sa i përket **kornizës institucionale**, ajo gjithashtu përkufizohet ndryshe në vende të ndryshme. Korniza institucionale posaçërisht varet nga tipi i sitit, a është fjalë për objektin e veçantë apo peisazhin kulturor. Kur siti është kompleks edhe korniza institucionale është më komplekse (si në rastin e sitit Ferrara qytet i Rilindjes në grykëderdhje të lumit Po ose Zonës natyrore dhe kulturo – historike të Kotorrit). Më së shpeshti ndodh që sistemi institucional për mbrojtjen dhe menaxhimin e Trashëgimisë Botërore

International Legislation	
Number/references	Title/name
2007 Decision 31COM 8B.40	Nomination of natural, mixed and cultural properties to the world heritage list - of the Old Town of Corfu, Greece
National Legislation	
Number/references	Title/name
Ministerial Decision F18/4659/2305/24-7-79 (GOVERNMENT GAZETTE ISSUE 52/ B/ 21-1-80)	Classification as a "historic monument" scheduled for preservation and a site of outstanding natural beauty and interesting from an architectural or historical point of view, Responsible: The Ministry of Culture
Presidential Decree 22-04-80 /Government Gazette 274 / A / 05-05-1980	Classification of the nominated Property as a "traditional settlement". Responsible for protection: Ministry of the Environment, Spatial Planning and Public Works.
Presidential Decree 07-09-81 / Government Gazette 552 A / 02-10-81	Transfer of responsibilities regarding the construction of new buildings, additions to pre-existing ones, as well as repairs and alterations regulated by the afore mentioned Presidential Decree concerning the "coefficients of building surface", in combination with Royal Decree 09-04-64 / Government Gazette 37 / 14-04-64 concerning "building terms and limitations of plots of land and on the height of buildings" from the Ministry of the Environment, Spatial Planning and Public Works to the Municipality of Corfu
Ministerial Decision 78140 / 3271 / 12-11-86 / Government Gazette 55D / 05-02-87	General Urban Planning Scheme, Regulates land use, determines the size of building plots and the building coefficient, and defines the mechanisms by which the plan will be applied, Responsible: Ministry of the Environment, Spatial Planning and Public Works
Royal Decree 09-04-64 /Government Gazette 37 D / 14-04-64	Fixes the requirements for building sites and determines the height to which buildings may legally be constructed
N. 3028/28-6-2002 (FEK 153/A/28-6-2002), NW 040658 / GG 88 A / 100658	On the protection of the Antiquities and in general of the Cultural Heritage
Regional and local legislation	
Number/references	Title/name
Presidential Decree 07-09-81/	The Municipality of Corfu under these decrees ensures the

*Nivelet e ndryshme të legjislacionit për Qytetin e Vjetër të Korfuzit, Propozimet për përditësim të Planit të menaxhimit – Plani i veprimit 2013-2018*

përfshin të gjitha nivelet: kombëtar, rajonal, krahinor dhe komunal. Shumë i rëndësishëm është bashkëpunimi i organizatave që veprojnë në nivele të ndryshme. Shpesh themelohen institucionet e posaçme për menaxhim të Trashëgimisë Botërore (këshillat, agjencitë ose fondacionet). Më shumë të dhëna për modele të ndryshme të sistemeve institucionale dhe atyre të menaxhimit mund të jenë prezantuar në kapitullin në vijim.



Vendimi mbi themelimin e Agjencisë për Qytetin e Vjetër të Mostarit, Plani i menaxhimit për Qytetin e Vjetër të Mostarit, 2005

### 5.3. Llojet e sistemeve të menaxhimit dhe aktorët kryesorë, përgjegjësitë, bashkërenditja mes aktorëve

Sistemet e menaxhimit dallohen në varësi prej kornizës ligjore dhe institucionale të vendit përkatës. Gjithashtu, ato varen edhe nga tipi dhe madhësia e sitit, kontekstet e ndryshme lokale dhe aktorët kryesorë.

Tek sitet e përfshirë në projektin EX.PO AUS janë njohur **disa modele të ndryshme të sistemit të menaxhimit:**

- Në rastin kur pasuria e Trashëgimisë Botërore është **sit i veçantë në pronë private, pronari** është aktori kryesor, ndërsa aktorët e tjerë përfshihen në lidhje me fushat specifike të veprimit. Shembulli i tillë është Kompleksi peshkopal i Bazilikës së Eufrazianit në Qendrën historike të Poreçit, që është pronë e kishës, por Qyteti i Poreçit dhe Sekretariati i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore gjithashtu janë të përfshirë në mbrojtje dhe mirëmbajtje.
- Në rastin kur pasuria e Trashëgimisë Botërore është zonë urbane, ose pjesë e **zonës urbane** (siç janë Alberobelo dhe Korfuzi) më së shpeshti **komuna është përgjegjëse për menaxhim**. Kësisoj komuna **kryen bashkërenditjen** e palëve të tjera të interesuara. Në këto raste mund të formohen grupet drejtuese dhe komitetet operative teknike. (Korfuz)
- Në raste kur pasuria e Trashëgimisë Botërore është **sit kompleks**, peisazh kulturor ose park arkeologjik, shpeshherë formohet **organi koordinues**, i përbërë nga përfaqësuesit/-et e aktorëve kryesorë, si të institucioneve publike ashtu edhe të

institucioneve të tjera. Shembujt e tillë janë:

- › Komiteti drejtues i sitit (Ferrara)
- › Komiteti koordinues (Ravena)
- › Këshilli për menaxhim (Kotor)
- › Njësia për menaxhim (Split)

▪ Në raste të caktuara shteti mund t'i formojë edhe **institucionet e posaçme publike**. Shembujt e tillë janë:

- › Agjencia për Qytetin e Vjetër të Mostarit
- › Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Butrintit  
Institucionet publike mund të kenë edhe këshillin (Butrint).

▪ Mund të ekzistojnë edhe format e ndryshme të **partneritetit publiko – privat**, siç është në rastin e Fondacionit për Akuileia.

Janë interesante edhe modelet që në mënyra të ndryshme i ndërldhin aktorët e ndryshëm, si për shembull Kuvendi i partnerëve që siguron pjesëmarrjen e palëve të interesuara në përkufizimin e politikave strategjike (Korfuz) ose rrjetet horizontale kombëtare ose transnacionale që kanë për qëllim përfundimin e marrëdhënieve bashkëpunuese, shkëmbimin e informacioneve dhe praktikave të mira, planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve specifike në bazë të interesave të përbashkëta.

**Aktorët kryesorë që janë të njohur në lidhje me site të veçanta janë shumë të ndryshëm dhe varen pikë së pari nga tipi i sitit dhe sistemet ligjore dhe institucionale. Tek sitet më komplekse dhe më të mëdha, siç janë peisazhet kulturore ose zonat**

urbane, numri i aktorëve të përfshirë është shumë më i madh dhe më i larmishëm.

- **Qeveritë dhe autoritetet lokale** janë ndër aktorët më kryesore tek gati tek të gjitha sitet.
- Aktorët e tjerë të rëndësishëm tek të gjitha sitet janë **institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore**, si dhe **institucionet e tjera në fusha të ndryshme të të gjitha niveleve**, kombëtar, rajonal dhe lokal (filluar nga ministritë e kulturës, enteve për mbrojtje të trashëgimisë, muzeve, etj.)
- Tek sitet ku jetohet, siç janë zonat urbane, **qytetarët/-et, pronarët/-et e pasurive dhe komuniteti lokal** janë aktorë shumë të rëndësishëm (si në rastet e Korfuzit, Splitit, Dubrovnikut, Alberobellos, Kotorit).

Kur është fjala për trashëgiminë fetare, **organizatat fetare** po ashtu janë aktorë (si në rastin e Kompleksit peshkopal të Bazilikës së Eufrazijanit në Qendrën historike të Poreçit)

- Duke konsideruar se shumica e siteve në mënyrë shumë aktive shfrytëzohen për segmente të ndryshme të kulturës, **aktorët kulturorë dhe operatorët** janë po ashtu aktorë.
- Duke konsideruar potencialin e pasurive të Trashëgimisë Botërore për edukim dhe studim, **institucionet arsimore**, siç janë shkollat dhe universitetet, janë aktorë të rëndësishëm.
- **Organizatat joqeveritare dhe përfaqësuesit/-et e shoqërisë civile** po ashtu janë aktorë të rëndësishëm tek të gjitha tipat e siteve.
- **Përfaqësuesit/-et e ekonomisë, kompanive për ofrim të shërbimeve dhe**



Split

**ndërtim të infrastrukturës** gjithashtu mund të jenë aktorë të rëndësishëm dhe ata tashmë janë njohur tek disa prej siteve (Alberobello).

- Një nga temat dominuese tek gati të gjitha sitet e Trashëgimisë Botërore është turizmi, kështu që **turistët dhe vizitorët** njihen si aktorë, por nevojitet shqyrtimi plotësues i kësaj tematike dhe gjetja e mënyrave të duhura për përfshirjen e tyre.



Piran



Akuileia



Dubrovnik



Alberobello

## 5.4. Marrëdhëniet e menaxhimit ndaj konservimit, restaurimit dhe mirëmbajtjes

Në përgjithësi, çështjet e konservimit, restaurimit dhe mirëmbajtjes së trashëgimisë, përfshirë edhe pasuritë e Trashëgimisë Botërore, janë të rregulluara në të gjitha vendet në kuadër të legjislacionit kombëtar që i referohet mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, dhe kryesisht është përgjegjësi e institucioneve shtetërore.

Për shkak të statusit të tyre specifik, pasuritë e Trashëgimisë Botërore mund të kenë edhe trajtimin specifik kur bëhet fjalë për konservimin dhe restaurimin e tyre, por mund të përkufizohen edhe përmes ligjeve të posaçme ose mekanizmave të tjerë (siç është Ligji i posaçëm mbi mbrojtjen e zonës natyrore dhe kulturo – historike të Kotorrit).

Nëse shtet e Trashëgimisë Botërore i kanë planet e menaxhimit, tema e konservimit dhe mirëmbajtjes shpesh konsiderohet si një nga **fushat kryesore të para në kuadër të planit**. Përmes planeve të menaxhimit më së shpeshti shikohet gjendja në lidhje me konservimin, restaurimin

dhe mirëmbajtjen, jepen udhëzimet për përmirësimin e tyre, dhe përkufizohen aktivitetet e mundshme. Në atë rast gjithçka që është propozuar përmes planit të menaxhimit duhet të jetë në përputhje me kornizën ligjore dhe institucionale, por kjo ndarje e shtuar e temave të konservimit, restaurimit dhe mirëmbajtjes mund të kontribuojë në realizimin e proceseve të caktuara.

Tema e **mirëmbajtjes** kryesisht nuk është e ndarë më vete, dhe pyetja është nëse për shkak se në këtë kontekst nuk konsiderohet e rëndësishme ose për shkak se nuk është trajtuar.

Shkalla e njohjes së përgjithshme të menaxhimit të pasurive kulturore në kuadër të sistemit të mbrojtjes është një nga treguesit e trajtimit adekuat dhe marrëdhënies mes natyrës dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore, përfshirë këtu edhe Trashëgiminë Botërore. Në Slloveni dhe Malin e Zi Ligjet mbi mbrojtjen e pasurive kulturore (në Slloveni nga viti 2008, dhe në Malin e Zi nga viti 2011) i njohin planet e menaxhimit si një nga instrumentet për mbrojtjen integrale të pasurisë kulturore. Me këto ligje janë përfshirë edhe pasuritë e Trashëgimisë Botërore.



Bazilika Patriarkale në Akuileia



Parku arkeologjik në Butrint

## 5.5. Marrëdhëniet e menaxhimit ndaj planifikimit urbanistik dhe hapsinor

Planifikimi urbanistik dhe hapsinor është njohur tek shumë site si segment i rëndësishëm i kornizës ligjore dhe institucionale.


Qasja e integruar ndaj planifikimit urbanistik/hapësinor, mbrojtjes dhe menaxhimit të trashëgimisë në përgjithësi, posaçërisht të Trashëgimisë Botërore është shumë e rëndësishme, posaçërisht sot kur është e qartë se shpesh ekzistojnë kërcënimet për ruajtjen e vlerave të siteve për shkak të lidhjes së dobët mes planifikimit dhe menaxhimit. Kjo posaçërisht ka rëndësi për zonat e mëdha, zonat urbane dhe peisazhet kulturore ose sitet që kanë edhe vlerat kulturore edhe ato natyrore, ku lidhja mes planifikimit urbanistik/hapsinor dhe mbrojtjes së trashëgimisë është shumë më komplekse.

Fusha e planifikimit urbanistik dhe hapsinor në të gjitha vendet është rregulluar sipas kornizës ligjore përkatëse, kurse lidhja mes planifikimit dhe mbrojtjes/menaxhimit të trashëgimisë është rregulluar me ligje nga fusha e planifikimit ose me ligje nga fusha e trashëgimisë kulturore. Raportet e tilla janë të ndryshme nga vendi në vend. Do të ishte e domosdoshme të ekzistonte trajtimi i posaçëm i Trashëgimisë Botërore në kuadër të këtyre sistemeve; megjithatë, ky akoma nuk është rasti në të gjitha vendet.

Hartimi i planit të menaxhimit mund të jetë i rëndësishëm për këtë temë. Planifikimi urbanistik dhe hapsinor gati gjithmonë trajtohen si një nga temat në kuadër të planeve të menaxhimit. Kjo

fushë më së shpeshti analizohet dhe përkufizohen udhëzimet për përmirësimin e saj. Pyetja është vetëm se sa të detyrueshme janë këto rekomandime. Ka shembuj (si në Malin e Zi) ku nëpërmjet ligjeve është përcaktuar se planet urbanistike/hapsinore duhet të jenë të harmonizuara me studimin e mbrojtjes dhe me planin e menaxhimit.

Bashkëpunimi mes institucioneve që merren me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe institucioneve të fushës së planifikimit është çështje kryesore e kësaj fushe. Ky bashkëpunim mund të nxitet përmes procesit të hartimit të planit të menaxhimit ose i përkufizuar si segmenti i sistemit të menaxhimit (formimi i organeve për bashkërenditje, etj.).



Plani hapsinor i Komunës së Kotorrit i vitit 1987 me shënim të zonës së Trashëgimisë

## 5.6. Marrëdhëniet e menaxhimit ndaj zhvillimit (politikat, strategjitë, etj.)

Sitet e Trashëgimisë Botërore janë burime shumë të rëndësishme për zhvillimin e territorit të caktuar, dhe përmes mbrojtjes dhe menaxhimit të tyre adekuat mund të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin e qëndrueshëm të territorit. Roli dhe rëndësia e tyre e tillë duhet të jenë të njohura në të gjitha dokumentet strategjikë të të gjitha niveleve, nga niveli kombëtar deri tek ai lokal. Megjithatë, tek sitet që janë analizuar nuk është çdoherë situata e tillë dhe roli i Trashëgimisë Botërore në zhvillimin e qëndrueshëm duhet të përmirësohet.

Gjithashtu, është me rëndësi se sa temat e lidhura me zhvillimin e qëndrueshëm janë të njohura në kuadër të planit të menaxhimit dhe sa janë faktikisht pjesë e sistemit të menaxhimit. Sitet që i kanë planet e menaxhimit, këtë çështje zakonisht e trajtojnë përmes temave të ndryshme: Shfrytëzimi i sitit, turizmi, vlera ekonomike, etiketimi, ...

Turizmi është i njohur si një nga temat kryesore për zhvillim të sitit. Turizmi gjithsesi është potencial, por njëkohësisht mund të jetë edhe kërcënim, ashtu që është shumë me rëndësi të merret para ysh kapacitetit i bartjes së sitit.

Sitet e përfshira në këtë studim e kanë rolin e rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe posaçërisht në zhvillimin turistik të rajoneve në të cilat ndodhen.

Plani i menaxhimit duhet të ketë masat e afatgjata për zhvillimin e qëndrueshëm, por mund të parashikojë edhe veprimet konkrete që mund të kontribuojnë në një zhvillim të tillë.

Është me rëndësi që temat të cilat janë të trajtuara përmes planit të menaxhimit të jenë të sinkronizuara me të gjitha dokumentet dhe strategjitë e tjera politike, duke përfshirë edhe ato të niveleve lokale dhe kombëtare, por edhe të niveleve evropiane dhe ndërkombëtare (për shembull Agjenda 21 për kulturën, ose E ardhmja që dëshirojmë e Kombeve të Bashkuara).



*Domosdoshmëria e harmonizimit të strategjive të mbrojtjes së Trashëgimisë Botërore dhe zhvillimit të turizmit*

## 5.7. Financimi dhe fondet

Për një sistem funksional të menaxhimit duhet të ekzistojnë të gjithë elementet e domosdoshëm, kështu që, me kornizën ligjore dhe institucionale, janë të rëndësishme edhe burimet, mes tyre edhe financat.

Financimi i mbrojtjes dhe menaxhimit të siteve që janë të përfshirë në projektin EX.PO AUS kryesisht sigurohet nga burimet vijuese:

- Qeveritë, ministritë
- Qeverisjet lokale (komuna)
- Grantet dhe donacionet, nga Bashkimi Evropian dhe institucionet e tjera
- Donacionet private
- Biletat për hyrje për sitet që e kanë sistemin e tillë

Tema e financimit trajtohet si një nga çështjet në kuadër të planit të menaxhimit, por është qartë se më së shpeshti nuk është trajtuar dot.

Është njohur se procesi i hartimit të planit të menaxhimit ose vetë plani mund të ketë rëndësinë e madhe për procesin e grumbullimi të mjeteve gjatë zbatimit të tij (si në rastin e Alberobellos, i cili merr pjesë në konkurse të shumta për financim, falë, mes tjerash, mjeteve teknike të vazhdueshme që janë siguruar nëpërmjet planit të menaxhimit).



*Aktivitetet në lidhje me promovimin e zonave të Trashëgimisë Botërore të realizuara përmes projekteve të BE-së, publikimi për Bazilikën e Eufrazianit në Poreç e punuar në kuadër të projektit EX.PO AUS*



*Modelet e ndryshme të financimit, shembulli i Mostarit*

## 5.8. Monitorimi i efikasitetit

Duke u nisur nga modelet ekzistuese për vlerësimin e efikasitetit të menaxhimit, është vendosur që si bazë për procesin e vlerësimit të pilot zonës në kuadër të projektit EX.PO AUS të përdoret metodologjia e zhvilluar në dokumentin “**Enhancing our Heritage Toolkit - Assessing management effectiveness of natural World Heritage sites**” / **Doracaku për përmirësimin e trashëgimisë sonë – Vlerësimi i efikasitetit të menaxhimit të Trashëgimisë Natyrore Botërore** / . Në kuadër të projektit janë testuar dy instrumente nga “Doracaku për përmirësimin e trashëgimisë sonë” (Instrumenti 5 – vlerësimi i planifikimit të menaxhimit dhe Instrumenti 8 – vlerësimi i procesit të menaxhimit), në bazë të të cilëve është përgatitur një pyetësor, i cili pastaj iu është shpërndarë partnerëve dhe është analizuar. Gjatë zbatimit të projektit, gjatë viteve 2014-2015, ka përfunduar Cikli i Dytë i Raportimit periodik të UNESCO-s për Evropën dhe Amerikën Veriore /Cycle II of UNESCO Periodic Reporting for Europe and North America/, që përmban raportet për sitet e Trashëgimisë Botërore të përfshirë në projektin EX.PO AUS. Për të patur një panoramë të plotë, janë analizuar edhe të dhënat e monitorimit nga **Raporti periodik i UNESCO-s**. Analiza e kompletuar është prezantuar në raportin “Vlerësimi dhe monitorimi i efikasitetit të menaxhimit të siteve të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në rajonin e Adriatikut”, që mund të shkarkohet nga faqja e uebit projektit EX.PO AUS [www.expoaus.org](http://www.expoaus.org).

Pas analizës së të dhënave nga raporti periodik i UNESCO-s dhe dy veglave nga *Doracaku për përmirësimin e trashëgimisë sonë* mund të përfundohet siç vijon:

▪ Pyetësorët nga **raporti periodik i UNESCO-s** kanë treguar se:

› **Duhet të përmirësohen programet e monitorimit** në sitet, të fokusuar drejt nevojave drejtuese dhe/ose përmirësimit të kuptimit të vlerës së jashtëzakonshme universale, duke konsideruar se tek shumica e siteve monitorimi kryhet në një masë shumë të vogël, ose nuk planifikohet ose nuk drejtohet nga nevojat drejtuese dhe/ose përmirësimi i kuptimit të vlerës së jashtëzakonshme universale

› Pa dyshim ekziston nevoja që të punohet më shumë me **treguesit kryesorë** për matje në gjendjes së të ruajturit dhe monitorimit të mirëmbajtjes së vlerës së jashtëzakonshme universale. Tek disa site nevojitet që këta indikatorë të **përkufizohen** dhe të vendosen në sistemin e menaxhimit, derisa tek sitet që i kanë treguesit nevojitet që të **përmirësohet monitorimi i gjendjes së treguesve**

› Sa i përket **përfshirjes së aktorëve të ndryshëm në procesin e monitorimit**, pa dyshim se kjo gjë **duhet të përmirësohet**. Edhe nëse shkalla e përfshirjes së menaxherëve/koordinatorëve të Trashëgimisë Botërore, stafit dhe autoriteteve lokale/ komunale është më i lartë, megjithatë duhet akoma të përmirësohet, sikur edhe përfshirja e aktorëve të tjerë që aktualisht nuk janë të përfshirë në mënyrë të mjaftueshme: komunitetet lokale, studiuesit, organizatat joqeveritare, industria, popullsia autoktone lokale

▪ Duke analizuar instrumentet nga *Doracaku për përmirësimin e trashëgimisë sonë*, mund të përfundohet siç vijon:

› **Planet e menaxhimit** përdoren si dokumente themelore të planifikimit, dhe në shumicën e rasteve janë të punuara mirë, me përkufizim të mirë të pyetjeve dhe proceseve, dhe sigurojnë kornizën strategjike adekuate dhe të përshtatshme për menaxhimin e siteve të Trashëgimisë Botërore. Megjithatë, **problemi kryesor** në shumicën e rasteve është **zbatimi i planeve**. Duhet të përmirësohen zbatimi, monitorimi dhe procesi i rishikimit të planeve.

› Një nga sfidat më të mëdha për funksionimin e sistemit të menaxhimit është **ekzistenca dhe funksionimi i një strukture drejtuese të përkufizuar qartë dhe e mekanizmave të menaxhimit**. Në shumë raste janë njohur dhe identifikuar organet drejtuese, por ato nuk funksionojnë.

› Sfida e radhës e padyshimtë është **bashkëpunimi mes aktorëve të ndryshëm**, përfshirja e të gjithë aktorëve, **përfshirja e komunitetit lokal dhe përfshirja më e madhe e të gjithë**



Diagrami që tregon raportin e instrumenteve nga dokumenti *Enhancing our Heritage Toolkit* me kornizën për menaxhimin efikas që e ka vendosur Komiteti Botëror i Zonave të Mbrojtura /the WCPA Management Effectiveness Framework/; Hockings, M., James, R., Stolton, S., Dudley, N., Mathur, V., Makombo, J., Courrau, J. and Parrish, J. (2008). *Enhancing our Heritage Toolkit. Assessing management effectiveness of Natural World Heritage sites*. Paris, UNESCO World Heritage Centre. (World Heritage Papers 23.), fq. 23.

aktorëve në marrjen e vendimeve të lidhura me menaxhimin.

- › Nevojitet të përmirësohen **monitorimi dhe mekanizmat e financimit**.
- › Nevojitet të përmirësohet **turizmi dhe menaxhimi i vizitave**
- › Sfidat janë posaçërisht të pranishme tek **sitet më komplekse**, që përfshijnë zonat e mëdha dhe përmbajnë elementet natyrore dhe kulturore të peisazhit kulturor, dhe ato janë kryesisht të lidhura me trajtimin integral të hapësirës dhe të gjithë elementeve. Tek sitet më komplekse janë më të ndërlikuara edhe sistemet e menaxhimit si në kuptimin territorial, ashtu edhe në kuptimin administrativ.
- › Në disa raste sistemi i menaxhimit që është vendosur për zonën e mbrojtur nuk trajton mjaft **zonën e mbrojtur (buffer zone)**, dhe kjo duhet të përmirësohet.

Pyetësi nga raporti periodik i UNESCO-s dhe dy instrumentet nga *Doracaku për përmirësimin e trashëgimisë sonë* janë shumë të dobishme për vlerësimin e efikasitetit të menaxhimit. Analizat e zbatuara gjatë projektit EX.PO AUS japin një imazh të qartë mbi gjendjen e efikasitetit të menaxhimit dhe identifikojnë zonat që duhen përmirësuar.

Edhe nëse në kuadër të projektit janë testuar vetëm dy instrumente nga *Doracaku për përmirësimin e trashëgimisë sonë*, ato duket se kanë qenë shumë të dobishme. Megjithatë, janë shumë të vëllimshme dhe nevojitet shumë kohë për plotësimin e tyre.

Procesi i vlerësimit dhe i monitrimit të efikasitetit të menaxhimit është hallkë shumë e rëndësishme në sistemin e menaxhimit të Trashëgimisë Botërore, dhe pikë së pari duhet të përdoret për të ndihmuar menaxherëve që të punojnë në mënyrë sa më efikase dhe që të sigurojnë të dhënat hyrëse për përmirësimin e tërë sistemit të menaxhimit. Për t'u bërë ky proces pjesë përbërëse e sistemit të menaxhimit, rekomandimi ynë është që të përdoren kornizat e vendosura për raportim që përdoren nga vendet që kanë aderuar në Komitetin për Trashëgiminë Botërore. Çështjet e lidhura me efikasitetin e menaxhimit duhet të përshkruhen më hollësisht në raporte mbi gjendjen e të ruajturit ose në raporte periodike. Në atë mënyrë do të krijohen mundësitë për zbatimin e monitorimit të këtyre çështjeve në mënyrë të rregullt.

## 6 Bibliografija

- EX.PO AUS project, 2013. *EX.PO AUS Extension of Potentiality of Adriatic UNESCO Sites*
  - Feilden, B.M., Iokilehto, I. (1993). *Management Guidelines for World Heritage Sites*. Rome
  - Hockings, M., James, R., Stolton, S., Dudley, N., Mathur, V., Makombo, J., Courrau, J. and Parrish, J. (2008). *Enhancing our Heritage Toolkit. Assessing management effectiveness of Natural World Heritage sites*. Paris, UNESCO World Heritage Centre. (World Heritage Papers 23.) <http://whc.unesco.org/en/series/23/>
  - Hockings, M., Stolton, S., Leverington, F., Dudley, N. and Courrau, J. (2006). *Evaluating Effectiveness: A framework for assessing management effectiveness of protected areas*. 2nd edition, IUCN World Commission on Protected Areas, Best Practice Protected Area Guidelines Series No. 14 IUCN, Gland, Switzerland and Cambridge, UK, <https://portals.iucn.org/library/efiles/documents/PAG-014.pdf>
  - ICOMOS. 2011. *The Paris Declaration on heritage as a driver of development*
  - UNESCO. 1972. *Convention concerning the Protection of the World Cultural and Natural Heritage*. (World Heritage Convention). <http://whc.unesco.org/en/conventiontext> (English web page)
  - UNESCO, ICCROM, ICOMOS and IUCN. 2013. *Managing Cultural World Heritage*. Paris. UNESCO World Heritage Centre. (World Heritage Resource Manual.) <http://whc.unesco.org/uploads/activities/documents/activity-703-1.pdf> (English web page)
  - UNESCO World Heritage Centre. 2015. *Operational Guidelines for the Implementation of the World Heritage Convention*. (WHC.15/01 8 July 2015) <http://whc.unesco.org/en/guidelines/> (English web page)
  - UNESCO World Heritage Centre. 2008. *World Heritage Information Kit*
- Internet**
- ExPo AUS official site: <http://expoaus.org/project-5>
  - WHC UNESCO official site: <http://whc.unesco.org/en/list/>

## 7 *Summary: About the “Management planning of UNESCO World Heritage Sites – Guidelines for the development, implementation and monitoring of management plans – with the examples of Adriatic WHSs”*

The “Management planning of UNESCO World Heritage Sites – Guidelines for the development, implementation and monitoring of management plans – with the examples of Adriatic WHSs” has been produced within the project **EX.PO AUS (EXtension of Potentiality of Adriatic UNESCO Sites)**, a cross-border project co-financed by the EU within the IPA Adriatic CBC Programme 2007–2013.

The general objective of the EX.PO AUS project is to set up a network between the UNESCO World Heritage Sites of the Adriatic Sea area (including sites on the Tentative List or those planning to apply for inclusion on this list), which will be able to develop in a cross-border context, and diffuse high-quality technical and managerial competences by means of the various public and private actors involved, with the aim of pursuing a joint long-term strategy for the sustainable development of the sites based on high levels of managerial, technological and energy-related innovation. One of the **specific objectives** of the EX.PO AUS project is **cross-border development of the concept and tools for sustainable management of UNESCO World Heritage Sites**.

These guidelines are part of a set of specific processes and activities related to the management planning process of World Heritage Sites initiated in the framework

of **Working Package 3 – Cross-border Sustainable Management of the Adriatic UNESCO Sites**, coordinated by the Centre for Conservation and Archaeology of Montenegro. The activities implemented within this Working Package include: assessing the condition of management plans and general management issues for the World Heritage Sites involved in the project; assessing the effectiveness of management through the drawing up and actual testing of a checklist and indicators; developing a joint cross-border approach to sustainable development of the UNESCO World Heritage Sites in the Adriatic area; and organizing a series of nine seminars/workshops on the preparation and implementation of management plans. These activities are explained in more detail in Chapter 1.2 – Activities related to management planning within the EX.PO AUS project. The present guidelines result from the stated project activities.

**The aim of the guidelines** is to contribute to enhancing the process of management of the World Heritage Sites on the Adriatic, as well as of the sites aspiring to this status, especially through a framework for developing, implementing and monitoring management plans.

The guidelines are based on the **results of the EX.PO AUS project**, relying on **international guidelines for the management of World Heritage Sites**. It is very important to note that during the realization of the project, a new *World Heritage Resource Manual – Managing Cultural World Heritage*<sup>41</sup> was published in 2013 by the UNESCO World Heritage Centre, ICCROM, ICOMOS and IUCN. In addition to extensive literature on this subject, the material from the Manual was essential in the creation of these guidelines.

The guidelines are **intended** for all stakeholders involved in the process of World Heritage Site management. It is especially important that the guidelines have been prepared in the **languages of all seven countries** participating in the EX.PO AUS project: Albanian, Bosnian, Croatian, Greek, Italian, Montenegrin and Slovenian, as well as English. In this way, the most advanced knowledge and guidelines on management plans will be made available to a larger number of stakeholders in the Adriatic countries.

The guidelines contain the following **chapters**:

The first chapter contains a general introduction to the EX.PO AUS project, the World Heritage Sites on the Adriatic that are included in the project and the activities implemented within the project related to management planning.

Chapters 2 and 3 present the basic concepts of World Heritage Site

management. This section summarizes the basic starting points and framework for a management system of World Heritage Sites. It is based on international documents adopted in this field, especially the documents of UNESCO, including the new *World Heritage Resource Manual – Managing Cultural World Heritage*.

Chapter 4 contains the complete text of Appendix A of the *World Heritage Resource Manual – Managing Cultural World Heritage: A framework for developing, implementing and monitoring a management plan*. We thought it would be very useful to present this material in full.

Chapter 5 states the lessons learnt from the management planning of the World Heritage Sites on the Adriatic included in the EX.PO AUS project, resulting from the EX.PO AUS project's activities.

Although the guidelines, as well as the EX.PO AUS project in general, primarily focus on World Heritage Sites or sites aspiring to this status, they can be useful as a model for managing other cultural heritage areas, as well as a framework for developing, implementing and monitoring management plans.

41 UNESCO, ICCROM, ICOMOS and IUCN. 2013. *Managing Cultural World Heritage*. Paris. UNESCO World Heritage Centre. (World Heritage Resource Manual.)

**Botuesi:**

Qendra për konservim dhe arkeologji e Malit të Zi

**Koordinatorë e aktivitetit të projektit:**

Jasminka Grgurević

**Botuesi:**

Lidija Ljesar

**Teksti:**

Teksti është krijuar në bazë të materialeve të punuara në kuadër të projektit EX.PO AUS, pikërisht *Paketës së punës 3 – Menaxhimi i qëndrueshëm ndërkufitar i siteve të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në rajonin e Adriatikut*, bashkërenditjen e të cilit e ka kryer Qendra për Konservim dhe Arkeologji e Malit të Zi.

Pjesa e tekstit, *Korniza për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të menaxhimit*, është marrë nga *Doracaku i Trashëgimisë Botërore – Menaxhimi i Trashëgimisë Kulturore Botërore / World Heritage Resource Manual - Managing Cultural World Heritage*, të cilin e kanë botuar UNESCO, ICCROM, ICOMOS dhe IUCN në vitin 2013.

**Kryeredaktore:**

Aleksandra Kapetanović, EXPEDITIO

**Fotografitë:**

Nga publikimi EX.PO AUS *Avancimi i potencialeve i siteve të UNESCO-s në rajonin e Adriatikut*, botuar në kuadër të projektit EX.PO AUS; EXPEDITIO në vitin 2013

**Përkthim / Redaktimi:**

Agjencia e përkthimeve “Porta Aperta d.o.o.”, Podgoricë, Mali i Zi

**Dizajni, përgatitja për shtyp dhe shtypi:**

Biro Konto, Igallo, Mali i Zi

**Tirazhi:** 100 kopje

**Vendi dhe viti i botimit:** Kotorr, 2016

CIP - Каталогизација у публикацији  
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-9940-38-007-6  
COBISS.CG-ID 29678608

ISBN 978-9940-38-007-6



9 789940 380076 >



Këtë aktivitet, zbatuar në kuadër të projektit EX.PO AUS (EXtension of POTentiality of Adriatic UNESCO Sites – Avancimi i potencialeve të siteve të UNESCO-s në rajonin e Adriatikut), e ka realizuar Qendra për Konservim dhe Arkeologji e Malit të Zi, në bashkëpunim me partnerët:

Qyteti i Dubrovnikut, Kroaci, partneri udhëheqës

Qyteti i Splitit, Kroaci

Qarku i Istriës, Kroaci

Provinca Ferrara, Itali

Komuna e Ravenës – Muzeu i qytetit, Itali

Komuna Alberobello, Itali

Fondacioni Akuileia, Itali

Universiteti Primorska – Qendra shkencore dhe studiuuese, Kopar, Slloveni

Komisioni për ruajtje të monumenteve kombëtare, Bosnje - Hercegovinë

Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Butrintit, Shqipëri

Komuna e Korfuzit, Greqi



The project is co-funded by the European Union, Instrument for Pre-Accession Assistance



City of Dubrovnik



Region of Istria



City of Split



Province of Ferrara



Municipality of Ravenna - Art Museum of the City



Municipality of Alberobello



FONDAZIONE AQUILEIA

Aquileia Foundation



University of Primorska, Science and Research Centre



**CENTAR ZA KONSERVACIJU I ARHEOLOGIJU CRNE GORE**  
Center for Conservation and Archaeology of Montenegro



Commission to Preserve National Monuments



Office of Administration and Coordination of Butrint



Municipality of Corfu